



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

STRATEGJIA FISKALE E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT PËR 2022-2024
(me perspektivë deri në 2026)

Shkup, maj 2021

Rezyme e Strategjisë fiskale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2024 (me perspektivë deri 2026)

Strategjia fiskale përfshin udhëzimet dhe qëllimet afatmesme të politikës fiskale, projeksionet makroekonomike themelore, vlerat për kategoritë kryesore për vlerësimin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe projeksionet për deficitin buxhetor dhe borxhin. Strategjia fiskale është pasqyrim i qëllimeve afatmesme fiskale dhe prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas rënies së madhe në vitin 2020, ekonomia pritet të rimëkëmbet në vitin 2021, ku parashihet intensifikimi i rritjes ekonomike në vitet vijuese. Përkrahja shtetërore përmes masave të ndryshme ekonomike vazhdoi në vitin 2021, si dhe përmes masave që u ndërmorrën vitin paraprak dhe vazhduan të realizohen gjatë këtij viti, ashtu që përmes masave të reja, me qëllim të përkrahjes së ekonomisë vendore për rimëkëmbjen më të shpejtë të saj dhe krijimit të bazës për rritje ekonomike më të lartë për afat më të gjatë. Lidhur me mjedisin e jashtëm, pritet stabilizim gradual i zinxhirit global për furnizim, rritje të kërkesës së jashtme, që shoqërohet me uljen e presioneve nga pandemia në suaza globale, pritet të ndikojnë në mënyrë favorizuese ndaj rrjedhave ekonomike vendore gjatë periudhës vijuese, si dhe procesi i imunizimit masiv në vend pritet të ndikojë pozitivisht ndaj pritshmërive dhe besimit të subjekteve ekonomike dhe prirjes për investime dhe konsum. Politika fiskale dhe ridizajnimi i shpenzimeve publike, me theks në përforsimin e ciklit të investimeve publike dhe masat e drejtuara drejt arritjes së rritjes ekonomike të shpejtë, inkluzive dhe të qëndrueshme, do të ketë ndikim të konsiderueshëm ndaj kërkesës investuese dhe ndaj rritjes potenciale. Në përputhje me skenarin bazë afatmesëm, rritja ekonomike për vitin 2021 është projektuar në 4.1%, kurse për periudhën 2022-2026 parashihet rritje mesatare vjetore prej 5.4%, lëvizur nga kërkesa vendore, kurse importi neto pritet të ketë kontribut negativ, në kushte të rritjes së projektuar dhe të eksporti dhe importit.

Elemente kyçe të politikës fiskale afatmesme paraqesin ridizajnim dhe përmirësim të strukturës së financave publike, përmes rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale, si dhe konsolidimit fiskal në etapa, përmes uljes së deficitit buxhetor si dhe pjesëmarrjes procentuale në BPV edhe atë: 4.3% në vitin 2022, 3.5% në vitin 2023, 2.9% në vitin 2024, 2.5% në vitin 2025 dhe 2.2% në vitin 2026. Deficiti primar buxhetor poashtu në kontinuitet do të ulet nga 3.0% të BPV-së në vitin 2022 deri në arritjen e nivelit 1.2% në vitin 2026. Me qëllim të përforsimit të disiplinës fiskale, strategjia fiskale afatmesme vendos limite të shpenzimeve buxhetor dhe limite ndaj shfrytëzuesve buxhetorë.

Prioritetet kryesore në lëminë e sistemit tatimor janë drejtësia në tatimim, efikasitet më i madh dhe efektivitet në arkëtimin e të hyrave, rritja e transparencës tatimore, cilësi më e mirë e shërbimeve që i ofrojnë institucionet e sistemit tatimor, në mënyrë të thjeshtësimit dhe përsheptimit të procedurave dhe uljes së barrës administrative përmes shërbimeve të shumta dixhitale, si dhe vendosjes së tatimit ekologjik (të gjelbër), me qëllim të stimulimit të obliguesve tatimorë që përmes detyrimeve publike të kontribuojnë për uljen e ndotjes. Qëllimi kryesor i politikës tatimore është sigurimi i rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me mundësimin e sigurisë juridike për obliguesit tatimorë dhe arkëtimin të rregullt të të hyrave publike.

Ana e shpenzimeve e Buxhetit të RMV-së për periudhën e ardhshme plotësisht është krijuar në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike, përsheptimit të rritjes ekonomike, prioritetit për proceset integruuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt BE-së dhe detyrimet që dalin nga anëtarësimi në NATO dhe të tjera.

Me qëllim të avancimit të decentralizimit fiskal, për periudhën 2021-2024 janë paraparë disa aktivitete dhe masa që janë grupuar në tre shtylla edhe atë: I. Përmirësimi i kapaciteteve fiskale dhe rritja e të hyrave të komunave, II. Rritja e disiplinës fiskale dhe III. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në punën e tyre. Qëllimi final i këtij procesi është arritja e cilësisë më të lartë të shërbimeve publike, shkallës më të lartë të zhvillimit ekonomik si dhe përmirësimit të standardit jetësor.

Përmes politikës për menaxhim me borxhin publik janë siguruar mjete të nevojshme për financim të deficitit buxhetor dhe pagesë të borxheve të viteve të kaluara, si dhe mjete për financim projektues, pa shaktuar rritje të pajustificueshme të borxhit deri në nivel i cili mund të rrezikojë stabilitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike të shtetit.

Në Ministrinë e Financave në fazë përfundimtare është përgatitja e Planit për financim të rimëkëmbjes ekonomike dhe rritjes ekonomike të përsheptuar. Qëllimi kryesor i këtij plani është që përmes krijimit dhe shfrytëzimit të mekanizmave, instrumenteve, fondeve dhe burimeve të reja të financimit të krijohet efekt multiplikativ, përkatësisht përveç investimeve publike të planifikuara me vlerë prej 4 miliardë euro për periudhën 2021-2026, të financuara nga buxheti, fondet IPA dhe institucionet ndërkombëtare financiare, të mobilizohen shumëfish më shumë mjete dhe investime nga sektori privat.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	
1. Lëvizjet dhe projeksionet makroekonomike.....	
1.2 Lëvizjet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	
1.3 Projeksionet afatmesme makroekonomike.....	
2. Projeksionet fiskale.....	
2.1 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut viti 2021.....	
2.1.1 Realizimi në periudhën janar – prill viti 2021.....	
2.1.2 Korniza afatmesme për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	
2.1.3 Deficiti i Buxhetit të RMV-së dhe financimi.....	
2.1.4 Masat ekonomike për ballafaqim me pasojat nga KOVID -19.....	
2.2 Buxheti i pushtetit lokal.....	
2.2.1 Realizimi në periudhën janar – prill viti 2021.....	
2.2.2 Korniza afatmesme për buxhetin e pushtetit lokal.....	
2.3 Buxheti i qeverisë (buxheti i konsoliduar i RMV-së dhe buxheti i komunave).....	
3. Aspekte të tjera dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike.....	
3.1 Ligji për buxhete.....	
3.2 Raporti për detyrimet e paraqitura në përputhje me Ligjin për paraqitje dhe evidencë të detyrimeve.....	
3.3 Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit.....	
4. Shfrytëzimi i ndihmës paraadruar të BE	
4.1 IPA 1- Perspektiva financiare 2007-2013	
4.2 IPA 2- Perspektiva financiare 2014-2020.....	
4.3 IPA3 – në kuadër të Perspektivës financiare 2021- 2027.....	
5. Borxhi publik.....	
5.1. Vlera e borxhit publik dhe shtetëror.....	
5.2 Borxhi i garantuar dhe rreziku nga aktivizimin i garancive shtetërore.....	
6. Analiza krahasuese e projeksioneve makroekonomike dhe fisake për vitin 2022-2026.....	
6.1 Krahasimi me Strategjinë fiskale të reviduar 2021 - 2025.....	
6.2 Krahasimi me projeksionet e institucioneve tjera vendore dhe ndërkombëtare	
7. Reziqet fiskale dhe analiza senzitive	
7.1 Reziqet makrofiskale dhe senzitiviteti i deficitit dhe borxhit shtetëror.....	

Në bazë të nenit 16 paragrafi 2 nga Ligji për buxhetet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.64/2005, 04/2008, 103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, 192/2015 dhe 167/2016) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e mbajtur në datë ____05.2021, miratoi Strategjinë fiskale të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2022-2024 (me perspektivë deri në 2026)

Hyrje

Strategjia fiskale ofron projeksione afatmesme dhe në përputhje me Ligjin për buxhetet, miratohet për periudhë tre vjeçare ku propozohen udhëzimet dhe qëllimet e politikës, projeksionet dhe treguesit themelore makroekonomike, përcaktohen vlerat për kategoritë kryesore të të hyrave të vlerësuara dhe mjeteve të miratuara për atë periudhë, si dhe projeksionet për deficitin buxhetor dhe borxhin. Në interes të parashikueshmërisë fiskale të përmirësuar, me këtë Strategji fiskale planifikimi afatmesëm përfshin periudhat për pesë vitet e ardhshme.

Strategjia fiskale vijon të jetë instrument kyç për planifikimin buxhetor afatmesëm dhe ekzistenca e planifikimit të besueshëm të buxhetit afatmesëm ka rëndësi të madhe në krijimin e kornizës afatmesme.

Përmirësimi i menaxhimit me financat publike dhe kështu Strategjia fiskale si një ndër dokumentet më të rëndësishme strategjike të një qeverie është vendosur si një ndër prioritet kryesore të Qeverisë, kurse poashtu prioritet është edhe rruga drejt BE-së.

Strategjia fiskale afatmesme është në përputhje me qëllimet fiskale afatmesme dhe prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mundëson ndjekje të dinamikës së të hyrave dhe shpenzimeve në raport me qëllimet fiskale.

Në përputhje me Vendimin për përcaktim të prioritetëve strategjike për vitin 2022 akoma mbetet përcaktim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizim të prioritetëve më të rëndësishme strategjike edhe atë:

- Sigurimi i rritjes ekonomike të përshpejtuar dhe të qëndrueshme, standard më të lartë jetësor dhe cilësi jetësore të qytetarëve;
- Ballafaqimi me pasojat e shkaktuara nga pandemia botërore e shkaktuara nga virusi i Koronës;
- Negociata të udhëhequara të sukseshme me Bashkimin Evropian;
- Zhvillimi i politikës mbrojtëse në funksion të zhvillimit, pavarësisë, integritetit territorial, sigurisë së qytetarëve dhe sigurisë kolektive;
- Sundimi i së drejtës, gjyqësi e pavarur, luftë e vazhdueshme dhe joselektive kundër krimit dhe korrupsionit me transparencë të gjërë dhe detyimore;
- Arsimit cilësor i kapshëm për të gjithë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, zhvillim dhe avancim të kulturës dhe sportit;
- Administratë moderne dhe efikase, e bazuar në dixhitalizim e cila siguron cilësi dhe shërbime të shpejta për qytetarët dhe subjektet afariste;
- Realizim i plotë i Marrëveshjes kornizë të Ohrit, ndërtimi i shtetit qytetar me kohezion etnik dhe social, në bazë të principeve të tolerancës së ndërsjellë dhe respektit dhe
- Mbrojtja e mjedisit jetësor, zhvillim të gjelbër, ulje të ndotjes së ajrit dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike.

Elemente kyçe të politikës afatmesme fiskale paraqesin ridizajnimi i politikave buxhetore dhe konsolidimi fiskal, që janë në drejtim të përkrahjes së stabilitetit makroekonomik, përshpejtimit të rritjes ekonomike dhe me këtë edhe përforsim të potencialit për rritje të ekonomisë vendore.

Ridizajnimi i politikave buxhetore është në korelacion të ngushtë me strategjinë për rimëkëmbje ekonomike dhe rritje të përshpejtuar, e cila përbëhet prej katër shtyllave: (I) rimëkëmbja ekonomike nga KOVID-19, (II) rritja e përshpejtuar, inkluzive dhe e qëndrueshme, (III) përforsimi i konkurrencës në sektorin privat dhe (IV) zhvillimi i resurseve njerëzore dhe mundësi të barabarta.

Shtylla e parë, Rimëkëmbja ekonomike nga Kovid-19 përfshin dy prioritetet vijuese: 1. Mbrojtja e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtja sociale e kategorive më të ndjeshme në shoqëri dhe 2. Përkrahja e ekonomisë, sektorit privat dhe mbrojtjes së vendeve të punës.

Shtylla e dytë, Rritja e përshpejtuar, inkluzive dhe e qëndrueshme do të fokusohet në sferat vijuese prioritare: 1/ menaxhim i mirë (sundimi i së drejtës, luftimi i korrupsionit dhe ngritja e kapaciteteve institucionale), 2/ qëndrueshmëria fiskale, stabiliteti makroekonomik dhe financiar, 3/ zhvillimi i barabartë lokal dhe rajonal, 4/ mjedisi

jetësor i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm dhe 5/ dixhitalizimi i ekonomisë dhe shërbimeve publike, në suaza të së cilës janë paraparë masa dhe aktivitete të ndryshme.

Lidhur me shtyllën e tretë, Përforcimi i konkurrencës së sektorit privat do të fokusohet si në vijim: 1/përforcimi i lidhjeve tregtare dhe integrimi në zinxhirët globalë të krijimit të vlerave, 2/ përmirësimi i mjedisit afarist dhe luftimi i ekonomisë gri, 3/ përmirësimi i qasjes në financa dhe adaptimi i teknologjive dhe 4/ modernizimi i bujqësisë.

Në shtyllën e katërt, Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe mundësi të barabarta të përfshira me tre sfera prioritare vijuese: 1/ zhvillimi i rurseve njerëzore (arsimi, shkenca dhe shëndetësia). 2/ aktivitet më i madh i popullatës së aftë për punë dhe 3/ mbrojtja sociale dhe sigurimi social, në kuadër të se cilës janë paraparë masa dhe aktivitete të ndryshme.

Konsolidimi i planifikuar fiskal përfshin tre aspekte kryesore:

- Përmirësimi i arkëtimit të të hyrave buxhetore, përmes masave për uljen e ekonomisë gri dhe masa për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;

- Ulja dhe ristrukturimi i shpenzimeve buxhetore, përmes shkurtimit të harxhimeve joprioritare dhe jothelbësore, përkrahje më e madhe e sektorit privat dhe inovacione me qëllim të përforcimit të konkurrencës, komponenti social për përkrahje të kategorive më të ndjeshme të popullatës dhe revidimi i metodologjisë për transferet dhe subvencionet;

- Ndryshime në burimin e financimit të deficitit buxhetor, diversifikim më i madh i burimeve për financim të deficitit, financimi dhe realizimi i projekteve të caktuara përmes partneritetit publiko-privat dhe themelimi i Fondit zhvillimor për investime strategjike.

Në drejtim të angazhimit për konsolidim fiskal, njëkohësisht qëllimet për dyfishim të rritjes ekonomike dhe arritjes së normave vjetore të rritjes reale të BPV-së prej rreth 5%, në Ministrinë e Financave në fazë përfundimtare të përgatitjes është Plani për financim të rimëkëmbjes ekonomike dhe përsheptim të rritjes ekonomike. Ky plan i prezanton mekanizmat ekzistuese dhe të reja për qasje deri te kapitali për financim të rimëkëmbjes dhe përsheptimit ekonomik, përmes projekteve investuese në sektorin privat dhe i përcakton efektet mbi investimet bruto – investimet dhe rritjen ekonomike. Me planin parashihet rritje e investimeve të përgjithshme në ekonomi dhe gjithashtu të mbetet në kursin e projektuar të konsolidimit fiskal dhe me këtë të ruhet borxhi publik në nivel stabil.

Qëllimi kryesor i këtij plani është që përmes krijimit dhe shfrytëzimit të mekanizmave, instrumenteve dhe burimeve të reja të financimit të krijohet efekt, gjegjësisht përveç investimeve të planifikuara publike me vlerë prej mbi 4 miliardë euro për periudhën 2021-2026, të financuara nga buxheti, fondet IPA dhe institucionet ndërkombëtare financiare, të mobilizohen shumëfish më shumë mjete dhe investime nga sektori privat.

Plani përbëhet prej krijimit të fondeve zhvillimore, fondeve për përkrahje të inovacioneve, fondeve garantuese, fondeve ekvite, fondeve për kapital sipërmarrës (venture) dhe instrumente të ngjashme për përkrahje të kompanive eksportuese, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe ndërmarrjeve sociale. Planifikohet partneritet publiko-privat, koncesione dhe instrumente tjera për financim të projekteve publike kapitale, por edhe për sektorin privat. Një pjesë e projekteve tashmë janë shqyrtuar edhe në kuadër të Komitetit nacional investues (KNI), kurse pjesa tjetër do jenë si rezultat i iniciativave të sektorit publik ose sektorit privat. Sferat prioritare të financimit janë: mjedisi jetësor, dixhitalizimi, inovacionet, kapitali njerëzor dhe inkluzioni social.

Parashihet vendosja e fondeve të ndryshme që do të targetojnë projekte në sektorin publik dhe privat dhe do të shfrytëzojnë mekanizma të ndryshme për grumbullim të kapitalit. Një prej tyre është Fondi për përkrahje të kompanive eksportuese, i cili përmes prodhimeve kreditore të volitshme, do të përkrahë pjesëmarrjen e tyre në tregun e huaj. Mundësi tjetër për shfrytëzim të Fondit për investime, janë projektet kapitale siç janë ndërtimi i kopshteve të fëmijëve, shkollave, sallave sportive etj, ku gjatë përzgjedhjes së kompanive që do të kyçen në procesin e përgjithshëm do u jepet përparësi kompanive të vogla dhe të mesme. Në këtë mënyrë, nga njëra anë përveç investimeve në të mira kapitale, do të përkrahen edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Sektori për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të përkrahet edhe përmes Fondit investues hibrid për ekonomi të “gjelbër” dhe dixhitale.

Parashihet edhe formimi i Fondit për investime strategjike, i dedikuar për financim të infrastrukturës dhe investimeve. Ky fond do të sigurojë përkrahjen e nevojshme financiare për mbulimin e infrastrukturës voluminoze dhe axhendën e investimeve në zonat e lira ekonomike dhe industriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pas pilotimit, modeli mund të zgjerohet që ti përfshijë të gjitha operacionet e tilla në vend, pa kufizime, por me përkrahjen e investitorëve ndërkombëtarë privatë dhe institucionalë.

Në kuadër të Ligjit për fonde investuese alternative, i cili është në fazë të përgatitjes do të rregullohet themelimi dhe puna e fondeve për kapital sipërmarrës, që do të grumbullojë investime nga investitorët institucionalë dhe sipërmarrësit privatë që do të investojnë vlera më të larta.

Për themelimin e një pjese të këtyre fondeve, mund të shfrytëzohen kapacitetet veçse të vendosura, të tilla si Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Banka Zhvillimore dhe Zona zhvillimore industriale teknologjike.

Instrument shtesë për financim, përveç fondeve, planifikohet të jetë edhe "financimi me bashkëpunim apo strukturim të grupit (crowdfunding). Korniza kohore për themelimin e këtij instrumenti është gjysma e dytë e vitit 2022.

Zhvillimi i zgjidhjeve ideore, koncepteve, kornizave institucionale dhe ligjore, ndihma teknike do të mundësohet në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare financiare si Grupacioni i Bankës Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane Investuese (BEI). Në mënyrë shtesë, në periudhën e ardhshme pritet që Banka Botërore të parashtrojë parastudim për realizueshmëri, e cila do ta kompletojë tërësisht kornizën dhe hapat konkrete në krijimin dhe implementimin e këtyre aktiviteteve.


1 Lëvizjet dhe projeksionet makroekonomike

1.1 Lëvizjet dhe projeksionet ekonomike ndërkombëtare¹

Ekonomia globale në vitin 2021 pritet që të vazhdojë të jetë nën ndikimin e efekteve të pandemisë së virusit të Koronës. Megjithatë, pas kontraktimit ekonomik në vitin 2020, siç nuk është parë më herët në histori për shkak të natyrës dhe shpejtësisë së përhapjes së saj, në vitin 2021 pritet rimëkëmbja e ekonomisë globale, që në masë të madhe do të varet nga përkrahja fiskale shtesë në ekonomitë e mëdha, si dhe nga shpejtësia e vaksinimit gjatë vitit. Falë politikave në kohë për ballfaqim me pasojat e pandemisë, efektet ekonomike të pandemisë në fjalë, pritet që të jenë më të vogla se kriza globale financiare e vitit 2008.

Aktiviteti ekonomik global pritet të shënojë rritje prej 6% në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 pritet të jetë 4.4%. Sa i përket periudhës afatmesme, rritja ekonomike globale pritet që të ngadalësohet edhe gjatë periudhës 2023-2026, ku është projektuar rritje vjetore mesatare prej 3.4%. Ekonomia e BE-së, për vitin 2021 pritet të shënojë rritje prej 4.4%, pas rënies prej 6.1% në vitin paraprak. Në vitin 2022, norma e rritjes është projektuar për 3.9%, ndërsa në periudhën 2023-2026 rritja mesatare në BE është projektuar të jetë 1.8% në vit. Në Gjermani, si ekonomia më e madhe në kuadër të BE-së dhe partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, pritet që aktiviteti ekonomik të rritet për 3.6% në vitin 2021, për 3.4% në vitin 2022, ndërsa në periudhë afatmesme, gjegjësisht për periudhën 2023-2026 projektohet rritje mesatare prej 1.3% (Grafiku 1). Ngadalësimi i rritjes ekonomike në periudhë afatmesme pritet që të jetë reflektim i ndikimeve të pritshme të pafavorshme të krizës mbi ofertën dhe rritjen e ngadalësuar të fuqisë punëtore në vendet e zhvilluara dhe të atyre në zhvillim, si rezultat i plakjes së popullsisë.

Grafiku 1. Rritja ekonomike globale (në%)



Burimi: FNM, prill 2021 (Projeksione për v. 2021-2026)

-Botë

-BE

-Gjermani

Pasiguria në lidhje me projeksionet për rritjen globale është e lartë dhe është rrjedhojë e rreziqeve të shumta në rënie dhe në rritje. Shumica e punëve edhe më tej janë nën ndikim të madh të garës ndërmjet virusit dhe vaksinave. Progresi më i madh lidhur me vaksinimin mund t'i përmirësojë projeksionet, ndërsa për llojet e reja të virusit për të cilat

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar "Rishikimi ekonomik botëror", publikuar në muajin prill 2021.

vaksinat nuk janë efikase mund t'i përkeqësojnë ato. Përveç kësaj, kriza shëndetësore mund të ndikojë në përkeqësim më të madh të potencialit të ofertës agregate, që mund të dalë nga shkalla e zvogëluar e aktiviteteve të fuqisë punëtore, falimentimeve të shumta dhe çrregullimeve të rrjeteve të prodhimit. Nuk duhet të anashkalohen edhe rreziqet gjeopolitike, tregtare dhe teknologjike, para se gjitha dhe vendosja e barrierave tregtare për shkak të mbrojtjes së fuqisë punëtore.

1.2 Lëvizjet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në vitin 2020 BPV-ja shënoi ulje nën 4.5% në bazë reale. Aktiviteti i zvogëluar ekonomik kryesisht është rezultat i lëvizjeve të pafavorshme në tremujorin e dytë, kur BPV-ja reale shënoi ulje për 14.9% në bazë vjetore, që i referohet masave për parandalimin e përhapjes së virusit Korona në vend dhe mjedisit të përkeqësuar ndërkombëtar dhe reflektoi në aktivitetin e një pjese të madhe të sektorit të shërbimeve, ndërtimtarisë dhe industrisë. Në tremujorin e tretë dhe të katërt ulja e aktivitetit ekonomik dukshëm u ngadalësua, gjegjësisht është shënuar ulje prej 3.3% dhe 0.7% në mënyrë përkatëse, në kushte të tempos së ngadalësuar të uljes së aktiviteteve në sektorin e industrisë dhe të shërbimeve, gjegjësisht kishte lëvizje më të favorshme, aktivitete për investime dhe rritje të vazhdueshme të konsumit publik, me qëllim të ballafaqimit me pandeminë.

Ulja e aktiviteti ekonomik mund të jetë më i thellë, sipas vlerësimeve mund të jetë dyfish më i madh, në mungesë së ndihmës shtetërore përmes katër pakove të masave ekonomike me qëllim të përkrahjes së ndërmarrjeve dhe të punësuarve në sektoret më të prekura dhe kategoritë e ndjeshme të qytetarëve. Respoziviteti i politikës fiskale rezultoi, para se gjitha, me zbutjen e uljes së të hyrave, konsumit privat dhe të punësisë të shkaktuara nga pandemia, si dhe rritje më e konsiderueshme e konsumit publik.

Grafiku 2. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës së prodhimit (kontribut në rritje, p.p)




Industria
Bujqësia
BPV (%)

Ndërtimtaria
Shërbimet

Burimi: Enti shtetëror i statistikës dhe përlllogaritjet e Ministrisë së Financave

Në vitin 2020, aktiviteti në sektorin e shërbimeve është zvogëluar për 2.6%, që është si rezultat i lëvizjeve të favorshme në veprimtarinë e Tregtisë, transportit dhe hotelierisë, me ç'rast vërehet rënie prej 7.9% që pjesërisht është i neutralizuar me lëvizjet e favorshme në veprimtarinë e informacionit dhe komunikimit. Të dhënat me frekuencë të lartë për tregtinë e brendshme në tre muajt e parë të vitit 2021, paraqesin rritje nominale të qarkullimit prej 2.9 % si rezultat i rritjes së qarkullimit me produktet joushqimore. Sektori i ndërtimtarisë, për vitin 2020 shënoi rritje prej 2.1% në bazë reale, që sipas të dhënave mujore i referohet lëvizjeve të pafavorshme në segmentin e ndërtimeve të larta, ndërsa punët ndërtimore në ndërtimet e ulëta shënuan rritje nominale prej 4.6%, që i referohet aktivitetit në pjesën e ndërtimeve të larta. Sektori i bujqësisë shënoi rritje reale prej 1.7%.

Grafiku 3. Rritja vjetore e prodhimit industrial (në %)




Lëvizja e mesatares (3m)
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Në vitin 2020, aktiviteti në sektorin industrial ishte ulur për 10%, që është kryesisht për shkak të zvogëlimit të prodhimit të makinerive, aparateve, pajisjes elektrike dhe automjeteve, përkatësisht aktiviteteve që kryesisht janë integruar në zinxhirët globalë të prodhimit, si dhe prodhimit të zvogëluar të veshjeve, tekstilit dhe produkteve ushqimore. Prodhimi industrial në tremujorin e parë të vitit 2021 shënoi rënie prej 6.1%, me çrast në muajin mars u ndalua rënia e prodhimit në dy muajt paraprakë, përkatësisht u regjistrua rritje vjetore prej 7.6% (Grafiku 3), ku përveç përshejtimit të rritjes së prodhimit të makinerive, aparateve dhe pajisjes elektrike në raport me dy muajt paraprakë, ku kaloi në zonën pozitive të prodhimit të tekstilit, produkteve ushqimore, automjeteve etj. Shfrytëzimi i kapaciteteve në industrinë e përpunimit vazhdoi të rritet gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 dhe në muajin mars arriti 71.1%, duke iu afruar nivelit të para krizës shëndetësore ekonomike.

Dekompozimi i BPV-së sipas shpenzimeve tregon se konsumi privat dhe investimet kishin kontribut negativ mbi aktivitetin ekonomik, ndërsa kontributi i konsumit publik dhe eksportit neto është pozitiv (Grafiku 4). Konsumi privat shënoi rënie nga 5.6% në bazë reale, në kushte të kufizimit të konsumit dhe zvogëlimit të konsiderueshëm të remitencave nga jashtë, të cilat në mënyrë negative u reflektuan mbi të hyrat e amvisërive dhe mbi konsumin rrjedhimisht. Kështu, rënia më e konsiderueshme e konsumit u parandalua përmes masave ekonomike antikrizë dhe përkrahjes kreditore të bankave. Për më tepër, reduktimi i konsumit të përgjithshëm ishte zbutur me rritjen e lartë të konsumit publik prej 10.1% për shkak të shpenzimeve lidhur me ballafaqimin e pandemisë dhe pasojave të saj mbi popullatën. Investimet bruto u zvogëluar për 10.2% në bazë reale, që korrespondon me rënien e investimeve në punët ndërtimore.

Grafiku 4. Struktura e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontribut i rritjes, p.p.)



Експорти нето
Кërkesa vendore
BPV-ja (%)

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përlogaritjet e Ministrisë së Financave

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie prej 10.9% në bazë reale, që kryesisht është reflektim i përkeqësimit të mjedisit ekonomik ndërkombëtar dhe rezultoi kryesisht me rënie të eksportit të makinerive, mjeteve të transportit dhe produkteve kimike. Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie prej 10.5%, kryesisht për shkak të importit të zvogëluar të produkteve intermediare. Gjatë muajve të fundit të vitit 2020, shkëmbimi i jashtëm tregtar tregoi shenja të rimëkëmbjes dhe në tremujorin e parë të vitit 2021 ky shkëmbim intensifikohet, përkatësisht eksporti i mallrave shënoi rritje prej 18% dhe importi i mallrave prej 14.1% në bazë nominale.

Sa i përket tregut të fuqisë punëtore, punësimi vazhdoi të rritet në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe pastaj vijonte përkeqësim i gjendjes në tremujorët vijues, si pasojë të efekteve të pandemisë, që ishin kufizuar në kushte të përkrahjes shtetërore të kompanive me qëllim të ruajtjes së vendeve të punës. Kështu, sipas Ankesë së fuqisë punëtore, numri mesatar i të punësuarve në vitin 2020 shënoi rënie të lehtë prej 0.3% në raport me vitin 2019. Punësimi u zvogëlua kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe furnizimit me energji elektrike dhe ujë dhe në masë më të vogël edhe në sektorin e ndërtimitarisë, transportit dhe hotelierisë. Nga ana tjetër, punësimi u rrit kryesisht në veprimtarinë e informacionit dhe komunikimit, në sektorin e shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe tregtisë. Shkalla mesatare e punësimit në vitin 2020 ishte 47.2% dhe ishte pothuajse e pandryshuar në raport me vitin 2019, ndërsa shkalla mesatare e papunësisë shënoi ulje dhe është 16.4%. Në Grafikon 5 mund të shihet lëvizja e punësimit dhe shkalla e papunësisë sipas tremujorëve.

Grafiku 5. Numri i të punësuarve dhe shkalla e papunësisë



Извор: Државен завод за статистика


Të punësuarit, në mijëra (majtas)

Papunësia, në % (djathtas)

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Paga mesatare mujore neto në vitin 2020 shënoi rritje prej 7.8% në bazë nominale dhe 6.5% në bazë reale, si rezultat i masave të ndërmarra para pandemisë, siç janë: rritja e nivelit të pagës minimale, masa e qeverisë për përkrahje financiare të punëdhënësve të cilët do ta rrisin pagën deri në një vlerë të caktuar, pagat e rritura të të punësuarve në sektorin publik në muajin shtator të vitit 2019, si dhe rritja shtesë e pagave në arsim dhe shëndetësi në vitin 2020, ndërsa masa për ndihmë financiare të punëdhënësve të goditur nga kriza shëndetësore për pagesë të pagës ndikonte mbi zbutjen e trendit në rënie të rritjes së pagave gjatë pandemisë. Pagat janë rritur kryesisht në veprimtaritë e mëposhtme: informacione dhe komunikime, arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale, tregti, industria e përpunimit dhe ndërtimtari. Nga ana tjetër, pagat shënuan ulje në sektorin e hotelierisë, që është reflektim i vëllimit të zvogëluar të punës në këtë veprimtari. Në Grafikon 6 është pasqyruar dinamika e rritjes së pagave sipas tremujorëve. Në tremujorin e parë të vitit 2021, paga mesatare neto shënoi rritje nominale prej 4%, kryesisht si rezultat i rritjes së pagave në veprimtarinë e informacionit dhe komunikimit, shëndetësisë, artit dhe në një pjesë të veprimtarive në sektorin industrial.

Grafiku 6. Rritja e pagës mesatare neto (në %)




Burimi: Enti shtetëror i Statistikës

Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave në vitin 2020 shënoi deficit prej 373 milionë euro, që është 3.5% e BPV -së. Krahasuar me vitin paraprak, llogaria rrjedhëse shënoi përqësimit të pakonsiderueshëm si përqindje e BPV-së, për shkak të transfereve private nga jashtë, të cilat u ulën me rreth 24%, para së gjithash, në tremujorët e dytë dhe të tretë, si rezultat i krizës globale ekonomike të shkaktuar nga pandemia. Zhvillimet e tilla neutralizohen nga ngushtimi i deficitit tregtar dhe deficitit tek të hyrat primare, por edhe përmirësimi i bilancit gjatë shkëmbimit të shërbimeve.

Hyrja e investimeve të huaja direkte (IHD) është 240 milionë euro (2.2% të BPV-së) dhe mbuloi pjesën më të madhe të deficitit të llogarisë rrjedhëse, duke reflektuar të hyrat solide në tremujorin e parë dhe të katërt, ndërsa në tremujorin e dytë dhe të tretë, në kushte të pasigurisë së madhe për shkak të pandemisë, fluksi hyrës i IHD u ndërpre (Grafiku 7). IHD-të, në pjesën më të madhe, janë në formën e instrumenteve debitoare, mbi bazën e të cilave u realizuan të hyra prej 128 milionë euro. Në formën e kapitalit personal u realizuan të hyra prej 97 milionë euro dhe pjesa tjetër bazohet në riinvestimin e fitimeve të kompanive me kapital të huaj. Në fund të vitit 2020, rezervat devizore arritën në 3.4 miliardë euro dhe sigurojnë mbulimin e importit të mallrave dhe shërbimeve prej 5.3 muajve nga periodha paraprake 12 mujore.


Grafiku 7. Saldoja e llogarisë rrjedhëse dhe të hyrat e IHD (në milionë euro)



Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Norma e inflacionit në vitin 2020 shënon 1.2%. Rritja e çmimeve konsumatore i detyrohet rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore prej 2.6% dhe bazës së inflacionit që është 0.9%, që ka lëvizur si rezultat i rritjes së çmimeve të duhanit, ndërsa çmimet e derivateve të naftës shënuan rënje dyshifrore, në përputhje me rënien e çmimit të të naftës në bursën botërore. Në periudhën janar-prill të vitit 2021, viti i inflacionit shënon 2.2%, e lëvizur nga rritja e çmimeve ushqimore, energjisë elektrike dhe duhanit, ndërsa ndryshimi i çmimeve të derivateve të naftës kaloi në zonën pozitive në muajin prill. Inflacioni bazik në këtë periudhë është 1.6% (Grafiku 8).

Grafiku 8. Informacioni i përgjithshëm dhe bazik (në %)



— I përgjithshëm
 - - - - - Bazik

Burimi: Enti shtetëror i Statistikës dhe përllogaritjet e Ministrisë së Financave

Në fillim të gjysmëvjetorit të parë të vitit 2020, në kushte të nivelit të lartë të rezervave devizore naftës dhe presioneve të ulëta të inflacionit, Banka Popullore vazhdon me përshtatjen e politikës monetare, përmes zvogëlimit të normës së bazës së interesit tre herë në muajin janar, mars dhe maj gjithsej me 0.75 pikë përqindje, përkatësisht 1.5%, por edhe nëpërmjet masave të tjera, me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë ndaj ekonomisë vendore. Aktiviteti kreditor në muajin dhjetor të vitit 2020 u rrit prej 4.7% në bazë vjetore i lëvizur nga rritja e kreditimit të amvisërive për 8%, ndërsa kontribut pozitiv kishte edhe kreditimi i ndërmarrjeve me rritje prej 1.1%. Depozitat e përgjithshme në sistemin bankar në muajin dhjetor për 5.9% në bazë vjetore, me ç'rast depozitat në valutë vendore rriten për 3.6, ndërsa ato në valutë të jashtme për 9.5%.

Në muajin mars të vitit 2021, me zvogëlimin shtesë të normës së bazës së interesit për 0.25 pikë përqindje, Banka Popullore vazhdoi me lehtësimin e mëtejshëm monetar, ashtu që norma e interesit shënon 1.25% dhe është në nivel më të ulët deri më tani. Në muajin prill të vitit 2021 u shënuar rritje për 5.7% në bazë vjetore, në kushte të rritjes së kredive të amvisërive prej 8.9% dhe kredive për ndërmarrjet prej 2.3%. Potenciali i përgjithshëm i depozitave në muajin prill 2021 u rrit prej 6.9% në bazë vjetore, me ç'rast përshpejtimi i tillë i rritjes së depozitave është si rezultat i rritjes së dinamikës së depozitave në valutë vendase.

1.3 Projektionet makroekonomike afatmesme

Pas rënies së fuqishme në vitin 2020, ekonomia pritet që të rimëkëmbet në vitin 2021, pas së cilës parashihet intensifikimi i rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, përkatësisht kthimi në nivelin e para krizës në vitin 2022 dhe përshpejtimi i mëtejshëm gradual.

Përkrahja e shtetit përmes masave të ndryshme ekonomike vazhdoi në vitin 2021, si përmes masave të ndërmarrja në vitin paraprak dhe vazhduan të realizohen gjatë këtij viti, ashtu edhe përmes masave të reja, me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë ndaj grupeve më të ndjeshme dhe për mbështetjes së ekonomisë vendase për rimëkëmbje më të shpejtë dhe krijim të bazës për rritje më të lartë ekonomike në periudhë afatgjate.


Sa i përket mjedisit të jashtëm, pritet stabilizim gradual i zinxhirëve global të furnizimit, rritja e aktivitetit ekonomik të partnerëve tanë më të mëdhenj tregtarë dhe kështu edhe rritja e kërkesës së huaj, e cila shoqërohet me presione të reduktuara të pandemisë në nivel global, në rrethana të intensifikimit të procesit të vaksinimit, pritet të ketë një ndikim të favorshëm në flukset e brendshme ekonomike në periudhën e ardhshme, si në aktivitetin e eksportit ashtu edhe në investimet dhe konsumin.

Mjedisi i favorshëm ndërkombëtar dhe procesi i imunizimit masiv në vend pritet që të ketë ndikim pozitiv në pritshmërinë dhe besimin e subjekteve ekonomike vendore dhe prirjen për investim dhe konsum. Politika fiskale dhe ridizajnimi i shpenzimeve publike, me theks në përforsimin e ciklit të investimeve publike dhe masat që synojnë arritjen e rritjes ekonomike të përshpejtuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, do të kenë ndikim të rëndësishëm në kërkesën për investime dhe rritjen potenciale.

Për të përkrahur aktivitetin e investimeve, intensifikimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e punësimit në periudhë afatgjate dhe përmirësimin e konkurrencës së ekonomisë dhe duke vazhduar në rrugën e konsolidimit fiskal në proces të përgatitjes është Plani për financimin e rimëkëmbjes dhe përshpejtimin të rritjes ekonomike e cila siguron mënyra të reja të qasjes në kapital, përmes projekteve në sektorin publik dhe privat, duke shfrytëzuar mekanizma, instrumente, fonde dhe burime të reja të financimit, të cilat do të krijojnë efekte multiplikative në aktivitetin ekonomik.

Rritja ekonomike në vitin 2021 projektohet në 4.1%, ndërsa në periudhën 2022-2026, sipas skenarit bazë afatmesëm, parashihet rritje mesatare vjetore prej 5.4%, e nxitur nga kërkesa e brendshme, ndërsa eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ, në rrethana të rritjes së eksportit dhe importit.

Grafiku 9. Struktura e shpenzimeve të rritjes së BPV-së (kontribut në rritje, p.p.)



Konsumi privat
Investime
BPV

Konsumi publik
Eksporti neto

Burimi: ESHS dhe përlogaritjet e Ministrisë së Financave (* projekcioni)

Dekompozimi i rritjes ekonomike tregon se investimet do të luajnë një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e ekonomisë dhe intensifikimin e saj gradual (Grafiku 9). Rritja reale e investimeve bruto është parashikuar në 8% në vitin 2021, ndërsa në periudhën 2022-2026, investimet pritet të shënojnë rritje mesatare vjetore prej 8.8%. Rritja e investimeve bazohet në rritjen e pritshme të investimeve private, në kushtet e rritjes graduale të besimit të subjekteve afariste, të hyrave më intensive të investimeve të huaja, impulsit të pritshëm fiskal që do të kanalizohet përmes rritjes së shpenzimeve kapitale dhe rritjes së mbështetjes për zhvillimin e sektorit privat dhe përforcimi i konkurrencës, mbështetjes së aktivitetit inovativ dhe zhvillimin teknologjik të ndërmarrjeve.

Konsumi, gjithashtu parashihet që ta mbështesë rritjen e kërkesës së brendshme. Pas rënies në vitin 2020, e cila u zbut ndjeshëm përmes masave ekonomike për mbështetjen e më të prekurve nga pandemia, konsumi privat pritet të rritet me 4% në vitin 2021, në rrethana të kthimit gradual të besimit dhe optimizimit me fillimin e vaksinimit masiv, rimëkëmbjes së remitancave nga jashtë, mbështetur edhe nga masat fiskale të ndërmarra për ballafaqimin e pandemisë. Zhvillimet e favorshme në konsumin privat pritet të vazhdojnë në periudhën 2022-2026, kur projektohet rritje mesatare vjetore prej 3.9%, e mbështetur nga pritshmëritë për përmirësimin e mëtejshëm të situatës së tregut të punës, përforcimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe rritjen e disponueshmërisë së të hyrave të amvisërive. Efekte pozitive në konsumin privat priten edhe nga mbështetja kreditore e bankave, e mbështetur nga masat e pushtetit monetar.

Rritja e konsumit publik është parashikuar në 4.3% në bazë reale në vitin 2021, e cila është pjesërisht për shkak të shpenzimeve për ballafaqim me krizën shëndetësore. Në vitet e ardhshme, konsumi publik pritet të rritet me një ritëm më të ngadalësuar, respektivisht parashikohet rritje mesatare vjetore prej 1.4% në periudhën 2022-2026, për shkak të përpjekjeve për zvogëlimin e shpenzimeve jothelbësore dhe racionalizimin dhe zbatimin e tyre të procesit të konsolidimit fiskal.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, me shterimin e efekteve ekonomike të pavolitshme nga pandemia, rimëkëmbjen e zinxhirëve globalë të prodhimit dhe kërkesës së jashtme, dhe kështu edhe shfrytëzim më të lartë të kapaciteteve prodhuese në vend, parashihet që të shënohet rritje reale prej 10.06% për vitin 2021. Në afat të mesëm, në kushte të pritshmërisë së stabilizimit të rritjes së kërkesës së jashtme dhe rritjes së potencialit eksportues në vend përmes të hyrave të investimeve të huaja, eksporti pritet të ketë kontribut të rëndësishëm mbi rritjen ekonomike, gjegjësisht është paraparë që të shënojë rritje mesatare vjetore prej 8.8% në bazë reale për periudhën 2022-2026.

Rritja e aktivitetit eksportues dhe rimëkëmbja e kërkesës vendore në vitin 2021 kushtëzojnë rritje të importit të të mirave intermediare, kapitale dhe konsumatore, me ç'rast me rritjen reale të importit të mallrave dhe shërbimeve është projektuar në 11%, që implikon kontribut negativ të eksportit neto mbi rritjen ekonomike. Në periudhën e ardhshme parashihet stabilizim i caktuar i kërkesës importuese, gjegjësisht rritje mesatare vjetore e importit të mallrave dhe shërbimeve prej 7.7% në bazë reale në periudhën 2022 – 2026, por edhe ngushtim gradual i kontributit negativ të eksportit neto në rritjen ekonomike (grafiku 9).

Табела 1. Тreguesit kryesorë makroekonomikë për Maqedoninë e Veriut

	2020	2021*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*
БДП, реална стапка на раст	-4,5	4,1	4,6	5,2	5,6	5,9	5,7
Стапка на инфлација (просек)	1,2	2,1	1,8	2,0	2,0	2,0	2,0
Бруто-инвестиции (% од БДП)	29,6	30,8	31,8	32,9	34,0	35,1	36,2
Трговско салдо (% од БДП)	-16,9	-17,9	-17,7	-17,3	-16,8	-16,2	-15,6
Салдо на тековна сметка (% од БДП)	-3,5	-3,0	-2,4	-2,0	-1,6	-1,2	-0,7
Нето-плата - номинален пораст (%)	7,8	3,0	3,5	3,8	4,1	4,2	4,2
Стапка на невработеност (просек)	16,4	15,8	14,4	12,9	11,4	9,9	8,6
Стапка на вработеност (просек)	47,2	47,5	48,6	49,8	51,3	52,8	54,3

Извор: ДЗС, НБРСМ и проекции (*) на Министерството за финансии

BPV, norma reale e rritjes

Norma e inflacionit (mesatarja)

Investimet bruto (% të BPV)

Saldoja buxhetore (% të BPV)

Paga neto – rritja nominale (%)

Shkalla e papunësisë (mesatarja)


Shkalla e punësisë (mesatarja)

Burimi: ESHS, BPRMV dhe projeksonet (*) e Ministrisë së Financave

Me zvogëlimin e presioneve nga kriza shëndetësore, kthimin gradual të besimit të investitorëve dhe përmirësimin e pritshmërive të subjekteve afariste, në periudhën e ardhshme parashihet rritja e kërkesës së fuqisë punëtore, e nxitur përmes masave dhe programeve aktive të punësimit dhe mbështetjes së kompanive vendase dhe të huaja për hapjen e vendeve të reja të punës.


Sipas skenarit bazë makroekonomik, në vitin 2021 pritet që rritja e numrit të të punësuarve të jetë 1%, dhe në periudhën 2022-2026 punësimi parashihet të rritet me ritëm më të lartë, përkatësisht parashihet rritje mesatare vjetore prej 3.6% (Grafiku 10). Rritja e punësimit në këtë periudhë pritet të reflektojë edhe në ofertën e punës, e cila projektohet të rritet mesatarisht për 1.7% në nivel vjetor. Zhvillime të tilla në tregun e punës do të kontribuojnë që niveli mesatar i papunësisë në vitin 2026 të ulet në 8.6%, ndërsa niveli mesatar i punësimit të rritet në 54.3%. Rritja e pagës mesatare neto në këtë periudhë pritet të jetë 3.8% në nivel vjetor në bazë nominale, me perspektiva për intensifikim të rritjes gjatë periudhës së parashikimit.

Grafiku 10. Rritja e numrit të të punësuarve dhe shkalla e papunësisë



Norma e inflacionit në vitin 2021 parashikohet të jetë 2.1%, që paraqet intensifikim të caktuar të inflacionit në krahasim me vitin 2020, me lëvizjen e projektuar në rritje të inflacionit efektiv të huaj dhe çmimeve të prodhimeve primare në bursat botërore. Në periudhën 2022-2026, inflacioni pritet të mbetet i ulët dhe stabil, i projektuar në 1.8% në vitin 2022 dhe 2% në nivel vjetor në periudhën e ardhshme, përmes rritjes së moderuar të inflacionit efektiv të huaj dhe pjesërisht i ndikuar nga kërkesa e brendshme.

Grafiku 11. Llogaria rrjedhëse sipas komponenteve (saldoja, % e BPV-së)



Burimi: BPRMV dhe përlogaritjet e Ministrisë së Financave (*projekcioni)

Në periudhën e ardhshme, deficitin e llogarisë rrjedhëse është parashikuar të shënojë ngushtim gradual. Në vitin 2021, deficitin pritet që të ulet për 3% nga BPV-ja, që kryesisht i referohet rritjes së projektuar të transfereve private nga jashtë, në rrethana të zvogëlimit gradual të efekteve negative të pandemisë. Përmirësimi i deficitit pritet të vazhdojë në vitet e ardhshme dhe të ulet nën 1% të BPV-së në vitin 2026, përkatësisht gjatë periudhës së parashikuar deficitin e llogarisë rrjedhëse mesatarisht në bazë vjetore është 1.6% të BPV-së (Grafiku 11). Përmirësimi i këtillë është rezultat i ngushtimit gradual të projektuar të deficitit tregtar dhe rritjes së suficitit të shkëmbimeve të shërbimeve, në rrethana të stabilizimit të pritur të nivelit të transfereve rrjedhëse nga jashtë në periudhë afatmesme. Të hyrat e IHD priten që ta tejkalojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse në periudhën 2022-2026, që do të ketë ndikim dhe do të jenë të favorshme për ruajtjen e rezervave devizore në nivel adekuat.

Skenari themelor makroekonomik shoqërohet me rreziqe, që vlerësohen si rënës dhe kryesisht i referohen lafatgjatësisë dhe pasojave nga kriza shëndetësore. Në rast të zbatimit të procesit të vaksinimit në mënyrë të ngadalësuar, si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar ose në rast të paraqitjes së valës së re të infeksioneve për shkak të mutacioneve të reja të virusit dhe rezistencës së tyre të madhe ndaj vaksinave, mund të rezultojë me vendosjen dhe/ose ashpërsimin e masave kufizuese, reperkusionet në zingjirët globalë të furnizimit dhe kërkesave të jashtme, përkeqësimin lidhur me pritshmëritë e subjekteve afariste dhe amvisërive, të hyrat e investimeve dhe dërgesave financiare nga jashtë, me ç'rast do të rezultojë me pasoja negative në aktivitetin ekonomik të përgjithshëm vendor. Nga ana tjetër, fillimi i negociatave për anëtarësim në BE, mund të ketë ndikim më të konsiderueshëm mbi aktivitetet e investimeve dhe zbatimit të reformave strukturore në vend, ku nëse përshpejtohet tempojat do të përforcohet rritja ekonomike afatgjate, ndërsa prolongimi i zgjidhjes së mangësive strukturore mund ta pengojë rritjen më të shpejtë të ekonomisë dhe konvergencën e saj në vend. Gjithashtu, ruajtja e stabilitetit politik në vend paraqet parakusht kyç për arritjen e rritjes së projektuar ekonomike. Rreziqet sa i përket dinamikës së projektuar të inflacionit, kryesisht lidhen me pasigurinë e lartë në aspekt të lëvizjes së çmimeve të produkteve primare në bursat botërore.

2. Projektionet fiskale

2.1 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 hartohet në gjysmën e dytë të vitit 2020, në rrethana të ndikimit të konsiderueshëm të krizës shëndetësore ekonomike të shkaktuar nga virusi i koronës. Si reagim ndaj ballafaqimit me pasojat nga kriza ekonomike, Qeveria ndërmori të gjitha masa të domosdoshme gjithpërfshirëse për ruajtjen e vendeve të punës, për servisim të detyrimeve më prioritare, si dhe për reduktim në minimum të të gjitha shpenzimeve produktive nga Buxheti.

Në supozimet e projeksioneve fiskale për vitin 2021 ishte marrë parasysh paparashikueshmëria ende e pranishme sa i përket kohëzgjedhjes dhe intensitetit të pandemisë shëndetësore, implikimeve të saj mbi buxhetin dhe ekonominë në tërësi dhe impaktin e saj mbi rimëkëmbjen ekonomike dhe sigurimin e rritjes së përsheptuar.

Të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 planifikohen në nivel prej 212.6 miliardë denarëve dhe ato janë 8.3% më të larta krahasuar me Ribalancin e dytë në vitin 2020, ndërsa shpenzimet planifikohen në nivel prej 247.5 miliardë denarëve ose për 2.1% më pak krahasuar me Ribalancin e dytë në vitin 2020.

Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara në këtë mënyrë rezultojnë me deficit buxhetor në nivel prej 4.9% të BPV-së së planifikuar ose në vlerë absolute prej 34.9 milionë denarëve dhe sigurojnë shlyerjen në mënyrë të rregulltë dhe të pandërprerë të detyrimeve të shfrytëzuesve të buxhetit.

2.1.1 Realizimi në periudhën janar – prill të vitit 2021

Në periudhën janar – prill të vitit 2021, të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë² së Veriut (Tabela 2) janë realizuar në vlerë prej 67.840 milionë denarëve ose rreth 31.9% të Buxhetit për vitin 2021, përkatësisht ato janë më të larta për 11.7% krahasuar me të hyrat e arkëtuara për të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Nga kjo vlerë, 39.743 milionë denarë janë të hyra tatimore dhe ato shënojnë rritje prej 17.7% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat nga TVSH-ja janë realizuar në nivel prej 18.510 milionë denarëve dhe ato dominojnë në strukturën e të hyrave tatimore me 46.6%. Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale u realizuan në vlerë prej 6.156 milionë denarëve, të hyrat nga tatimi mbi fitimin janë arkëtuar në vlerë prej 4.756 milionë denarëve, ndërsa akcizat arritën nivelin prej 7.190 milionë denarëve. Të gjitha llojet e të hyrave tatimore shënuan rritje krahasuar me periudhën e analizuar në vitin e kaluar. Të hyrat nga kontributet sociale u realizuan në vlerë prej 22.527 milionë denarëve dhe ato janë për 1.222 milionë denarë ose 5.7% më të larta krahasuar me periudhën përkatëse të vitit 2020. Në bazë të sigurimit pensional janë realizuar 15.226 milionë denarëve, ndërsa në bazë të sigurimit shëndetësor janë arkëtuar 6.373 milionë denarë.

Në periudhën janar – prill të vitit 2021, të hyrat jotatimore janë 4.364 milionë denarë. Në këto korniza, dominojnë të hyrat jotatimore të shfrytëzuesve të buxhetit në llogaritë vetanake, që janë realizuar në nivel prej 2.437 milionë denarëve. Të hyrat kapitale janë 287 milionë denarë, ndërsa shfrytëzuesit e buxhetit u realizuan 919 milionë denarë në bazë të donacioneve nga bashkëpunimi bilateral dhe multilateral ndërkombëtar.

Shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar-prill të vitit 2021 u realizuan në vlerë prej 74.701 milionë denarëve ose rreth 30.2% të Buxhetit për vitin 2021, përkatësisht për 2.5% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Në këtë periudhë, detyrimet e shfrytëzuesve të buxhetit, të drejtat ligjore të qytetarëve dhe detyrimet e maturuara ndaj kreditorëve vendas dhe të huaj u shlyen në mënyrë të pandërprerë dhe në kohë.

Në këto korniza, shpenzimet rrjedhëse arritën 70.007 milionë denarë. Në këtë periudhë janë paguar 10.105 milionë denarë për paga dhe kompensime për të punësuarit në institucionet që janë shfrytëzues të buxhetit, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në vlerë prej 5.157 milionë denarëve.

Pjesëmarrje më të madhe në strukturën e shpenzimeve rrjedhëse kanë shpenzimet, për të cilat gjatë kësaj periudhe janë paguar 52.730 milionë denarë. Detyrimet e shtetit ishin servisuara në mënyrë të rregullt sa i përket plotësimit të të drejtave të mbrojtjes së garantuar sociale të popullatës (kompensimet financiare për kategoritë e ndjeshje të qytetarëve, si dhe kompensimet në bazë të shtesës për fëmijët dhe prindërit) për të cilin qëllim u realizuan 3.938 milionë denarë. Për pagesën e rregullt të pensioneve u dedikuan 20.622 milionë denarë. Për financimin e shërbimeve shëndetësore dhe kompensimeve u paguan 10.662 milionë denarë, ndërsa për pagesën e kompensimit financiar në rast të papunësisë u destinuan 558 milionë denarë përmes Agjencisë së punësimit. Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt komunave u transferuan 6.364 milionë denarë si bllok grante për financimin e kompetencave të transferuara, si dhe grante të destinuara për financimin e shpenzimeve materiale në institucionet publike lokale. Gjithashtu, u transferuan edhe 746 milionë denarë nga të hyrat e realizuara të tatimit të vlerës së shtuar.

Për servisimin e rregullt të detyrimeve në bazë të interesit u ndanë 2.015 milionë denarë sipas planeve të amortizimit për huamarrjen e brendshme dhe të jashtme. Nga kjo vlerë 1.090 milionë denarë u destinuan për pagesën e

² Sipas Buxhetit të RMV-së për vitin 2021 (Gazeta Zyrtare numër 307/20)

interesit sa i përket huamarrjes në tregun e jashtëm. Për servisimin e rregullt të detyrimeve në bazë të shlyerjes së kryegjës janë paguar mjete në vlerë prej 7.019 milionë denarëve.

Shpenzimet kapitale në periudhën janar – prill të vitit 2021 u realizuan në vlerë prej 4.694 milionë denarëve dhe ato janë për 1.596 milionë denarë ose 51.5% më të larta krahasuar me vitin paraprak.

Gjatë kësaj periudhe, deficit i Buxhetit të RMV-së ishte në vlerë prej 6.861 milionë denarëve ose 1% krahasuar me BPV-së së projektuar për vitin 2021.

Gjatë vitit 2021, Ministria e Financave sa i përket rritjes së transparencës krijoi vegël të re për transparencë Numëruesi fiskal, që në bazë ditore tregon të hyrat dhe shpenzimet e realizuara, si dhe realizimin e shpenzimeve kapitale, ndërsa në bazë mujore tregon borxhin e shtetit.

Tabela 2. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 dhe realizimi janar – prill viti 2021

	Buxheti 2021	Realizimi jan – prill 2021	Realizimi jan – prill 2020	Realizimi jan – prill 2021/Buxheti 2021 (%)	Realizimi jan – prill 2021/Realizimi jan - prill 2020 (%)
					në %
Të hyrat e përgjithshme					
Të hyrat tatimore dhe kontribute					
Të hyra tatimore					
Tatimi mbi të hyrat personale					
Tatimi mbi fitimin					
TVSH (neto)					
Akciza					
Detyrimet e importit					
Tatimet e tjera					
Kontribute					
Të hyra jotatimore					
Të hyra kapitale					
Donacione					
Shpenzime të përgjithshme					
Shpenzime rrjedhëse					
Paga dhe kompensime					
Mallra dhe shërbime					
Transfere në NJVL					
Subvencione dhe transfere					
Transfere sociale					
Interesi					
Shpenzime kapitale					
Deficiti					
Deficiti (% e BPV)					
Def. Primar (% e BPV)					
Financimi i deficitit					
Fluksi hyrës					
Burime vendore					
Burime të jashtme					
Depozimi ("-" është akumulimi në llogari)					
Fluksi dalës					
Pagesë sipas huamarrjes vendore					
Pagesë sipas huamarrjes së jashtme					
Fluksi i hyrjeve të tjera					

2.1.2 Korniza afatmesme për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2022-2026

Politika fiskale në periudhën 2022-2026 karakterizohet nga përcaktimi për të forcuar më tej menaxhimin e financave publike dhe qëndrueshmërinë fiskale, që duhet të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimin fiskal në etapa (Tabela 3).


Në periudhën e ardhshme afatmesme do të vazhdojmë të stimulojmë konsumin privat të qytetarëve dhe përkrahjen shtesë të ekonomisë në veprimtaritë inovative dhe eksportuese, rritjen e konkurrencës, produktivitetit dhe modernizimin dhe dixhitalizimin e proceseve.

Prioritetet afatmesme do të orientohen në ballafaqimin me pasojat e pandemisë, përmes rritjes së vëllimit të investimeve me përkrahje të drejtpërdrejt të aktiviteteve të kompanive, përmirësimin dhe lehtësimin e klimës investuese, hapjen e vendeve të reja të punës përmes masave aktive për punësim, si dhe përkrahjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Kjo do të thotë se përkrahja do të realizohet përmes krijimit të fondeve zhvillimore, fondeve për përkrahjen e inovacionit, fondeve garantuuese, fondeve ekvite, fondeve për kapital sipërmarrës (venture) dhe instrumenteve të ngjashme për të përkrahur kompanitë eksportuese, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe ndërmarrjet sociale. Përveç kësaj, janë planifikuar partneritete publike-private, koncesione dhe instrumente të tjera për financimin e projekteve publike kapitale, si dhe projekte të sektorit privat.

Edhe më tej Mbetet përkushtimi për qëndrueshmërinë fiskale, përkrahjen e ekonomisë me investime në projekte infrastrukturore, ridizajnimin e strukturës së financave publike përmes rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale, si dhe përf forcimin e procesit të planifikimit, realizimit dhe raportimit të financave publike.

Strategjia fiskale afatmesme përcakton limitet e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore, si dhe limitet e përgjithshme sipas shfrytëzuesve buxhetorë (Shtojca 1). Arkëtimi i prituri i të hyrave do të sigurojë ngushtim në etapa të deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 4.9% të BPV-së në vitin 2021 në 2.2% në vitin 2026. Deficiti primar buxhetor gjithashtu do të zvogëlohet vazhdimisht nga 3.6% të BPV-së në vitin 2021 deri në arrijtjen e nivelit prej 1.2% në vitin 2026. (Grafiku 12).

Grafik 12. Lëvizja e saldove të përgjithshme dhe primare buxhetore (në % të BPV-së)



% të BPV

---- Saldoja primare buxhetore

___ Saldoja buxhetore

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave (*)

Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit të RMV-së (buxheti qendror dhe fondet) për periudhën 2022-2026 janë planifikuar në masën rreth 31.3% të BPV-së. Projeksionet e të hyrave për periudhën e ardhshme afatmesme bazohen në të hyrat e realizuara nga vitet paraprake dhe efektet e reformave të planifikuara në sferën tatimore.

Përkatësisht, pas dy debateve publike me të gjitha palët e involvuara, Qeveria gjatë muajit dhjetor të vitit 2020 miratoi Strategjinë për reformën e sistemit tatimor 2021-2025, e cila është e harmonizuar me të gjitha dokumentet e tjera strategjike të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave. Sipas saj, grupi punues për zbatimin e strategjisë miratoi Planin aksional për vitin 2021, nga ku edhe burojnë qëllimet kryesore, prioritetet dhe aktivitetet

e politikës tatimore për periudhën e ardhshme. Qëllimi kryesor i politikës tatimore është të sigurojë rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duke garantuar siguri ligjore për obliguesit tatimorë dhe arkëtim të rregullt të të hyrave publike. Prioritetet kryesore të strategjisë janë:

- drejtësi më e madhe në tatimin, në mënyrë që të sigurohet që të gjithë t'i përmbushin detyrimet e tyre shoqërore dhe ta paguajnë pjesëmarrjen e tyre të drejtë të tatimit,
- efikasitet dhe efektivitet më i madh i sistemit tatimor për arkëtim më të mirë të të hyrave, përmes luftës më efikase ndaj veprimtarive të paregjistruara dhe evazionit tatimor dhe fuqizimit të kapaciteteve institucionale, si dhe uljes së detyrimeve të prapambetura;
- rritja e transparencës tatimore, e cila përfshin përmirësimin e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet organeve tatimore dhe subjekteve të tjera, i cili do të bazohet kryesisht në shërbimet elektronike, që do të rezultojë në rritjen e edukimit fiskal dhe harmonizimin më të madh vullnetar;
- cilësi më e mirë e shërbimeve të ofruara nga institucionet e sistemit tatimor, në mënyrë që të thjeshtësohen dhe përshpejtohen procedurat dhe zvogëlohet barra administrative, nëpërmjet më shumë shërbimeve dixhitale, menaxhimit më të mirë sa i përket dhënies së lejeve të import-eksportit, eliminimin e barrierave të panevojshmeve tarifore dhe kontroll më të mirë të brendshëm tatimor.
- vendosja e tatimit ekologjik (të gjelbër), me qëllim që të stimulohen obliguesit tatimorë përmes detyrimeve publike që të kontribuojnë në ndotjen më të vogël, pra të destimulohen sa i përket ndotjes së mjedisit. Efekti i këtij prioriteti pritet të reflektohet si në të hyrat buxhetore ashtu edhe në mjedisin jetësor.

Përmes relaksimit të zbutur të politikës tatimore me analizë të njëkohshme për korrigjimin e normave tatimore individuale, pritet të arrihet një efekt i shumëfishtë, dmth. - synohet të ofrohet mbulim më i madh tatimor, procese administrative të drejta dhe të lehtësuara, si dhe mbështetje për sektorin privat. , e cila do të rezultonte në uljen e evazionit fiskal dhe një rritje të bazës tatimore.

Nga aspekti i reformave tatimore është e rëndësishme që të theksohet reforma për kthimin e një pjese të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) tek personat fizikë, e cila ka nisur me zbatim në muajin korrik të vitit 2019 por vijon me një numër të madh të qytetarëve në të ardhmen. Domethënë, personat fizikë përmes mbledhjes së llogarive të tyre fiskale dhe përmes paraqitjes në organin tatimor kanë të drejtën e kthimit të një pjese të TVSH-së, përkatësisht 15% të tatimit të deklaruar në llogaritë fiskale, përkrahësisht gjatë vitit 2020 është bërë ndryshim në TVSH-në time dhe atë 20% në vend të 15% të kthimit për produktet dhe shërbimet e Maqedonisë.

Kjo masë siguron të hyra shtesë për çdo familje, përforcon fuqinë blerëse dhe ndikim pozitivisht në rritjen e konsumit dhe arkëtimin të TVSH-së, si dhe në uljen e evazionit tatimor dhe ekonomisë gri. Kjo masë planifikohet të vazhdojë edhe në vitin 2021, me ç'rast bëhet analizë lidhur me mundësinë e rritjes së vlerës më të lartë të shfrytëzuar për të drejtën e kthimit të TVSH-së për personat fizikë.

Në vitin aktual 2021, Ministria e Financave është duke përgatitur propozim ndryshime ligjore në Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar në aspekt të harmonizimit me Direktivën e BE-së për TVSH-në, ndërsa ndryshimet do t'i referohen vendosjes së termit përfaqësues tatimor, rregullimin e vendit të krijimit të qarkullimit të shërbimeve, analizë për rritjen e pragut të detyrueshëm të regjistrimit të TVSH-së nga 2 në 3 milionë denarë, rregullimin e mëtejshëm të konceptit të faturës në format elektronik, rregullimin e trajtimit të lëshimit të faturës nga blerësi (self-billing) si dhe ndryshime dhe plotësime të tjera.

Në të njëjtën kohë, në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në drejtim të zvogëlimit të ekonomisë gri në sektorin e hotelarisë si dhe zvogëlimit të çmimeve sa i përket shërbimeve të restoranteve nga data 1 janar 2021, një normë e re preferenciale e tatimit mbi vlerën e shtuar 10. % ishte prezantuar.

Ligji për akciza thjeshton dhe përmirëson mënyrën e paraqitjes së akcizës për prodhuesit e vegjël të alkoolit, si dhe përmes vendosjes së sistemit për monitorim elektronik të mallrave të akcizave përmirëson kapacitetin për administrimin e akcizës lidhur me to.

Tatimi i mjeteve motorike bëhet përmes Ligjit të ri për tatimin e mjeteve motorike, ku krahas parametrin bazë të tatimit, vendoset tregues për ndotjen e mjedisit jetësor, i cili kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe i njëjti duhet të rritet mesatarisht në 4 vitet e ardhshme prej 25% në nivel vjetor.

Sipas ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin e tatimit mbi të ardhurat personale, të cilat zbatohen nga data 1 janar i vitit 2020, parashikohet fiksimi i normave progresive të tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe kthimi i normës së sheshtë tatimore prej 10% për të gjitha llojet e të ardhurave, përveç të ardhurave të realizuara nga lojërat e fatit, dhe ndërkohë, përmes analizave të shumta do të krijohet një model tatimor optimal për përcaktimin e të ardhurave.

Në vitin rrjedhës 2021 janë planifikuar analiza të caktuara për disa lloje të bazës tatimore, të cilat dalin nga llojet e ndryshme të të ardhurave të përshkruara në ligj.

Nga aspekti i procedurave tatimore në vitin 2021 është planifikuar miratimi i Ligjit të ri për procedurë tatimore si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për DAP me qëllim të lehtësimit të proceseve tatimore dhe dixhitalizimit të tyre.

Në lidhje me tatimet direkte janë bërë disa ndryshime në drejtim të përlogaritjes së drejtë të bazës tatimore tek tatimi mbi fitimin dhe me të është bërë harmonizimi me praktikat ndërkombëtare tatimore. Konkretisht, në vitin 2021 janë planifikuar ndryshime në Ligjin për tatimin mbi fitimin nga aspekti i përcaktimit të lirimeve të caktuara tatimore për grupe të ndjeshme të punëtorëve dhe thjeshtësimi i mënyrës së mbulimit të humbjeve për qëllime tatimore.

Në vitin 2021, për herë të parë në histori bëhet harmonizimi i normave doganore me ato të BE-në për më shumë se 300 numra tariforë (produkte) që shfrytëzohen përgjithësisht si repromateriale në industrinë e përpunimit dhe do të kishin një shtysë të fuqishme ndaj rritjes së prodhimit, eksportit dhe punësimit. Analizat tregojnë se kompanitë që përdorin produktet e cekura në procesin e tyre të prodhimit më shumë se 36% do të rrisnin eksportin dhe punësimin.

Gjithashtu, nga mesi i vitit 2021 duhet të fillojë zbatimi i sistemit të automatizuar për kthimin e TVSH-së tek obliguesit tatimorë të regjistruar në të, me ç'rast do të reduktonte ndjeshëm kohën mesatare të kthimit të tatimit dhe do të automatizonte të gjithë procesin për likuiditet më të madh dhe në kohë sa i përket ekonomisë.

Në përputhje me qëllimet strategjike të Ministrisë së Financave, e njëta filloi me analizën dhe vlerësimin e të gjitha harxhimeve tatimore që dalin si rezultat i ligjeve tatimore përmbajtësore si dhe ligjeve përkatëse me të cilat përcaktohen lirimet e caktuara tatimore me qëllim të evidentimit dhe matjes në kohë të të hyrave potenciale tatimore. Detyrimi për vlerësimin e harxhimeve tatimore në nivel vjetor do të rridhte si rezultat i ligjit të ri për buxhete i cili është në procedurë parlamentare dhe do të ishte në harmonizim me Direktivën e kërkesave për kornizat buxhetore (2011/85/BE) vendet anëtare kanë detyrimin që të sigurojnë raporte për shpenzimet tatimore dhe ndikimin e tyre ndaj të hyrave.

Paralelisht me procesin e ndryshimeve ligjore, po zhvillohet edhe procesi i forcimit të kapaciteteve të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë Doganore për zbatimin e dispozitave ligjore të lartpërmendura.

Në strukturën e të hyrave të planifikuara, të hyrat tatimore marrin pjesë me 59.9%, të hyrat nga kontributet sociale me 30.1%, të hyrat jotatimore dhe kapitale me 7.7%, ndërsa pjesa tjetër e të hyrave pritet të realizohet nga fondet IPA dhe donacione të tjera. Në kuadër të të hyrave tatimore, vlera më e madhe e të hyrave do të realizohet në bazë të TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat personale dhe akcizës.

Projeksionet e kontributeve sociale që paraqesin të hyrat burimore të fondeve për sigurim pensional dhe shëndetësor dhe punësimit në periudhën e ardhshme afatmesme bazohen në rregullativën ekzistuese për përcaktimin e vlerës së normave për sigurim pensional dhe shëndetësor si dhe zhvillimet e pritshme ekonomike, që do të reflektohen në parametrat përkatës - rritja e punësimit dhe pagat.

Të ardhurat jotatimore në periudhën e ardhshme afatmesme marrin pjesë me rreth 6.3% në të hyrat e përgjithshme dhe në to më e rëndësishme është pjesëmarrja e të hyrave nga taksat administrative dhe të hyrat e tjera jotatimore të realizuara nga shfrytëzuesit buxhetorë në llogaritë e tyre. Në kuadër të të hyrave kapitale është planifikuar intensifikimi i aktiviteteve lidhur me shitjen e tokës bujqësore.

Në projeksionin e të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pjesën e donacioneve të huaja, në periudhën e ardhshme janë planifikuar donacionet që shfrytëzuesit buxhetorë do t'i realizojnë për projekte konkrete, si dhe tërheqjet nga paraaderuese të BE-së.

Tabela 3. Buxhet i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020-2026 (në milionë denarë)

	Llogaria përfundimtare 2020	2021*	2022*	2023*	20204*	2025*	2026*
Të hyra të përgjithshme							
Të hyra tatimore dhe kontribute							
Të hyra tatimore							
Kontribute							
Të hyra jotatimore							
Të hyra kapitale							
Donacione							
Shpenzime të përgjithshme							
Shpenzime rrjedhëse							
Paga dhe kompensime							
Mallra dhe shërbime							

Transfere në NJVL							
Subvencione dhe transfere							
Transferet sociale							
Pagesa të interesit							
Vendore							
Të jashtme							
Shpenzimet kapitale							
Saldoja buxhetore							
Saldoja primare buxhetore							
Të hyra të përgjithshme, % e BPV-së**							
Shpenzime të përgjithshme, % e BPV-së**							
Saldoja buxhetore, % e BPV-së**							
Saldoja primare buxhetore, % e BPV-së**							

Burimi: Ministria e Financave dhe projektionet e Ministrisë së Financave (*)

Në krijimin e kornizës fiskale afatmesme me rëndësi të madhe është planifikimi adekuat afatmesëm i buxhetit. Në këtë drejtim duhet të merret parasysh se në periudhën e ardhshme projektionet fiskale afatmesme bazohen në skenarin bazë afatmesëm, që do të thotë se përcaktimi i projeksioneve fiskale është si rezultat i kryerjes së kompetencave të shfrytëzuesve buxhetorë të përcaktuara në legjislacionin ekzistues, detyrimeve dhe detyrave ekzistuese, të cilat janë si rezultat i detyrimeve tashmë të miratuara shumëvjeçare, marrëveshje dhe projekteve rrjedhëse.

Për më tepër, në kuadër të iniciativave të reja, të cilat në thelb i referohen projekteve dhe detyrimeve të reja financiare, ndryshimit të konsiderueshëm të kornizës kohore dhe financiare të projekteve, si dhe ndryshimeve në legjislacion, të cilat shkaktojnë implikime fiskale për buxhetin, me këtë Strategji fiskale planifikohet vlerë e konsiderueshme e mjeteve për realizim të investimeve kapitale në sferën e infrastrukturës rrugore.

Ana e shpenzimeve të Buxhetit të RMV-së në periudhën e ardhshme është krijuar plotësisht për arritjen e prioritetëve strategjike, përshejtimin e rritjes ekonomike, prioritetin për proceset integruuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE dhe detyrimet që dalin nga anëtarësimi në NATO.

Pjesëmarrja mesatare e shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2022-2026 është rreth 34.4% të BPV-së. Projektionet e shpenzimeve të Buxhetit për periudhën e ardhshme afatmesme janë krijuar mbi tre bazat kryesore:


- harmonizimi i projeksonit të të hyrave me aktivitetet e planifikuara ekonomike;
- projekcioni i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit siguron konsolidim të vazhdueshëm fiskal, dhe
- vlerat e planifikuara të shpenzimeve sigurojnë kryerjen e rregullt dhe të pandërprerë të të gjitha detyrimeve ligjore.

Gjatë projektimit të vlerës dhe strukturës së shpenzimeve rrjedhëse për periudhën e ardhshme (Grafiku 13), të destinuar për pagesën e rregullt të pagave të të punësuarve në sektorin publik, pagesën e rregullt dhe në kohë të pensioneve dhe të drejtave të tjera sociale, pagesën e subvencioneve në bujqësi, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe subvencionimin e aktiviteteve inovative, me ç'rast janë marrë parasysh supozimet në vijim:

- në pjesën e shpenzimeve për paga dhe kompensimeve vazhdon përcaktimi për të kontrolluar punësimet e reja me qëllim të optimizimit të administratës publike, si dhe rritja graduale e pagave në sektorë të caktuar sipas mundësive fiskale;
- pagesë e të ardhurave në kohë, përmes indeksimit të rregullt me shpenzimet e jetesës, në mënyrë që të sigurohet nivel adekuat i standartit të jetesës për të moshuarit;
- pagesë e kompensimeve sociale në kohë, sistemi i reformuar i mbrojtjes sociale (të ardhura minimale të garantuara) në mënyrë që të krijohet gjendje e sigurt materiale për shfrytëzuesit e këtyre të drejtave;
- mbrojtje shëndetësore, e cila realizohet përmes Fondit të sigurimit shëndetësor, kryesisht është në lidhje me financimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën;
- zbatim i politikave aktive dhe masave të punësimit, të cilat do të dedikohen kah krijimi i programeve, masave dhe shërbimeve të punësimit, të cilat do të zbatohen për të përmirësuar funksionimin e tregut të punës, për të përkrahur krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe punësimin e të rinjve – garanci për të rinjtë.
- përkrahje optimale duke siguruar mjete për shfrytëzim më efikas të subvencioneve në bujqësi në mënyrë që të krijohet sistem i prodhimit të qëndrueshm dhe konkurrues bujqësor, si dhe stimulim të punësimit përmes bizneseve bujqësore;
- stimulim i rritjes ekonomike dhe zhvillimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes avancimit të mjedisit të biznesit dhe përmes krinimit të një mjedisi për biznes dinamik dhe konkurrues, përkrahjes së

ndërmarrjeve të qëndrueshme dhe konkurruese mikro, të vogla dhe të mesme, avancimit të sipërmarrësisë dhe inovacionit.

Grafiku 13. Struktura mesatare e shpenzimeve rrjedhëse 2022-2026 (në %)



Kompensime sociale 53%

Interesi 4%

Paga 13%

Shpenzime materiale 11%


Transfere në NJVL 9%

Subvencione dhe transfere 10%

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave

Në periudhën afatmesme, fokusi i politikës fiskale mbetet në drejtim të sigurimit të nivelit të konsiderueshëm të investimeve publike, të cilat janë parakusht për përmirësimin e perspektivave ekonomike, si dhe për jetë më të mirë të qytetarëve. Në këtë drejtim, planifikohet një vlerë e konsiderueshme të investimeve kapitale (Grafiku 14) përmes shfrytëzimit të mjeteve nga Buxheti, duke përfshirë edhe mjetet e siguruar me hua nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kreditorët bilateral. Vlerat e planifikuara tregojnë intensifikimin e projekteve infrastrukturore, përkatësisht investimet në infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore, infrastrukturën energjetike dhe komunale, si dhe investimet kapitale për përmirësimin e kushteve në sistemin shëndetësor, arsimor dhe social, në bujqësi, kulturë, sport, mbrojtje të mjedisit dhe gjyqësi.

Grafiku 14. Shpenzimet kapitale e Buxhetit të RMV-së



Milionë denarë (shkalla e majtë) % e BPV-së (shkalla e djathtë)

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave (*)

Investime të konsiderueshme planifikohen në sferën e infrastrukturës rrugore, në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e një pjese të Koridorit 8, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e Korridorit 8, Seksioni: Tetovë – Gostivar/zgjerimin e autostradës, ndërtimin e autostradës së re Trebenishtë – Strugë – Qafë Thanë, ndërtimin e seksionit Gostivar – Bukojçan dhe Bukojçan – Kërçovë, si dhe Korridorit 10, seksioni Prilep – Manastir.

Përveç Buxhetit, përmes Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore realizohen investime të konsiderueshme në sferën e infrastrukturës rrugore: Projekti për mbindërtim dhe zhvillim të seksionit Rankoc – Kriva Pallankë, i financuar me hua nga Banka Botërore, dhe në të njëjtën kohë vazhdon ndërtimi i autostradës Kërçovë – Ohër, që financohet me hua nga Banka Eksport-import të RP të Kinës. Në periudhën e ardhshme do të intensifikohen aktivitetet e parashikuara në Programin e rrugëve nacionale, i cili financohet me hua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZH, me të cilin parashikohet ndërtimi i seksioneve Shtip – Koçan, Raec – Drenovë, si dhe rikonstruim dhe rehabilitim i 26 seksioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me gjatësi të përgjithshme prej rreth 400 km. Në të njëjtën kohë, me hua nga BERZH-i financohet edhe realizimi i Projektit për ndërtim të seksionit Shtip – Radovich.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdojë ndërtimi i seksionit Shkup – Bllacë, i cili do të ketë ndikim pozitiv mbi aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike në rajon, si dhe lehtësimin e transportit ndërkombëtar dhe tregtisë në rajon, veçanërisht midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës. Për rehabilitimin dhe rikonstruimin e rrugëve lokale në vend, do të vazhdojë realizimi i Projektit për lidhjen e rrugëve lokale, i cili financohet me hua nga Banka Botërore. Në të njëjtën kohë, në vitin 2021 do të vazhdojë ndërtimi i seksionit Kriva Pallankë – Deve Bair (kufiri me Bullgarië), si dhe faza e dytë e vendosjes dhe instalimit të sistemit për pagesë elektronike të taksave rrugore, përgjatë Korridorit VIII dhe autostradës Milladinoc – Shtip”.

Në kuadër të infrastrukturës hekurudhore, fokusi do të jetë në përfundimin e zbatimit të Projektit për përmirësimin e linjës hekurudhore të Korridorit X, si dhe intensifikimi i aktiviteteve në lidhje me Projektin për rindërtim të linjës hekurudhore të Korridorit VIII (linjë hekurudhore Kërçovë – Lin – kufiri me Republikën e Shqipërisë), që synon lidhjen e Detit të Zi me Detin Adriatik, që ka rëndësi të madhe strategjike dhe ekonomike sa i përket këtij projekti.

Ndërtimi i pjesës lindore të linjës hekurudhore të Korridorit VIII – pjesa drejt Republikës së Bullgarisë realizohet në 3 faza. Brenda periudhës së parashikuar do të intensifikohet realizimi i fazës së parë (linja hekurudhore Kumanovë – Beljakocë) në gjatësi prej 30.8 km dhe fazës së dytë (linja hekurudhore Beljakovcë – Kriva Pallankë) në gjatësi prej 34 km, të financuara me hua nga BERZH-i dhe mjete grant nga KIBP (Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor).

Gjegjësisht, përveç mjeteve grant nga KIBP për përkrahje teknike të projektit, u siguroa edhe grant investues nga KIBP në vlerë prej 68.6 milionë euro për financimin e fazës së dytë të projektit. Përfundoi përgatitja e fazës së tretë (linja hekurudhore Kriva Pallankë-Deve Bair-kufiri drejt Republikës së Bullgarisë) në gjatësi prej 23.4 km, që financohet me mjete grant nga IPA dhe ndërtimi i linjës hekurudhore do të financohet me hua nga Banka Evropiane e Investimeve – BEI, BERZH-i dhe mjetet grant nga IPA kombëtare dhe KIBP.

Në sferën e infrastrukturës së transportit, me hua nga iniciativa rajonale e Bankës Botërore për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në vendet e Ballkanit Perëndimor, financohen aktivitete të konsiderueshme të projektit, në lidhje me promovimin e integritetit më të thellë ekonomik brenda rajonit, uljen e shpenzimeve të tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën kohë, në vitin 2021 do të fillojë implementimi i Projektit për vendosjen e transportit të shpejtë me autobus në Qytetin e Shkupit, i cili do të financohet me hua nga BERZH-i.

Me realizimin e Projektit për ndërtimin e sistemit nacional gazsjellës do të sigurohet furnizimi i ekonomisë, sektorit publik dhe amvisërive me energji të lirë dhe ekologjike, dhe në të njëjtën kohë do të ulet emitimi i gazrave të dëmshme. Në kuadër të periudhës së parashikuar pritet të fillojë realizimi i Projektit të ri të gazsjellësit interkonektiv midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë, i cili financohet me hua nga BEI. Në të njëjtën kohë, në kuadër të këtij sektori është paraparë të fillojë edhe realizimi i Projektit për ndërtimin e gazsjellësit magjstral seksioni Gostivar – Kërçovë dhe seksioni Shën Nikollë – Veles.

Në periudhën e ardhshme vazhdon realizimi i Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale, i financuar nga Banka Botërore. Mjetet nga huatë nga Banka Botërore janë dedikuar për financimin e projekteve infrastrukturore në sferën e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të zeza, menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe për investime të tjera në shërbimet komunale, të cilat kanë potencial për të gjeneruar të ardhura, përkatësisht kursime ose të cilat kanë prioritet më të lartë për komunat.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2021 filloi realizimi i Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, i cili do të financohet me hua nga Banka Botërore. Projekti do të përfshijë realizimin e investimeve në efikasitet të energjisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit dhe komuna në Qytetin e Shkupit, si dhe institucionet shëndetësore publike, Ministria e Ekonomisë, Ministrisa e Financave dhe Banka Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës, veçanërisht në zonat rurale të vendit, duke furnizuar ujë të pijshëm të pastër, në periudhën e ardhshme do të vazhdojë realizimi i Projektit për furnizim me ujë dhe largim të ujërave të zeza, i financuar me hua nga BEI. Këto mjete Qeveria ua jep komunave në formë granti, me ç’rat në mënyrë të konsiderueshme kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdojë ndërtimi i Spitalit klinik rajonal në Shtip, i financuar me hua nga Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës – CEB. Në sferën e arsimit, në periudhën e ardhshme pritet të vazhdojë realizimi i Projektit për ndërtim të sallave të fizkulturës në shkollat fillore dhe rehabilitim të shkollave fillore dhe të mesme, i financuar me hua nga CEB dhe me pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, projekt që synon përmirësimin e kushteve për edukim fizik, si dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme për mësim të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme.

Në sferën e arsimit zbatohet edhe Projekti për rikonstruim të konvikteve studentore, i cili financohet me hua nga banka KfW, i cili synon zbatimin e qëllimeve dhe politikave në lidhje me rritjen e efikasitetit energjetik dhe sigurimin e kushteve themelore për qëndrim në konvikte studentore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën kohë, në kuadër të kësaj sfere, projekt i rëndësishëm në të cilin fokusohet Qeveria është Projekti për përmirësimin e arsimit fillor, i cili financohet me hua nga Banka Botërore dhe synon përmirësimin e cilësisë së arsimit me investime të reja në

infstrukturalen e shkollave fillore, reformen e ndjekjes dhe vleresimit te progresit nacional te procesit te mesimit, si dhe Perforcimin e kompetencave te personelit mesimor, bashkepunetoreve profesionalë dhe drejtorëve të shkollave.

Me perkrahje te BEI-se planifikohet te filloje realizimi i fazes se dyte dhe se trete te projektit "Permiresimi i shfrytezimit te ujerave ne pellgun e lumit Zletovicë". Qëllimi kryesor i fazes se dyte eshte qe te sigurohet ujitja e sipërfaqes neto prej 4.570 hektarëve në zonën e komunave të Probishtipit dhe Kratovës. Realizimi i fazes se trete, e cila perfshin ndertimin e hidrocentraleve te vogla pergjate shtratit te lumit Zletovicë, do te kontribuojë në drejtim te lehtesimit sa i perket mungeses se energjise elektrike ne ketë rajon, furnizim te qendrueshëm, te sigurt dhe cilësor te konsumatorëve me energji dhe rritje te efikasitetit energjetik.

Faza e dyte e projektit "Ujitja e luginës jugore te lumit Vardar", e cila do te vazhdoje edhe ne vitin 2021, financohet me hua nga Banka KfW. Per ketë projekt u siguruan 4 milionë euro mjete grant nga Republika Federale e Gjermanisë permes Bankës KfW per perkrahje te aktiviteve te parashikuara te investimeve, perkatesisht rehabilitim dhe modernizim te sistemeve te ujtjes ne rajonin e Vallandovës. Ne te njjten kohë, do te filloje Programi per ujitje, qe perfshin rehabilitimin dhe zgjerimin e 4 sistemeve te ujtjes pergjate luginës se lumit Vardar (Straishtë, Lisiçe, Konjsko dhe Pepelishë), si dhe ndertim i hidrocentraleve te vogla te HS Lisiçe.

Në periudhën e ardhshme afatmesme pritet te perfundoje faza e pare e projektit "Ujësllësi dhe kanalizimi i komunave", i financuar me hua nga Banka KfW dhe mjete grant nga Zvicra, ku sigurohet furnizimi i qendrueshëm i popullatës me ujë te pjeshëm ne komunat e Gostivarit, Kavadarit dhe Radovishit. Ne te njjten kohë, pritet te filloje edhe realizimi i fazes se dyte te ketij projekti, financuar me mjete grant ne vlerë te pergjithshme prej 5 milionë euro, te siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë permes Bankës KfW per aktivite investuese ne komunat e Gjevgjeliës dhe Kavadarit.

Me perkrahje te Bankës Botërore do te filloje pergatitja dhe realizimi i Projektit per modernizim te bujqësisë, qe do te perfshije krijimin e qendrave per furnizim dhe distribuim te produkteve bujqësore, si dhe ndertimin e stacionit per perpunim te mbetjeve me origjinë shtazore.

Prioriteti i rëndësishëm mbi te cilin do te fokusohet Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut eshte pergatitja e Projektit per ndertim te stacionit filtrues te ujerave te zeza te Qytetit te Shkupit, qe financohet me hua nga BEI dhe BERZH, si dhe mjete grant nga instrumenti ERI.

Segmenti i pare i Projektit per rikonstruim te institucioneve ndeshkuese korrektuese, perkatesisht burgu i Kumanovës, Qendra edukativo-korrektuese per te mitur ne Tetovë dhe faza e pare e INK Idrizovë janë realizuar . Ne vazhdim eshte pergatitja e dokumentacionit projektues per segmentin e dyte te projektit, perkatesisht faza 2 dhe 3 e INK Idrizovë. Projekti financohet me hua nga BQE dhe mjete grant nga BE dhe i njjeti ofron kontribut te madh ne drejtim te krijimit te institucioneve ndeshkuese korrektuese profesionale te organizuara dhe te menaxhuara ne menyre efektive, me ç'rast ne vazhdim sigurojnë risocializim dhe integrim te qytetarëve ne shoqëri.

Në kuadër te sektorit social, ne vitin 2021 do te vazhdoje implementimi i Projektit per avancim te shërbimeve sociale, i cili financohet me hua nga Banka Botërore dhe qe synon zgjerimin e qasjes dhe permiresimin e cilësisë se shërbimeve sociale, duke perfshire edhe shërbimet parashkollore per grupet me te ndjeshme, permes zhvillimit te politikave, vendosjes se sistemit gjithperfshirës te shërbimeve sociale dhe zbatimit sistematik te shërbimeve te reformuara permes rrjetit te zgjeruar te ofruesve te shërbimeve sociale, ngritjes se sistemit te integruar informatik per administrimin e te drejtave dhe shërbimeve, zgjerimit te kapaciteteve te kujdesit dhe arsimit ne moshën parashkollore permes ndertimit te objekteve te reja dhe adaptimit (ose rindertimit) te infrastrukturës ekzistuese te institucioneve parashkollore. Gjithashtu, ne kuadër te kësaj sfere, projekt i rëndësishëm eshte edhe Projekti per administrim te sigurimit social, qe synon permiresimin e cilësisë se shërbimeve ne administrimin e sigurimit social dhe avancimin e kornizës ligjore, qe rregullon çështjet qe i referohen personave me aftësi te kufizuara dhe vendeve te punës me stazh te sigurimit me kohëzgjatje (stazh i beneficuar). Ky projekt financohet me hua nga Banka Botërore.

Në drejtim te tejkalimit te problemeve, qe janë si rezultat i paraqitjes se virusit te koronës COVID-19, dhe me qëllim te parandalimit, zbulimit dhe parandalimit te virusit te koronës COVID-19, si dhe perforcimit te sistemeve nacionale per gatishmërinë e shëndetësisë publike ne Mëqedoninë e Veriut, Qeveria do te vazhdoje me realizimin e Projektit per ballafaqim urgjent me COVID-19 ne Maqedoninë e Veriut, i financuar me hua nga Banka Botërore.

Me qëllim te sigurimit te kapitalit te ri per ndërmarrjet e vogla dhe te mesme si dhe perkrahjes se tyre me qëllim te ballafaqimit me pasojat e pandemisë COVID-19 permes perkrahjes se projekteve te reja, punësimeve te reja, rritjes se likuiditetit te ekonomisë dhe rritjes se eksportit, ne vitin 2021 do te realizohet linja e gjashtë kreditore nga BEI per financimin e ndërmarrjeve te vogla dhe te mesme ne vlerë prej 100 milionë euro.

2.1.3 Deficiti i Buxhetit të RMV-së dhe financimi

Në periudhën 2022-2026 eshte paraparë qe deficiti buxhetor te jetë si ne vijim: 32.7 miliardë denarë per vitin 2022 ne 22.5 miliardë denarë ne vitin 2026. Kjo do te thotë se gjatë kësaj periudhe afatmesme eshte paraparë

konsolidim fiskal gradual, përkatësisht pjesëmarrja e deficitit buxhetor sa i përket BPV-së do të ulët nga 4.3% në vitin 2022 në 2.2% në vitin 2026.

Financimi i deficitit të planifikuar, si dhe pagesat e borxhit, do të sigurohen përmes huamarrjes nga burime të huaja dhe vendase (Tabela 4). Në muajin mars të vitit 2021, shteti emetoi euroobligacion në vlerë prej 700 milionë eurove. Maturimi i euroobligacionit është 7 vite, ndërsa norma e interesit të kuponit është 1.625%, që është norma më e ulët e interesit të euroobligacioneve të emetuara deri më tani. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021 pritet të arrijë transha e dytë e Huasë nga BE-ja për përkrashje makrofinanciare në vlerë prej 80 milionë eurove, kurse financimi plotësues i Buxhetit do të realizohet përmes tërheqjes së huave nga institucionet ndërkombëtare financiare, si dhe përmes huamarrjes në tregun vendor të letrave shtetërore me vlerë. Përmes kësaj strukture financiare, shteti në mënyrë të pandërprerë do mund ta financojë deficitin buxhetor si dhe ta kryejë pagesën e detyrimeve në bazë të borxhit, që maturon gjatë vitit. Në periudhën 2022-2024, huamarrja e jashtme mund të realizohet përmes emetimit të euroobligacionit në tregun ndërkombëtar të kapitalit dhe përmes tërheqjes së mjeteve nga kreditë e favorshme nga institucionet e huaja financiare dhe linjat kreditore të dedikuara për financimin e projekteve të veçanta. Gjegjësisht, përzgjedhja e burimit konkret për financim të jashtëm do të bazohet në gjendjet rrjedhëse dhe të pritura në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Më tutje, huamarrja në tregun vendor do të realizohet përmes emetimit të letrave shtetërore me vlerë, me të cilat do të sigurohet financim shtesë me kushte të favorshme, duke shfrytëzuar norma të ulëta të interesit dhe interesin e investitorëve. Me qëllim të optimizimit të pagesave dhe zvogëlimit të rrezikut për rifinancim, Ministria e Financave do të vazhdojë sa i përket emetimit të fletobligacioneve shtetërore me maturime më të gjata, me të cilat do të zvogëlohet rreziku për rifinancimin e borxhit. Me qëllim të menaxhimit efikas me borxhin publik, Ministria e Financave do monitorojë edhe mundësinë për pagesë të parakohshme të një pjese të borxhit, përkatësisht arritje të strukturës më të favorshme të maturimit, valutës dhe interesit të borxhit.

Tabela 4. Nevojat dhe burimet e financimit (në milionë denarë)

	Остварување 2020	2021*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*
Буџетско салдо	-53,867	-34,937	-32,659	-28,414	-25,338	-23,591	-22,494
Финансирање на дефицит	53,867	34,937	32,659	28,414	25,338	23,591	22,494
Приливи	95,695	78,290	44,141	77,792	56,153	80,183	105,065
Домашни извори	36,347	23,437	23,903	31,666	40,499	31,402	45,809
Странски извори	66,207	53,542	18,690	45,091	12,000	49,900	58,050
Депозити ("-" e kumulirane na сметka)	-6,859	1,311	1,548	1,035	3,654	-1,119	1,206
Одливи	41,828	43,353	11,482	49,378	30,815	56,592	82,571
Отплата по домашно задолжување	15,261	6,119	5,379	13,103	18,821	9,674	24,526
Отплата по странско задолжување	26,567	37,234	6,103	36,275	11,994	46,918	58,045
Меморандум:							
Нето домашно задолжување	21,086	17,318	18,524	18,563	21,678	21,728	21,283
Нето странско задолжување	39,640	16,308	12,587	8,816	6	2,982	5

Извор: Министерството за финансии и проекции на Министерството за финансии (*)

Realizim 2020

Saldoja buxhetore

Financimi i deficitit

Fluksi hyrës

Burime vendore

Burime të jashtme

Depozita ("-" është akumuluar në llogari)

Daljet

Pagesa sipas huamarrjes vendore

Pagesa sipas huamarrjes së jashtme

Memorandum:

Huamarrje e brendshme neto

Huamarrje e jashtme neto

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave

2.1.4 Masat ekonomike për ballafaqim me pasojat nga COVID-19

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi disa pako të masave ekonomike, të drejtuara kah ballafaqimi me pasojat negative mbi ekonominë të shkaktuara nga pandemia shëndetësore. Në kuadër të katër pakove të para, janë miratuar rreth 70 masa të ndryshme, me të cilat janë përfshirë dhe mbështetur subjektet dhe personat fizikë të goditura nga pandemia. Masa e pestë ekonomike përmban gjithsej 29 pako, të dedikuara kah qytetarët, kompanitë dhe për përmirësim të likuiditetit të ekonomisë. Pakoja e gjashtë ekonomike përfshin 7 masa me të cilat janë targetuar sektorët më të goditur nga kriza e koronës.

Të gjitha paketat e masave antikrize për mbështetje të ekonomisë në fokusin e vetë i kanë qytetarët, vendet e tyre të punës, sigurinë sociale, solidaritetin, krijimin e ambientit për kapërcim më të lehtë të pasojave ekonomike nga virusi i koronës dhe zbatimin e strategjisë së shpejtë dalëse kur kriza do të mbarojë për të vazhduar me trendet pozitive të ekonomisë së re zhvillimore të Maqedonisë.

Vlera e përgjithshme e masave të miratuara ekonomike është vlerësuar në 1.2 miliardë euro, përkatësisht rreth 10% të BPV-së, nga të cilat vlera e katër pakove të para të masave antikrize është rreth 1.02 miliardë euro, përkatësisht pakoja e katërt e masave ekonomike është 470 milionë euro, kurse vlera e përgjithshme e tre pakove të paraprahe është rreth 555 milionë euro. Vlera e pakos së pestë të masave ekonomike është rreth 160 milionë euro, kurse pakoja e gjashtë është me vlerë prej 17.8 milionë euro dhe ato janë në fazë të realizimit. Këto mjete financiare janë dedikuar kah qytetarët dhe ekonomia për të siguruar qëndrueshmërinë ekonomike stabile me potencial për rivitalizim.

Të gjitha masat e miratuara mund të ndahen në një prej 3 grupeve vijuese:

1. Masa që shkaktjnë shpenzime buxhetore, përkatësisht kanë implikime direkte fiskale,
2. Masa që shkaktjnë të ardhura të zvogëluara buxhetore, dhe
3. Masa që kanë ndikim ekonomik, dhe nuk kanë implikime fiskale.

Pakoja e parë

Pakoja e parë e masave ishte reagim i shpejtë i Qeverisë për situatën e re të krijuar dhe ishte drejtuar kah zbutja e goditjes së krizës shëndetësore mbi ekonominë. Pakoja përbëhej nga masa intervenuese të dedikuara kah mbrojtja dhe likuiditeti i vendeve të punës, të targetuar për qytetarët dhe kompanitë më të prekur nga kriza shëndetësore. Për këtë pako ishin të ndarë gjithsej 12.2 milionë euro. Të gjitha mjetet e realizuara ishin dedikuar kah ndërmarrjet, dhe ishin përfshirë edhe masa të caktuara për qytetarët, të cilët nuk kanë kërkuar mjete.

Pakoja e parë ishte fokusuar në reagimin e shpejtë ndaj krizës dhe masat e miratuara kryesisht ishin nga grupi i masave, të cilat shkaktuan zvogëlimin e të ardhurave buxhetore, si dhe nga grupi i masave, të cilat kanë ndikim ekonomik, por nuk kanë implikime fiskale. Të ardhurat e humbura për masat e këtij grupi janë vlerësuar në 5.5 milionë euro.

Me pakon e parë të masave ishte paraparë lirim nga pagesa e avanseve mujore për tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin për muajt nga marsi deri në korrik të vitit 2020 për subjektet me të ardhura të zvogëluara nga 30% në raport me periudhën e kaluar, me të ardhura të zvogëluara të vlerësuara prej 2.1 milionë euro, si dhe subvencionim të 50% të kontributeve për muajin prill, maj dhe qershor të vitit 2020 për të punësuar në kompanitë e sektoreve të goditura, me të ardhura të zvogëluara të vlerësuara prej 2.5 milionë euro. Gjithashtu, u shfryqzuan detyrimet doganore për çështje të caktuara, kurse u zvogëluar dhe interesi i vonuar i paracaktuar dhe interesi ndëshkues për detyrimet publike.

Për masat pa implikime fiskale, në pakon e parë u realizuan kredi pa interes në vlerë prej 5.5 milionë euro përmes Bankës Zhvillimore, të dedikuara për mbrojtje të likuiditetit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, aktiviteti ekonomik i së cilëve është më i goditur nga pandemia dhe për mbrojtje të vendeve të punës për kompanitë që kanë probleme me pagesën e pagave, ku janë përkrahur 737 ndërmarrje me 6.509 të punësuar. Përveç kredive pa interes, me pakon e parë u zvogëluar norma themelore të interesit të Bankës Popullore në nivel prej 1.75%, dhe u tjeshtësua edhe mënyra e lëshimit, transferimit dhe pranimit të faturës në formë elektronike.

Në kuadër të pakos së parë nuk u realizuan mjete për masat që shkaktuan shpenzime buxhetore, përkatësisht implikime direkte fiskale.

Pakoja e dytë

Pakoja e dytë e masave ekonomike përbëhej nga masa konkrete, të cilat kanë pasur impakt direkt mbi ekonominë reale dhe ndihmë direkte për çdo familje dhe individ në veçanti. Qëllimi ishte që t'i jepet mbështetje ekonomisë, të ruhen vendet e punës, të ruhet stabiliteti social dhe t'u ndihmohet qytetarëve të goditur nga kriza. Në kuadër të kësaj pakaje u alokuan 332.9 milionë euro.

Pjesa më e madhe e mbështetjes orientohej drejt masave të cilat nuk kanë implikime fiskale, para së gjithash mundësinë hyrëse për shtyrje dhe ristrukturim të pagesave të kredive për kompanitë dhe qytetarët për periudhë nga 3 deri 6 muaj. Gjithashtu, u siguruan 8 milionë euro për linjën e re kreditore pa interes nga Banka Zhvillimore, përmes së cilës u mbështetën 639 ndërmarrje me 11.325 të punësuar.

Për masat që shkaktuan shpenzime direkte buxhetore u ndanë 85.9 milionë euro. Masa më e rëndësishme në këtë grup ishte mbështetja e punëdhënësve për mbrojtje të vendeve të punës në vlerë prej 14.500 denarë (në nivel të pagës minimale) për të punësuar për pagesën e pagave për muajt prill, maj dhe qershor të vitit 2020, për kompanitë dhe ushtruesit e pavarur të veprimtarisë, të cilët kanë pasur zvogëlim të të ardhurave prej së paku 30%. Për këtë masë u alokuan 84 milionë euro, ku ishin përfshirë rreth 120.000 të punësuar.

Masa të tjera të këtij lloji ishin:

- Kompensim financiar për qytetarët, që mbetën pa punë në vlerë prej 50% nga paga mesatare e punëtorit me efekt fiskal prej rreth 900 mijë euro;
- Lehtësim i kriterëve me qëllim të zgjerimit të përfshirjes së shfrytëzuesve të ndihmës sociale me efekt fiskal prej rreth 450 mijë euro;
- Mbështetje për sportistët dhe artistët në vlerë prej 14.500 denarë për muajin prill dhe maj të vitit 2020 me efekt fiskal prej rreth 508 mijë euro.

Në kuadër të pakos së dytë nuk ka masa që ndikuan në zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore.

Pakoja e tretë

Pakoja e tretë e masave ekonomike orientohej drejt rigjallërimit të ekonomisë vendore përmes mbështetjes direkte të qytetarëve dhe ekonomisë. Po ashtu, përfshin masa afatshkurtra dhe afatmesme për rivitalizimin e ekonomisë vendore.

Masat nga pakoja e tretë kanë për qëllim:

- Nxitjen e konsumit privat të qytetarëve, me ç'rast krijohen kushte për jetesë më të mirë;
- Mbrojtjen e vendeve ekzistuese të punës dhe hapjen e vendeve të reja të punës;
- Rritjen e konkurrencës së kompanive në nivel vendor, rajonal dhe global;
- Aktivizimin intervenues të turizmit vendor;
- Promovimin e kulturave të reja bujqësore dhe mbështetjen e bujqve për vëllim dhe cilësi më të madhe të prodhimit vendor;
- Zhvillimin e veprimtarive ekonomike me vendosjen e IT si dhe aktiviteteve dhe veglave online;
- Stimulimin dhe rritjen e pagesave pa para të gatshme dhe online si instrument për zvogëlimin e ekonomisë joformale etj.

Për pakon e tretë u ndanë gjithsej 229.3 milionë euro, ku 122.4 milionë euro janë të dedikuara për personat fizikë, kurse 106.9 milionë euro janë të dedikuara për persona juridikë.

Për masat që shkaktojnë shpenzime direkte buxhetore janë planifikuar 143.3 milionë euro. Në këtë pako u përfshinë disa masa me vlerë të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore, para se të gjithash kartela pagesore me vlerë prej 9.000 denarë për të gjithë personat e papunë dhe kartela pagesore me vlerë prej 3.000 denarë për të rinjtë dhe personat e papunë me pagë neto më të vogël se 15.000 denarë në muaj. Vetëm për këtë masë u implementuan 28 milionë euro dhe u shpërndanë kartela pagesore për rreth 309.337 qytetarë.

Masa të tjera të këtij grupi janë:

- Mbështetje për sektorin privat për tregje të reja, konkurrencë dhe modernizim ku u implementuan 20 milionë euro me të cilat u mbështetën 400 kompani;
- Vauçer për turizmin vendor me vlerë prej 6.000 denarë për persona të papunë me pagë neto më të vogël se 15.000 denarë në muaj, me ç'rast u implementuan 16 milionë euro;
- Kartelë pagesore për subvencionim të 50% të naftës së gjelbër për bujqit, me ç'rast u implemntuan 4.6 milionë euro;
- Shpërblim për mjekët dhe personelin mjekësor në klinikat infektive dhe repartet me realizim të 890 mijë euro për 4.260 mjekë dhe personelin mjekësor;
- Kompensim për papunësi për persona që kanë humbur vendin e punës për shkak të COVID-19, me ç'rast u implementuan 2.5 milionë euro për 3.123 persona;
- Mbështetje financiare për të rinjtë deri në 3.000 denarë në formë vauçeri për kofinancim të trajnimeve IT dhe shkatësi dixhitale, ku u implementuan 12 milionë euro;
- Kofinancim i shpenzimeve për zejtarët për furnizim të mjeteve dhe repromaterialeve u implementuan 145 mijë euro për 225 zejtarë;
- Mbështetje për zhvillim të start-up prodhimeve vendore dhe shërbimeve përmes Fondit për inovacione, ku u implementuan 1.6 milionë euro për 88 projekte;

- Kofinancim i ngjarjeve dhe konferencave me 50% të mbështetjes financiare nga shteti më së shumti deri në 30.000 denarë, ku u implementuan 250 mijë euro;

Për masat që nuk kanë implikime fiskale në këtë pako u ndanë 86 milionë euro. Me këtë pako u miratuan kredi të favorshme me normë interesi prej 1.6% për kompanitë përmes Bankës Zhvillimore në kuadër të linjës kreditore të BEI në vlerë prej 50.9 milionë euro për 186 kompani. Po ashtu, përmes Bankës Zhvillimore u miratuan kredi pa interes për kompani në vlerë të përgjithshme prej rreth 28 milionë euro me të cilat u përkrahën 2.459 kompani me 17.747 të punësuar. Për mbështetjen e sektorit agrar u siguruan 5 milionë euro përmes Bankës Zhvillimore. Në pakon e tretë nuk ka masa që ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave buxhetore.

Pakaja e katërt

Pakaja e katërt e masave ekonomike ishte e dedikuar si ndihmë direkte për sigurimin ekonomik dhe social të qytetarëve si dhe për nxitjen e konsumit privat si stimulues i rritjes shoqërore. Në kuadër të kësaj pakoje u alokuan 472.1 milionë euro, ku për shpenzime direkte buxhetore u ndanë 293.4 milionë euro. Për mbështetje financiare për pagesën e pagave për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020 u implementuan 70 milionë euro ku mbështetjen e shfrytëzuan 13.042 kompani me 70.766 të punësuar. Për mbështetje financiare të kategorive të ndjeshme përmes pagesës së mjeteve financiare në llogarinë e transaksionit për konsum më të lartë dhe për zhvillim të veprimtarive ekonomike vendore u implelementuan 27.6 milionë euro për 254.646 shfrytëzues. U implementua edhe pjesa e kredisë nga Banka Botërore për mbështetje të sektorit shëndetësor dhe social në vlerë prej 68.4 milionë euro.

Masa të tjera që kanë tërhequr shpenzime direkte buxhetore janë:

- Mbështetje sa i përket blerjes së rrushit nga rekolta 2020 për të cilën u realizuan 7.7 milionë euro;
- Grante për 500 agjencione turistike për të cilat u implementuan 2 milionë euro;
- Grante për restorante për dasma në vlerë prej 3 deri në 10 mijë euro për të cilat u implelementuan 1 milionë euro;
- Grante për këndet e lojërave për fëmijë për të cilat u implementuan 2.5 milionë euro;
- Kthim i taksës turistike për vitin 2019 për 4.740 subjekte u implementuan 2 milionë euro;
- Mbështetje me paga për udhëheqësit turistikë për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020 përmes së cilës u implementuan mjete në vlerë prej 1.6 milionë euro.

Masat që shkaktojnë shpenzime të zvogëluara buxhetore u vlerësuan në vlerë prej rreth 28 milionë euro.

Masa më të rëndësishme të kësaj pakoje janë:

- Vonesa e pagesës së avanseve të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi të ardhurat personale deri në muajin mars të vitit 2021 për kompanitë dhe ushtruesit e veprimtarive që kanë zvogëlim të të ardhurave më shumë se 40%;
- Zvogëlimi i normës së TVSH-së për shërbimet e restoranteve dhe shërbimin e ushqimit dhe pijeve në 10%;
- Zvogëlimi i detyrimeve të importit për lëndë të para dhe repromateriale;
- Fundjavë pa TVSH;
- Zvogëlimi i interesit ndëshkues ditor për detyrimet publike;
- Vazhdimi i licencave të punës për diskotekat, klubet e natës si dhe për kompanitë nga komuniteti i transportit;
- Zvogëlimi i normës së TVSH-së për shërbimet dhe prodhimet zejtare nga 18% në 5%;
- Pranimi i shpenzimeve për sigurimin privat shëndetësor dhe testimin nga COVID-19 si shpenzime të pranuar etj.

Nga masat që nuk kanë implikime fiskale, janë paraparë 100 milionë euro kredi të favorshme nga Banka Zhvillimore. Po ashtu, u rrit grejs periudha për linjën kreditore pa interes COVID-1 dhe u mundësua edhe shtyerja shtesë e pagesës së kredive për kompanitë deri në fund të vitit 2020. U mundësua shtyerja e pagesës së TVSH-së pesë ditë pas parashtrimit të fletëparaqitjes së TVSH-së.

Pakaja e pestë

Pakaja e pestë e masave është në drejtim të vazhimit të masave nga katër pakot paraprake masave me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë dhe kthimit të normave të rritjes ekonomike para periudhës së fillimit të krizës. Pakoja e pestë e masave është dizajnuar me mbështetje direkte të ekonomisë dhe kompanive dhe me atë edhe mbështetje të qytetarëve për përmirësimin e standardit të jetesës dhe kushteve të punës.

Pakoja e pestë ekonomike përfshin gjithsej 29 masa, në vlerë prej rreth 160 milionë euro, nga të cilat implikimet direkte fiskale janë në vlerë prej 92 milionë euro.

Masat nga pakoja e pestë ekonomike janë sistematizuar në 4 shtylla kryesore:

- Mbështetje direkte financiare për kompanitë me qëllim të ruajtjes së vendeve të punës për qytetarët, që punojnë në sektorët që akoma kanë pasoja nga pandemia;
- Mbështetje financiare për likuiditetin e qytetarëve dhe sektorit privat me qëllim të ruajtjes dhe/ose rritjes së numrit të punëtorëve si dhe procesin e rimëkëmbjes së kompanive;
- Krijimi i mjedisit më të favorshëm afarist përmes redefinimit sistematik të tarifave doganore, zvogëlimi të detyrave të tjera parafiskale dhe lehtësimit tatimor dhe shtyerjes së disa detyrimeve publike;
- Mbështetje për qytetarët.

Masa më të rëndësishme të këtij grupi, me alokime më të mëdha të mjeteve financiare janë në vijim:

- Mbështetje financiare me paga për të punësuarit, në mënyrë graduale nga 14.500 deri në 21.776 denarë për muajin shkurt dhe mars të vitit 2021;
- Kredi me 0% interes përmes Bankës Zhvillimore për sektorët më të goditur nga sfera e turizmit, zejtarisë, hotelierisë, transportit, industrisë për organizim të ngjarjeve, institucioneve private shëndetësore etj;
- Skema e garantimit të kredisë përmes Bankës Zhvillimore në periudhë prill – tetor të vitit 2021;
- Formimi i Fondit për mbështetje të kompanive eksportuese përmes Bankës Zhvillimore;
- Shfuqizimi i normave doganore për 71 produkte dhe lëndë të para deri në fund të vitit 2021;
- Shfuqizimi dhe zvogëlimi i normave doganore për 31 lëndë të para dhe për produkte të mishit për kompanitë eksportuese deri në fund të vitit 2021;
- Mbështetje e kompanive eksportuese përmes revidimit të Tarifave doganore dhe harmonizimi me rregulloret e tregut të BE-së dhe tregjeve të vendeve anëtare të OBT-së;
- Kushte lehtësuese për 245 kompani që kanë marrëveshje aktive dhe të reja, të cilat do të investojnë në përputhje me Ligjin për mbështetje financiare të investimeve;
- Ndihmë kofinancuese për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për zhvillim teknologjik;
- Shlyerja e interesit të borxheve të qytetarëve ndaj institucioneve dhe ndërmarrjeve publike;

Pakoja e gjashtë

Pakoja e gjashtë e masave përfshin 7 masa me të cilat janë targetuar sektorët më të goditura nga kriza e koronës në vlerë prej 17.8 milionë euro, ku do të mbështeten 10.000 kompani, që do të punësojnë rreth 60.000 qytetarë. Pakoja e gjashtë e masave është në drejtim të mbështetjes së veprimtarive, që ishin plotësisht të mbyllura me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit korona gjatë muajit prill të vitit 2021, si dhe përmirësimi i likuiditetit të kompanive, që investojnë gjatë vitit 2021. Rreth 14.8 milionë euro nga mjetet e parapara do t'u destinohen ekskluzivisht kompanive nga sektori i hotelierisë dhe turizmit.

Pakoja e gjashtë i targeton subjektet dhe masat në vijim:

- Objektet hotelierike do të mbështeten me rreth 9.9 milionë euro, me përfshirje të rreth 6.000 subjekteve, që punësojnë 17.000 persona. Me këtë masë do t'u mbulohen 30% e të ardhurave, vlerë që llogaritet si mesatare nga të ardhurat mesatare mujore për periudhën e viteve 2019 dhe 2020. Përveç kësaj, të gjitha objektet e regjistruara hotelierike do të marrin 15.200 denarë mbështetje financiare për të punësuar, duke përfshirë datën 06.04.2021.
- Restorantet e kategorizuara për dasma, industria për organizim të ngjarjeve, këndet e lojërave, klubet e natës, pushimoret private për fëmijë, qendrat e fitnesit, fotografët dhe studiot fotografike do të mbështeten me 2.5 milionë euro. Në këto kategori përfshihen rreth 1.200 kompani dhe do t'u mbulohen 30% e të ardhurave, vlerë e cila do të llogaritet si mesatare nga të ardhurat mujore mesatare për periudhën e viteve 2019 dhe 2020 dhe gjithashtu do të marrin mbështetje prej 15.200 denarë për të punësuar, duke përfshirë datën 31.12.2020.
- Agjencitë turistike të kategorizuara do të mbështeten me 1.4 milionë euro. Përveç kësaj, agjencitë turistike me licencë A do të marrin deri në 5.000 euro, kurse agjencitë turistike me licencë B do të marrin deri në 2.000 euro.
- Muzikantët, anëtarët e asociacioneve të muzikantëve si dhe udhëheqësit e licencuar turistikë, që gjatë vitit 2020 kanë pasur të ardhura mesatare mujore neto nën 15.000 denarë do të marrin mbështetje financiare prej 30.750 denarë.
- Për kompanitë që e kanë riinvestuar fitimin nga viti 2020 do të destinohen rreth 2 milionë euro, masë e cila do të realizohet përmes Bankës Zhvillimore dhe do t'u ndihmojë kompanive për të rritur likuiditetin, për të realizuar planet e tyre të investimeve dhe të vazhdojnë me zhvillimin e tyre përmes subvencionit të normave të interesit.

- Mediat që emetojnë programe radiotelevizive do të mbështeten me linjë kreditore pa interes përmes Bankës Zhvillimore në vlerë prej 1 milionë euro.
- Për turistët e huaj që kanë qëndruar në vend do të mundësohen 50.000 PCR teste falas si mbështetje dhe ndihmë shtesë për veprimtarinë turistike dhe hotelierike vendore.

2.2. Buxheti i pushtetit lokal

Decentralizimi i kompetencave deri te pushtetet lokale dhe përmirësimi i kapacitetit të tyre është një nga prioritetet që dalin nga Partneriteti aderues i Republikës së Maqedonisë së Veriut me BE-në dhe Marrëveshja kornizë. Të gjitha komuna (përveç Plasnicës) nga viti 2012 i financojnë kompetencat e transferuara me bllok grante me të cilat përfundoi qasja në faza për transmetim dhe menaxhim me resurset materiale dhe financiare lidhur me kompetencat e transferuara në arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.


Kompetencat e ndërmarra në sfera të ndryshme nga ana e komunave e rritën kapacitetin administrativ dhe fiskal dhe i përforcuan kapacitetet për menaxhim me vëllim më të madh të mjeteve financiare. Me administrimin e sukseshëm dhe arkëtimin e të ardhurave vetanake vazhdon procesi i rritjes së të ardhurave vetanake të komunave dhe kapaciteti për menaxhim me mjetet, realizimi i kompetencave të transferuara dhe menaxhimi i mjeteve financiare dhe dhe resurseve të tjera të nevojshme për realizimin e tyre. Përveç kësaj, komunat në mënyrë të sukseshme administrojnë kompetenca të reja të menaxhimit me tokën ndërtimore, veprojnë me objekte të ndërtuara pa leje me sigurim përkatës të të ardhurave. Realizimi i sukseshëm i decentralizimit fiskal me qëllim të vendosjes së kornizës ligjore dhe institucionale në vetëqeverisjen lokale siguron njësi të pushtetit lokal të zhvilluara, përgjegjëse dhe funksionale si dhe nivelit të demokracisë lokale, i cili i afron qytetarët me institucionet e vetëqeverisjes lokale. Progesi në arritjen e qëllimeve të decentralizimit është i notuar si i sukseshëm nga disa institucione ndërkombëtare me ndihmën e të cilave në kuadër të shumë projekteve është përmirësuar sistemi i menaxhimit, kontrollit, transparencës dhe koordinimit të menaxhimit të reformave në vetëqeverisjen lokale.

Gjithashtu, qasja në tregun e kapitalit u bë më i kapshëm në bazë të kushteve më liberale dhe më transparente për huamarrje me çka rritet edhe interesi i komunave për financimin e projekteve investuese përmes huamarrjes. Në këtë drejtim, Qeveria siguroi linja kreditore nga institucionet financiare ndërkombëtare (Banka Botërore, BEI, KfW dhe BERZH) me të cilat realizohen investime të konsiderueshme edhe atë në: rekonstruim dhe rehabilitim të rrugëve lokale, rrugëve dhe urave, ndërtim dhe rekonstruim të ujësjellësve dhe rrjetave për ujëra atmosferike, përmirësim të higjienës publike dhe ngritje të efikasitetit energjetik në objekte publike komunale dhe rregullim hapësinor lokal.

Republika e Maqedonisë së Veriut në raport me nivelin e decentralizimit sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve në vitin 2020 (pjesëmarrje prej 5.3% të BPv-së), përfshihet në grupin e vendeve që kanë decentralizim mesatar. Më tej, krahasuar me vitin 2005 kur filloi procesi i transferimit të kompetencave dhe decentralizimit fiskal, të ardhurat e komunave u rritën për më shumë se gjashtë herë (në vitin 2005 realizim prej 5.9 miliardë denarë, në vitin 2020 mbi 36 miliardë denarë). Në të njëjtën periudhë, të ardhurat tatimore mbi të cilat komuna ka autonomi në arkëtim u rritën për më shumë se dy herë (Grafiku 15).

Grafiku 15. Të ardhura vetanake dhe të përgjithshme në periudhën 2005-2020 (në milionë denarë)

Графикон 15. Сопствени и вкупни приходи во периодот 2005-2020 година (во милиони денари)



Тë ardhura vetanake
Тë ardhura të përgjithshme
Burimi: Ministria e Financave

Komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut financohen nga burime vetanake të të ardhurave, grante nga Buxheti i RMV-së për kompetencat e transferuara në arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje nga zjarri, të ardhura që janë përcaktuar me ligje të veçanta, të ardhura nga tatime që paguhën në nivel qendror, transfere nga Buxheti i RMV-së dhe institucione të tjera, të ardhura nga donacione dhe kredi si dhe të ardhura të tjera.

Të ardhurat vetanake të komunave janë tatimet lokale (tatimi mbi pronë, tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratat, tamim mbi qarkullimin e patundshmërisë), taksa lokale të përcaktuara me ligj (taksa komunale, taksa administrative dhe taksa të tjera të përcaktuara me ligj), kompensimet lokale (kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore, kompensime për veprimtari komunale, kompensime për planet hapësinore dhe urbanistike), të ardhurat nga pronësia dhe të ardhurat e tjera të përcaktuara me ligj. Komunat marrin të ardhura në vlerë prej 3% nga arkëtimi i tatimit personal mbi të ardhurat personale nga pagat për persona fizikë me vendbanim të përhershëm në atë komunë dhe 100% të tatimit personal mbi të ardhurat për persona fizikë, që merren me veprimtari zejtare, të regjistruara në territorin e komunës.

Të ardhura shtesë sigurohen përmes granteve nga Buxheti i RMV-së edhe atë: të ardhura nga granti i TVSH-së (në vlerë prej 4.5% të TVSH-së së arkëtuar në vitin paraprak fiskal), transfere kapitale, grante të dedikuara dhe bllok grante për kompetencat e transferuara në arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje kundër zjarrit. Mjetet nga këto grante shpërndahen sipas kriterëve që janë përcaktuar me rregullore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Planifikimi joreal i buxheteve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht planifikimi tejoptimist i të ardhurave është një nga arsytet për shkak të të cilave njësitë e administrimit lokal krijuan detyrime të pashlyera gjatë viteve paraprake. Me qëllim të tejkalimit të kësaj situatë me ndryshimet e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale nga muaji nëntor të vitit 2018 u vendos rregulli fiskal për planifikimin e të ardhurave vetanake të buxhetit themelor të njësive të vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht planifikimi i të ardhurave vetanake në buxhetin themelor të komunës kufizohet me realizimin e të ardhurave të realizuara. Me ndryshimet e ligjit, të ardhurat vetanake të buxhetit bazë të komunave në të ardhmen do të planifikohen me rritje deri në 10% nga të ardhurat e realizura mesatare në tre vitet e fundit, sipas të dhënave të evidentuara të Thesarit. Po ashtu, janë paraparë përjashtime vetëm nëse komuna ka siguruar vërtetim për transfer të mjeteve nga institucioni përkatës. Gjatë vitit 2019 u miratua edhe një ndryshim sa i përket Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, me të cilin me kërkesë të komunave, dhe me qëllim të rritjes së fleksibilitetit gjatë planifikimit të Buxhetit të komunave dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimin e pozicionit fiskal të komunave, norma e përcaktuar paraprake e të ardhurave të planifikuara nga 10% u rrit në 30%. Me ndryshimin e fundit të Ligjit u përcaktua norma për rritjen e të ardhurave të planifikuara për vitin 2021 të jetë 50%.

Gjatë vitit 2020 u ruajt trendi i rritjes së granteve të dedikuara dhe bllok granteve për kompetencat e transferuara në sferën e arsimit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, kulturës dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Me qëllim që të sigurohen të ardhura stabile dhe të lehtësohet puna e komunave gjatë pandemisë COVID-19 për vitin 2021, Qeveria e RMV-së caktoi masë – Ndryshimi i përlogaritjes së bazës për financim të njësive të vetëqeverisjes lokale, me të cilën ndahen mjete për njësitë e vetëqeverisjes lokale, në vend të TVSH-së së arkëtuar për vitin e kaluar si deri më tani, do merret parasysh përlogaritja e mesatares së TVSH-së së arkëtuar për tre vitet paraprake fiskale. Në këtë drejtim me Ligjin për plotësimin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjeve lokale u

përcaktua se lartësia e të ardhurave nga TVSH-ja për vitin 2021 sigurohet në vlerë prej 4.5% nga mesatarja e arkëtuar e TVSH-së në tre vitet paraprake fiskale.

Me qëllim të avancimit të decentralizimit fiskal, në periudhën 2021-2024 janë paraparë disa aktivitete dhe masa, të cilat do të grupohen në tre shtylla edhe atë: I. Përmirësimi i kapacitetit fiskal dhe rritja e të ardhurave të komunave, II. Rritja e disiplinës fiskale dhe III. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në punën e tyre. Qëllimi final i këtij procesi është arritja e cilësisë më të lartë të shërbimeve publike, niveli më i lartë i zhvillimit ekonomik dhe përmirësimi i standardit jetësor.

Shtylla e parë i reformës ose Përmirësimi i kapacitetit fiskal dhe rritja e të ardhurave të komunave, do të realizohet përmes disa aktiviteteve të cilat parashohin rritje të mjeteve, që u shpërndahen komunave nga detyrimet e arkëtuara në buxhetin qendror, rritje e të ardhurave vetanake të komunave dhe formimi i fondeve me të cilat do të përkrahin performancën më të mirë. Në këtë drejtim do të diskutohet edhe për revidimin e metodologjisë për shpërndarjen e mjeteve të tatimit dhe granteve për komunat. Është planifikuar edhe rritja graduale e përqindjes që e marrin komunat nga të ardhurat e tatimit mbi të ardhurat personale, i paguar nga personat fizikë të regjistruar me vendbanim të përhershëm në atë komunë. Gjithashtu, gradualisht do të rritet edhe norma e granteve nga pagesa e TVSH-së sipas performancës së komunave. Planifikohet të formohen dy fonde – Fondi i performancës dhe Fondi i barazimit.

Gjithashtu, planifikohet që komunat të cilat tregojnë rezultate pozitive dhe kanë realizim më të lartë të të ardhurave vetanake të marrin mjete nga Fondi i performancës, kurse nga Fondi i barazimit të sigurohen mjete për komunat që kanë të ardhura më të ulëta, por gjithashtu, duhet të tregohet përpjekje fiskale dhe rezultate të mira në mbledhjen e të ardhurave vetanake.

Do të veprohen edhe kah rritja e të ardhurave vetanake të komunave përmes përmirësimit të efikasitetit të administratës, si dhe kah gjetja e të ardhurave vetanake lokale të reja sipas praktikave më të mira të BE-së dhe përmirësimi i kreteve për shpërndarjen e mjeteve të ndara për kompetencat e transferuara në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së personave të moshuar dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Shtylla e dytë, që është në drejtim të rritjes së disiplinës fiskale të komunave, zvogëlimit të borxheve dhe menaxhimit në mënyrë ekonomike parashihet aktivitete në drejtim të masave për planifikim real të të ardhurave dhe shpenzimeve të komunave, racionalizim të punës dhe zvogëlim të shpenzimeve të panevojshme, servisim të rregullt të detyrimeve, rritje të disiplinës financiare, procedurave për shpallje të jostabilitetit ekonomik, lëshim të fletobligacioneve komunale dhe analizë të detyrimeve ekzistuese të komunave dhe ndërmarrjeve publike.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, gjegjësisht në kuadër të shtyllës së tretë për avancim të decentralizimit fiskal do të rritet kontrolli nga ana e shtetit, gjegjësisht nga ana e inspeksionit financiar në drejtim të Ligjit për paraqitjen dhe regjistrimin e detyrimeve dhe paraqitje për mosrespektimin e Ligjit për disiplinë financiare, do të ndërmerren masa për rritjen e transparencës së komunave përmes publikimit të raporteve financiare në mënyrë transparente dhe koncize dhe do të veprohet në drejtim të rritjes së llogaridhënies më të madhe për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Një nga prioritetet e Qeverisë së RMV-së është vazhdimi i procesit të decentralizimit në drejtim të demokratizimit më të madh, shërbimeve më të mira (më cilësore dhe të llojllojshme) dhe zhvillimit të përfortuar lokal në interes të qytetarëve. Po ashtu, në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë politikat për zhvillim të komunave, përkatesisht decentralizim fiskal dhe zhvillim të barabartë rajonal, me qëllim të përfortimit të burimeve financiare të komunave, por njëherit edhe rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës së punës së tyre, ashtu që komunat të jenë edhe më afër qytetarëve.

Pas rimëkëmbjes ekonomike nga pasojat e shkaktuara nga pandemia COVID-19 parashihen masa dhe politika për rritje të përsheptuar, inkluzive dhe të qëndrueshme ekonomike, që do orientohen në menaxhimin e mirë – gjegjësisht, sundimin e ligjit, luftimin kundër korrupsionit dhe ngritjen e kapacitetit të institucioneve. Këtu përfshihen edhe masat për nxitjen e decentralizimit fiskal, sigurimin e zhvillimit lokal dhe të barabartë rajonal, një mjedis jetësor më të pastër dhe më të qëndrueshëm dhe dixhitalizimin e ekonomisë dhe shërbimeve publike.

2.2.1 Realizimi në periudhën janar – prill 2021

Realizimi i të ardhurave dhe fluksit të hyrës në buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale në periudhën janar – prill 2021 është 12.580 milionë denarë dhe krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar u shënuar rritje e konsiderueshme prej 15.8%. Nga kjo vlerë 3.130 milionë denarë janë të ardhura tatimore, që evidentojnë rritje e konsiderueshme prej 37.6% në raport me vitin e kaluar. Në periudhën nga viti 2021 realizimi i të ardhurave nga tatimet e pronës është 1.256 milionë denarë dhe është konstatuar rritje prej 40.1%. Te tatimet e të ardhurave është konstatuar rritje e lehtë prej 4.2% të të ardhurave nga tatimet e shërbimeve specifike shënojnë rritje të konsiderueshme prej 55.1%, kurse tatimet për shfrytëzim ose lejet për kryerjen e veprimtarive janë në nivel përafërsisht të njëjtë në krahasim me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar, gjegjësisht rritje e lehtë prej 0.5%.

Në periudhën e analizuar, të ardhurat jotatimore janë 363 milionë denarë dhe janë përafërsisht në nivel të njëjtë me periudhën kohore nga viti 2020 me rritje të lehtë prej 0.9%. Në kuadër të të ardhurave jotatimore dominon fluksi hyrës nga tatimet dhe kompensimet në vlerë prej 227 milionë denarë dhe paraqesin zvogëlim prej 12.3% në raport me periudhën e realizuar nga viti i kaluar, kurse të ardhurat jotatimore të tjera janë 107 milionë denarë, kështu që është konstatuar rritje prej 38.9%.

Në periudhën janar – prill të vitit 2021, të ardhurat kapitale janë realizuar në vlerë prej 657 milionë denarë dhe është konstatuar rritje prej 80.5% në krahasim me vitin e kaluar. Rritja kryesisht është si rezultat i situatës së përkeqësuar të shkaktuar nga pandemia me COVID-19, dhe aktiviteti i zvogëluar ekonomik në gjysmën e parë të vitit 2020, por njëkohësisht thekson atë se gjatë vitit 2021 gradualisht do të kthehet aktiviteti ekonomik dhe rimikëmbja e ekonomisë që rezulton edhe me përmirësimin e arkëtimit të të ardhurave. Të ardhurat kapitale pothuajse në përgjithësi përbëhen nga të ardhurat e shitjes së tokës dhe investimeve jomateriale.

Të ardhurat nga grantet në periudhën e analizuar nga viti 2021 janë 6.365 milionë denarë, gjegjësisht shënojnë rritje prej 1.1%. Të ardhurat nga transferet në periudhën janë – prill 2021 janë realizuar me vlerë 1.299,9 milionë denarë, që është për 31.8% ose për 313 milionë denarë më e lartë në raport me periudhën e realizuar vitin e kaluar.

Në periudhën janar – prill 2021 janë realizuar të ardhura nga donacionet në vlerë prej 415 milionë denarë, gjegjësisht të njëjtat janë rritur oër 8.9% në krahasim me vitin e kaluar.

Në periudhën janar – prill 2021 të ardhurat nga kreditë janë realizuar në vlerë prej 351 milionë denarë dhe krahasur me periudhën e njëjtë shënojnë rritje të konsiderueshme për 70.7%.

Shpenzimet e realizuara për periudhën janar – prill 2021 janë 11.746 milionë denarë dhe krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar janë më të larta për 7.8%. Me këto shpenzime shlyhen detyrimet e ndërrmarra në përputhje me kompetencat e transferuara të komunave të nevojshme për punën e vazhdueshme, realizimin e projekteve kapitale dhe pagesën e kryegjësë për kreditë paraprake.

Në strukturën e shpenzimeve pjesëmarrje më të lartë me 52.9%, gjegjësisht 6.216 milionë denarë kanë shpenzimet për paga dhe kompensime. Pjesa më e madhe e pagave, gjegjësisht 85.4% ose 5.354 milionë denarë u dedikohen të punësuarve në institucionet në nivel lokal nga shkollat fillore dhe të mesme, kultura, kopshtet e fëmijëve dhe shtëpitë e moshuarve dhe mbrojtja kundër zjarrit, me ç'rast 99.2% janë financuar me bllok grante. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë 2.250 milionë denarë dhe marrin pjesë me 19.2% nga shpenzimet e përgjithshme. Shpenzimet kapitale marrin pjesë me 19.7% dhe janë 2.313 milionë denarë, që në përqindje më të madhe, gjegjësisht 79.1% janë financuar me mjete vetanake të komunës, 3.9% janë mjete të marra nga donacionet dhe 14.6% janë kredi. Shpenzimet për subvencione dhe transfere janë 684.8 milionë denarë dhe marrin pjesë me 5.8% dhe pagesa e kryegjës është 225.9 milionë denarë ose 1.9% të shpenzimeve të përgjithshme. Shpenzimet e realizuara nga rezervat, benefitet sociale dhe pagesat e normës së interesit marrin pjesë me rreth 0.5%.

2.2.2 Korniza afatmesme për buxhetin e pushtetit lokal

Një ndër prioritetet që është theksuar në Programin e Qeverisë së RMV-së për periudhën 2020-2024 është vazhdimi i procesit të decentralizimit. Kjo synon të sigurojë demokratizim shtesë të shoqërisë, sigurim efikas dhe më ekonomik dhe ofrim të shërbimeve, por edhe zhvillim lokal të përfurcuar.

Qëllimi është transferimi i kompetencave në nivel të menaxhimit që është më afër qytetarëve, për realizimin e tyre në mënyrë efikase, me mjete përkatëse financiare dhe përfshirje të garantuar të qytetarëve në miratimin e vendimeve. Në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me politikat për zhvillimin e komunave, gjegjësisht, decentralizimin fiskal dhe zhvillimin e barabartë rajonal me qëllim të përfurcimit të burimeve financiare të komunave, por njëkohësisht edhe rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës për punën e tyre.

Gjatë vitit 2021 dhe në periudhë afatmesme dhe me qëllim të avancimit të decentralizimit fiskal parashihen disa aktivitete dhe masa, të cilat grupohen në tre shtylla, dhe ato janë: përmirësimi i kapacitetit fiskal dhe rritja e të ardhurave të komunave, rritja e disiplinës fiskale dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies për punën e tyre.

Komunat pritet që të vazhdojnë me arkëtimin më të mirë të të ardhurave vetanake, përfurcimin e kapaciteteve për zhvillimin e politikave për financimin e komunave dhe përfurcimin e kapaciteteve për menaxhim financiar. Për arritjen e qëllimeve strategjike edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojë përkushtimi i fuqishëm i realizimit për nxitje të zhvillimit të qëndrueshëm lokal, qeverisjes së mirë lokale dhe krijimit të kushteve për rol më aktiv, më efikas dhe më inovativ të vetëqeverisjeve lokale në realizimin e qëllimeve nacionale për rritje dhe zhvillim.

Në drejtim të përmirësimit të kapacitetit fiskal dhe rritjes së të ardhurave të komunave janë paraparë disa aktivitete me të cilat do të sigurohet rritja e mjeteve, që u shpërndahen komunave nga buxheti qendror, rritja e të ardhurave vetanake dhe formimi i fondeve të cilat do të përkrahin punën e mirë të komunave. Është planifikuar rritje graduale e përqindjes që e marrin komunat nga të ardhurat e tatimit mbi të ardhurat personale, të arkëtuar nga personat fizikë të regjistruar me vendbanim të përhershëm dhe vendqëndrim në atë komunë. Po ashtu, gradualisht do të rritet edhe norma e granteve nga TVSH-ja e arkëtuar. Deri në fund të vitit 2021 do të hartohen modele për

shpërndarjen e një pjese të të ardhurave nga TVSH-ja, që u shpërndahet komunave dhe formimi i Fondit të barazimit dhe Fondit të performancës.

Komunat që kanë arritur rezultate pozitive dhe kanë realizim më të lartë të të ardhurave vetanake do të marrin mjete nga Fondi i performancës, kurse nga Fondi i barazimit do të sigurohen mjete për komunat që kanë të ardhura më të ulëta, por që kanë treguar përpjekje fiskale dhe rezultate të mira në mbledhjen e të ardhurave vetanake.

Përmes përmirësimit të efikasitetit të administratës dhe gjetjes së të ardhurave të reja lokale do të veprohet në drejtim të rritjes së të ardhurave vetanake. Në bashkëpunim me ministritë përkatëse, të cilat transferojnë mjete si bllok grante dhe grantee të dedikuara për kompetencat e transferuara në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes së personave të moshuar dhe mbrojtjes kundër zjarrit do të punohet në përmirësimin e kriterëve për shpërndarjen e mjeteve të dedikuara dhe sigurimin e cilësisë më të mirë të shërbimeve. Nga ana e Qeverisë së RMV-së është formuar Grupi i punës ndër-resorcial për tejkalimin e problemeve për mbrojtje kundër zjarrit dhe analizë të situatave në këtë sferë në të cilat ndahet granti i dedikuar. Në periudhën e ardhshme do të veprohet në ndryshimin e Ligjit për zjarrfikje, veçanërisht në pjesën e rregullimit të mëtejshëm të pagave dhe kompensimeve të zjarrëfikësve, si dhe në përcaktimin e numrit të nevojshëm të zjarrëfikësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj.

Në periudhën e ardhshme afatmesme është paraparë përcaktimi i trguesve për monitorim të decentralizimit fiskal, rritje të efikasitetit për arkëtimin e tatimeve lokale, përmirësim të efikasitetit të profitabilitetit të ndërmarrjeve publike në komuna, si dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies së komunave.

Rritja e disiplinës financiare të komunave, zvogëlimi i borxheve dhe puna në mënyrë ekonomike do të jenë prioritetet në periudhën e ardhshme dhe do të ndërmerren masa për planifikim real të të ardhurave dhe shpenzimeve të komunave, racionalizim në punë dhe zvogëlim të shpenzimeve të panevojshme, servisim të rregullt të detyrimeve, disiplinë financiare më të lartë, përmirësim të procedurave për shpalljen e jostabilitetit financiar dhe analizë të detyrimeve ekzistuese të komunave dhe ndërmarrjeve publike lokale.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe avancimit të decentralizimit fiskal, do të rritet kontrolli nga ana e shtetit, gjegjësisht nga ana e Inspeksionit financiar në sektorin publik në drejtim të Ligjit për paraqitje dhe evidencë të detyrimeve dhe paraqitje për mosrespektim të Ligjit për disiplinë financiare, do të ndërmerren masa për rritjen e transparencës së komunave përmes publikimit të raporteve financiare në mënyrë transparente dhe koncize dhe do të veprohet në drejtim të rritjes së llogaridhënies më të madhe për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Veçse ka filluar procesi i konsultimeve publike dhe debati me BNJVL-në dhe palët e tjera të interesuara rreth propozimeve për reformë, dhe në koordinim me Grupin e punës për vazhdimin e procesit të decentralizimit, i formuar nga ana e Qeverisë, në të cilin do të marrin pjesë: Ministria e Sistemit Politik, Ministria e Financave, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe BNJVL-ja. Një nga prioritetet qeveritare është vazhdimi i procesit të decentralizimit në drejtim të demokratizimit më të madh, përmirësimit të shërbimeve publike dhe përforsimit të zhvillimit lokal në interes të qytetarëve.

Të ardhura stabile janë siguruar me shpërndarje të mjeteve nga qiraja e tokës bujqësore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave edhe atë në raport 50% për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 50% për komunat dhe komunat në Qytetin e Shkupit, që janë shpërndarë nga viti 2018, në varësi të lokacionit të tokës bujqësore, e cila është subjekt i dhënies me qira, me kusht që realizimi i të ardhurave nga tatimi mbi pronën e patundshme të realizohet mbi 80% në raport të të ardhurave të planifikuara nga viti paraprak. Rritja e të ardhurave vetanake të komunave do të realizohet me kompensimin që do të paguhet nga dhënia e koncesioneve për shfrytëzim të resurseve ujore për prodhimin e energjisë elektrike në raport prej 50% për buxhetin qendror dhe 50% për pushtetet lokale, në varësi të rajonit ku kryhet veprimtaria koncesionare.

Rritja e të ardhurave vetanake të komunave, veçanërisht të ardhurat nga tatimet mbi pronën e patundshme me përfshirje më të mirë të bazës tatimore të personave fizikë dhe subjekteve juridike dhe me rivlerësim të vlerës së pronës së patundshme. Në periudhën e ardhshme pritet të realizohen të ardhura më të larta me përcaktim real të vlerës së pronës së patundshme pas mbarimit të procedurës për objektet e ndërtuara pa leje dhe tokën ndërtimore dhe bujqësore. Rritja e normës së tatimit sa i përket pronave me vlerë të lartë, mund të jetë burim shtesë i të ardhurave, pasi me rritjen e normës është thelbësore që të ofrohen kapacitete për vlerësim dhe revizion me qëllim të shmangies së deklarimit të pasurisë me vlerë më të ulët.

Në periudhën e ardhshme pritet të realizohen të ardhura më të larta me përcaktimin e vlerës reale tregtare të pronës së patundshme pas mbarimit të procedurës për objektet e ndërtuara pa leje në tokën bujqësore dhe ndërtimore. Në vijim, komunat do të vazhdojnë të ushtrojnë në pjesën e kompetencave të transferuara për menaxhimin e tokës ndërtimore dhe trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje në tokën ndërtimore dhe bujqësore, për të cilat janë përcaktuar edhe burimet adekuate të të ardhurave të buxhetit të komunës.

Në periudhën e ardhshme afatmesme pritet implementimi i Ligjit të ri për zhvillim të barabartë rajonal dhe Strategjisë së re për zhvillim të barabartë rajonal për periudhën 2020-2030. Qeveria e RMV-së në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me aktivitetet për zhvillim të barabartë rajonal dhe përparim në të gjitha rajonet e vendit. Zbatimi i Strategjisë për zhvillim të barabartë rajonal në RMV-në 2020-2030 në tetë rajone të planifikimit (rajoni i Vardarit, Lindor, Jugperëndimor, Juglindor, i Pellagonisë, i Pollogut, Verilindor dhe i Shkupit) me koordinim më të mirë

vertikal dhe horizontal të politikave nacionale dhe lokale dhe zhvillim të integruar të projekteve të adaptuara për nevojat dhe kushtet lokale do të sigurohet zhvillim lokal më i balancuar dhe i determinuar territorialisht. Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal edhe më tej do të ketë rol të rëndësishëm si nxitës i partneritetit ndërmjet rajoneve/komunave dhe Qeverisë dhe në kuadër të tij do të koordinojë shfrytëzimin e mjeteve nga të gjitha programet sektoriale të dedikuara për rajonet e planifikimit dhe komunat. Përpjekje të veçanta do të bëhen për përkrahjen e komunave me nxitjen e zhvillimit lokal përmes përkrahjes së projekteve lokale dhe harmonizimin e tyre me ato nacionale. Qëllimi i barazimit fiskal në kontekst të Strategjisë për zhvillim rajonal është të sigurohet ofertë e njëjtë e shërbimeve dhe të mirave publike të të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, duke arritur gjithashtu, efekt komplementar të arritjes së baraspeshës më të lartë të zhvillimit të rajoneve të caktuara të planifikimit. Duke ndihmuar në mënyrë solidare komunat financiarisht më të dobëta, gjegjësisht komunat me kapacitet më të ulët për mbledhjen e të ardhurave do të ndikojë në mënyrë pozitive mbi zhvillimin e tyre, por njëkohësisht edhe mbi zhvillimin e rajonit të planifikimit ku takojnë.

Është miratuar Programi për zhvillim të qëndrueshëm rajonal dhe decentralizim për periudhën 2021-2026 dhe parashihet Plani aksional sa i përket Programit për zhvillim të qëndrueshëm rajonal dhe decentralizim për periudhën 2001-2016, si dhe për periudhën 2021-2023.

Njëkohësisht, grupi punues sektorial për zhvillim rajonal dhe lokal ka për obligim të zbatojë detyra në nivel ekspertësh, të lidhur me formulimin dhe implementimin e politikave nacionale sektoriale, duke përfshirë edhe ato në lidhje me integrimet në BE dhe ndihmën e donatorëve në tërësi dhe programin IPA.

Përveç përkrahjes në lidhje me transferin e kompetencave për pagesë të një pjese të të ardhurave publike, si dhe transfereve nga buxheti qendror, ndihma në ndërtimin e kapaciteteve komunale do të realizohet edhe përmes projekteve të pushtetit qendror të financuara përmes institucioneve ndërkombëtare financiare.

Projekti për përmirësimin e shërbimeve komunave (MSIP), të cilin e realizon Ministria e Financave me përkrahje nga Banka Botërore dhe Komisioni Evropian filloi para një dekade, fondi i tij i përgjithshëm është mbi 100 milionë euro dhe ka për qëllim që të përmirësojë shërbimet komunale përmes huave dhe granteve për komunat për realizimin e projekteve kapitale si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, efikasiteti energjetik (ndriçimi rrugor, izolimi i objekteve komunale dhe etj.), infrastruktura rrugore lokale (modernizimi dhe rekonstruimi i rrugave dhe rrugëve), shërbimet komunale (furnizimi me automjete për ndërmarrjet komunale publike), si dhe shërbime dhe kompetenca të tjera komunale (ndërtimi i çerdheve për fëmijë, tregje të gjelbra, infrastrukturë në zonat industriale etj.).

Përmes Projektit për rrugë lokale, i cili është pjesë nga Korniza rrjedhëse për bashkëpunim me Bankën Botërore dhe realizohet përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, shtatëdhjetë milionë euro janë destinuar t'u shpërndahen 80 komunave për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve dhe rrugicave lokale si dhe në infrastrukturë tjetër rrugore në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Me ndihmën direkte prej 500.000 eurove deri në 2 milionë euro për komunë (në varësi të projektit me të cilin do të aplikojnë), do të veprohet në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës lokale në komuna.

Në periudhën e ardhshme do të fillojë realizimi i Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, i cili do të zbatohet përmes Ministrisë së Financave me përkrahje të Bankës Botërore me Marrëveshje të huasë me fond të përgjithshëm prej 10.5 milionë euro. Projekti për efikasitet energjetik në sektorin publik do të realizohet përmes Njesisë projektuese për përmirësimin e shërbimeve komunave – MSIP. Qëllimi kryesor për realizimin e këtij projekti është zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorin publik, njëkohësisht përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së objekteve publike dhe ndriçimit publik. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë të drejtë të përdorimit të mjeteve nga ky komponent. Vlera e huasë për një vetëqeverisje lokale mund të jetë nga 50 mijë deri në 750 mijë euro dhe e njëjta varet nga kapaciteti i lirë huamarrës i komunës dhe vlera e vlerësuar e projektit të propozuar të komunës. Me nënshkrimin e marrëveshjes me Ministrinë e Financave, 80% nga këto mjete komuna do t'i marrë si nënhua, kurse pjesa tjetër prej 20% si grant. Njëkohësisht, nga ana e Ministrisë së Financave, në kuadër të mjeteve të siguruara për projektin, do të mbulohen edhe shpenzimet për përgatitjen e revizionit energjetik dhe dokumentacionit teknik të projekteve.

Një tjetër projekt i madh që është realizuar në dhjetë vitet e kaluara, në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës komunale është "Furnizimi me ujë dhe largimi i ujërave të zeza", i financuar përmes Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), Bankës Botërore, KfW, IPA dhe mjeteve buxhetore, dhe i implementuar përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve. Të gjitha komunat janë përkrahur me mjetet në vlerë prej 100 milionë euro për ndërtimin e infrastrukturës më të mirë, furnizimit me ujë dhe stacioneve filtruese. Ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen përmes Ministrisë së Mjedisit Jetësor, me fond shtesë të mjeteve për përkrahje të avancimit të infrastrukturës lokale.

Tabela 5. Projektioni afatmesëm lidhur me Buxhetin e pushtetit lokal (në milionë euro)

	2021*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*
Вкупни приходи	42,000	44,920	45,966	47,050	50,944	54,748
Даночни приходи	10,905	11,240	11,505	11,770	12,410	12,850
Неданочни приходи	2,466	2,689	2,689	2,689	2,739	2,839
Капитални приходи	3,098	3,150	3,200	3,250	3,600	4,000
Трансфери	23,666	25,791	26,522	27,291	30,145	33,009
Донации	1,865	2,050	2,050	2,050	2,050	2,050
Вкупни расходи	43,583	44,920	45,966	47,050	50,944	54,748
Плати и надоместоци	19,365	19,284	19,334	19,384	19,434	19,641
Стоки и услуги	10,238	10,470	10,570	10,870	12,170	13,338
Каматни плаќања	61	61	61	61	61	61
Субвенции и трансфери	2,810	3,480	3,681	3,681	3,681	3,681
Социјални трансфери	56	61	61	61	61	61
Капитални расходи	11,053	11,564	12,259	12,993	15,537	17,966
Салдо	-1,583	0	0	0	0	0

Извор: Проекции на Министерство за финансии (*)

Тë ardhura të përgjithshme

Тë ardhura tatimore
Тë ardhura jotatimore
Тë ardhura kapitale
Transfere
Tatime

Spenzime të përgjithshme

Paga dhe kompensime
Mallra dhe shërbime
Pagesa të interesit

Subvencione dhe transfere
Transfere sociale
Shpenzime kapitale

Saldoja

Burimi: Projekcione të Ministrisë së Financave (*)

2.3 Buxheti i qeverisë (buxheti i konsoliduar i RMV-së dhe buxheti i komunave)

Buxheti i qeverisë përfshin të dhënat e konsoliduara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe buxhetet e komunave. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut përbëhet nga buxheti qendror (buxheti themelor, buxheti i aktiviteteve vetëfinancuese, mjetet nga donacionet dhe mjetet nga huatë) dhe buxhetet e fondeve për sigurim pensional, sigurim shëndetësor dhe Agjencisë së Punësimit.

Të ardhurat e parashikuara të Buxhetit të Qeverisë, si përqindje e pjesëmarrjes në PBB, janë planifikuar në nivel prej 32.2% në pesë vitet e ardhshme (Tabela 6). Si rezultat i vazhdimësisë në zbatimin e politikës së disiplinuar buxhetore, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të konsoliduar në periudhën 2022-2026 janë planifikuar të zvogëlohen nga 37.8% në vitin 2022 në 36% në vitin 2026. Rrjedhimisht dhe në përputhje me konsolidimin gradual fiskal, deficitin buxhetor i qeverisë do të zvogëlohet nga 4.3% e PBB-së në vitin 2022 në 2.2% të PBB-së në vitin 2026.

Табела 6. Буџет на општа влада

	милиони денари						% од БДП					
	2021*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Централен буџет												
Приходи	118,889	131,948	144,882	161,711	177,214	194,149	16.8	17.5	17.9	18.6	18.8	19.1
Расходи	153,819	164,600	173,288	187,040	200,797	216,634	21.8	21.8	21.4	21.5	21.3	21.3
Буџетско салдо	-34,930	-32,652	-28,406	-25,329	-23,583	-22,485	-4.9	-4.3	-3.5	-2.9	-2.5	-2.2
Буџетски фондови												
Приходи	70,750	75,778	80,169	84,823	89,756	94,986	10.0	10.1	9.9	9.7	9.5	9.3
Расходи	70,758	75,786	80,177	84,831	89,764	94,994	10.0	10.1	9.9	9.7	9.5	9.3
Буџетско салдо	-8	-8	-8	-8	-8	-8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Буџет на РСМ (Централен буџет и фондови)												
Приходи	189,639	207,726	225,051	246,534	266,970	289,135	26.8	27.6	27.8	28.3	28.3	28.4
Расходи	224,577	240,386	253,465	271,871	290,561	311,628	31.8	31.9	31.3	31.2	30.8	30.6
Буџетско салдо	-34,938	-32,660	-28,414	-25,337	-23,591	-22,493	-4.9	-4.3	-3.5	-2.9	-2.5	-2.2
Буџет на локална власт												
Приходи	41,086	44,920	45,966	47,050	50,944	54,748	5.8	6.0	5.7	5.4	5.4	5.4
Расходи	42,859	44,920	45,966	47,050	50,944	54,748	6.1	6.0	5.7	5.4	5.4	5.4
Буџетско салдо	-1,773	0	0	0	0	0	-0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Буџет на општа влада (Консолидиран)												
Буџет на РСМ и Буџет на општини												
Приходи	230,725	252,646	271,017	293,584	317,914	343,883	32.7	33.5	33.5	33.7	33.7	33.8
Расходи	267,435	285,305	299,430	318,922	341,504	366,376	37.8	37.8	37.0	36.6	36.2	36.0
Буџетско салдо	-36,710	-32,659	-28,413	-25,338	-23,590	-22,493	-5.2	-4.3	-3.5	-2.9	-2.5	-2.2

Извор: Министерството за финансии и проекции на Министерството за финансии (*)

Tabela 6. Buxheti i qeverisë

në milionë denarë

% e BPV-së

Buxheti qendror

Të ardhura
Shpenzime
Saldoja buxhetore

Fonde buxhetore

Të ardhura
Shpenzime
Saldoja buxhetore

Buxheti i RMV-së (Buxheti qendror dhe fondet)

Të ardhura
Shpenzime
Saldoja buxhetore

Buxheti i pushtetit lokal

Të ardhura
Shpenzime
Saldoja buxhetore

Buxheti i qeverisë (Buxheti i konsoliduar i RMV-së dhe Buxheti i komunave)

Të ardhura
Shpenzime
Saldoja buxhetore

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave (*)

3. Aspekte të tjera dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike

3.1 Ligji për buxhete

Ligji i ri për buxhete, i cili është në procedurë parlamentare, ofron kornizë me të cilën është përcaktuar sistemi i menaxhimit të financave publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën e kaluar, Ministria e Financave, në bashkëpunim me ekspertë të institucioneve ndërkombëtare, i ka kushtuar vëmendje të madhe zhvillimit të një koncepti bashkëkohor për menaxhimin e financave publike të hartuar përmes Ligjit të ri për buxhete.

Buxheti është një nga instrumentet më të rëndësishme të politikës ekonomike. Prandaj, Ligji për Buxhetin, i cili përcakton procedurat për përgatitjen dhe miratimin e këtij dokumenti ka rëndësi të njëjtë.

Ligji ekzistues për buxhete është që nga viti 2005, me disa ndryshime dhe riprecizime shtesë dhe rregullon procedurat për përgatitjen, miratimin dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit, si dhe raportimi për realizimin e buxhetit. Megjithatë, trendet, rekomandimet dhe direktivat e reja kërkojnë zgjidhje të reja për menaxhimin e financave publike, në përputhje me praktikën e mira të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Me këtë ligj rregullohet procedura për përgatitjen, miratimin, realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetit të Shkupit dhe raportimin për realizimin e tyre. Ligji rregullon rregullat fiskale dhe parimet fiskale, formimin e Këshillit fiskal, planifikimin afatmesëm të buxhetit, menaxhimin e mjeteve shtetërore dhe komunale, si dhe monitorimin e rezultateve financiare të ndërmarrjeve dhe shoqërive publike të themeluara nga shteti dhe komunat, si dhe shoqëritë tregtare të themeluara, si dhe përgjegjësia fiskale dhe baza për vendosjen e sistemit të integruar informativ për menaxhimin e financave publike.

Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe përforsimi i buxhetimit afatmesëm për 5 vitet e ardhshme është një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Me këtë zgjidhje ligjore vazhdon përcaktimi për planifikim strategjik, duke ofruar një kornizë afatmesme të financave publike, gjegjësisht planifikim buxhetor afatmesëm dhe përforsim të procesit nëpërmjet të prezantimit të deklaratës së politikës fiskale në Kuvend gjatë mandatit të qeverisë e cila do t'i përfshijë udhëzimet e strategjisë fiskale përmes projeksioneve reale makroekonomike dhe fiskale (të ardhurat dhe shpenzimet) sipas të dhënave më të fundit statistikore në dispozicion dhe të dhënave të tjera përkatëse.

Përveç kësaj, për përgatitjen e Strategjisë fiskale është planifikuar zhvendosja e kornizës kohore nga struktura ekzistuese si dhe përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së strategjisë.

Buxheti për vitin 2021 ka hedhur tashmë disa nga bazat e kornizës fiskale afatmesme për periudhë 5-vjeçare me projeksione për rritje, deficit dhe projekte kapitale.

Buxheti do të ketë një pasqyrë më të mirë, përmes një numri më të madh të informacioneve që do të prezantohen dhe do të strukturohen më mirë dhe do të ndahet në pjesë të përgjithshme, të veçantë dhe zhvillimore. Në pjesën e përgjithshme do të jepen të gjitha hyrjet dhe daljet nga buxheti për vitin fiskal përkatës. Pjesa e veçantë do të ofrojë një pasqyrë të detajuar të shpenzimeve të shfrytëzuesve buxhetorë, ndërsa pjesa projektuese do të përfshijë informacione për projektet lidhur me investimet publike me të dhëna për kohëzgjatjen dhe vlerën e përgjithshme të secilit projekt, të dhëna për realizimin e deritanishëm dhe investimet e planifikuara për periudhën afatmesme.

Ligji parashikon edhe afate të reja për procesin buxhetor, të cilat e zhvendosin kornizën kohore të përgatitjes së buxhetit, me qëllim të rritjes së parashikueshmërisë, përfshirjes së publikut dhe transparencës.

Me ligjin e ri për herë të parë u vendos Regjistri i subjekteve publike, që do të ketë qasje publike. Në këtë Regjistrë do të evidentohen të gjitha subjektet juridike të themeluara në mënyrë direkte ose indirekte nga shteti ose nga komunat dhe në këtë mënyrë do të sigurohet gjithpërfshirje dhe transparencë për të gjitha subjektet publike, qoftë në nivel qendror ose nivel lokal.

Njëkohësisht, janë paraparë dispozita për vendosjen e rregullave fiskale numerike, të dizajnuara në mënyrë që të jenë të harmonizuara dhe konsistente me rregullat fiskale të BE-së dhe ta bëjnë politikën fiskale më të parashikueshme dhe më të përgjegjshme. Qeveria mund të devijojë nga rregullat e përcaktuara fiskale gjatë rrethanave të jashtzakonshme.

Lidhur me Këshillin fiskal parashihet formimi i një organi të pavarur prej 3 antarëve të propozuar nga ASHAM –i, Enti Shtetëror i Revizionit dhe Banka Popullore, që do të përzgjedhen nga ana e Kuvendit. Antarët duhet të jenë ekspert nga sfera e financave publike, makroekonomia ose ekonomia.

Poashtu, në ligj parashihen dispozita të përgjithshme për përcaktimin e borxhit publik dhe lëshimin e garancive, me ç'rast përcaktohen procedurat për huamarrje për nevojat e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe lëshimin e garancive.

Njëkohësisht, parashihet përmirësim i cilësisë dhe kuatitetit të raportimeve.

Gjatë periudhës së ardhshme, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Botërore, si dhe përmes twining projektit IPA të BE-së "Strengthening budget planning, execution and internal control functions", do të vazhdojë të punojë në përgatitjen e akteve nënligjore, udhëzimeve, doracakëve dhe ngjajshëm, që synojnë operacionalizimin e Ligjit të ri për buxhete, përmirësimin e mëtejshëm të sistemit për menaxhimin e financave publike, si dhe zhvillimin e planit të detajuar për të gjitha proceset e punës në Ministrinë e Financave.

Poashtu, me propozim Ligjin për buxhete gjatë periudhës së ardhshme planifikohet vendosja e Sistemit të integruar për menaxhimin e financave publike (IFMIS – Integrated Financial Management Information System), me të cilin do të vendoset integrimi dhe lidhshmëria me të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe sistemet e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Drejtorisë doganore dhe institucioneve të tjera, me qëllim të mundësisë së menaxhimit më efikas të financave publike. Me zbatimin e sistemit IFMIS do të arrihet kompatibiliteti dhe interperabiliteti i përgjithshëm i sistemit të financave publike, kurse aplikimi i tyre në përputhje me Strategjinë për menaxhimin e financave publike, që nënkupton sigurimin e qasjes së sistemit dhe shkëmbimit të të dhënave në mënyrë të pandërprerë - 24 orë në ditë gjatë tërë vitin.

Në bazë të Vlerësimit të zbatuar për menaxhim me investimet publike (PIMA) nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Ministria e Financave si kordinatore e procesit përgatiti Planin aksional për zbatimin e rekomandimeve nga PIMA, që u miratua nga ana e Qeverisë. Plani aksional parasheh aktivitete që duhet të fillojnë me realizim në vitin 2021 dhe vitin 2022, kurse do të zbatohen nga ana e institucioneve kompetente nacionale në periudhën e ardhshme 2021- 2024 në funksion të përmirësimit të menaxhimit të financave publike.

Konkretisht, reformat që gradualisht do të vendosen janë në drejtim të përmirësimit të planifikimit, alokimit dhe zbatimit të projekteve publike infrastrukturore, që do të kontribuojë drejt harmonizimit më të madh të alokimeve buxhetore me prioritetet investuese të Qeverisë, përmirësimin e gjithpërfshirjes së dokumentacionit

buxhetor me qëllim të përfshirjes së të gjitha shpenzimet publike për investime kapitale dhe informacione për nevojat financiare të projekteve të reja dhe rrjedhëse, vendosjen e mbikëqyrjes ndaj portofolit të investimeve publike në nivel nacional që përfshin monitorimin dhe menaxhimin me rrezikun e tërsishëm gjatë realizimit.

3.2 Raporti mbi detyrimet e paraqitura në përputhje me Ligjin për paraqitje dhe evidencë të obligimeve

Me qëllim të sigurimit dhe ruajtjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe forcimit të përgjegjësisë në disponimin e mjeteve publike në Ligjin për paraqitje dhe evidencë të obligimeve rregullohet paraqitja, evidenca dhe publikimi i të dhënave për obligimet e paraqitura, të ndërmarra dhe obligimet e pamaturuara, të maturuara dhe të papaguara.

Kjo zgjidhje ligjore rregullon paraqitjen e obligimeve në bazë mujore në sistemin elektronik nga organet e pushtetit shtetëror, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet që kryejnë veprimtari në sferën e kulturës, arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes së fëmijës, mbrojtjes sociale, si dhe në veprimtaritë e tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë të themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Me qëllim të informimit të publikut dhe transparencës më të madhe, si dhe në bazë të të dhënave të evidentuara për obligimet e paraqitura, paraqitja bëhet në bazë mujore përmes Sistemit elektronik të paraqitjes dhe evidencës së obligimeve (SEPEO), më së voni deri në datën dhjetë të muajit për muajin paraprak dhe Ministria e Financave në vazhdimësi publikon raporte përmbledhëse tremujore në ueb faqen e saj.

Në bazë të të dhënave të evidentuara në Sistemin Elektronik të Paraqitjes dhe Evidencës së Obligimeve, nga të dhënat e paraqitura në muajin mars të vitit 2021, në tabelën 6 është paraqitur Raporti për obligimet e paraqitura sipas grupeve të subjekteve.

Табела 6. Извештај за пријавени обврски по групи на субјекти за март 2021 година (во милиони денари)

Реден број	Група на субјекти	Доспеани, а неплатени обврски, 2021	Недоспеани обврски, 2021	Недоспеани обврски, 2022	Недоспеани обврски 2023
1	Буџетски корисници прва линија	693	652	804	403
2	Буџетски корисници втора линија - институции на национално ниво	191	68	12	2
3	Општини	3,833	776	336	413
4	Единки корисници од втора линија-локални установи финансирани преку блок дотации	321	45	7	0
5	Јавни здравствени установи	3,269	1,540	1	0
6	Јавни претпријатија / Трговски друштва основани од Република Северна Македонија	7,557	4,995	5,464	1,078
7	Локални претпријатија основани од општини	3,221	637	193	99
8	Регулаторни тела	5	25	0	0
9	Плански региони	94	0	0	0
10	Останати субјекти	4	41	1,221	1,481
Вкупно (1+2+3+4+5+6+7+8+9+10)		19,188	8,779	8,038	3,476

Извор: Министерство за финансии - Електронски систем за пријавување и евиденција на обврски

Табела 6. Raport për obligimet e paraqitura sipas grupeve të subjekteve për muajin mars të vitit 2021 (në milionë denarë)

Numri rendor	Grupi i subjekteve	Detyrime të maturuara por të papaguara 2021	Detyrime të pamaturuara, 2021	Detyrime të pamaturuara, 2022	Detyrime të pamaturuara, 2023
1.	Shfrytëzues buxhetorë të linjës së parë				
2.	Shfrytëzues buxhetorë të linjës së dytë – institucione në nivel nacional				
3.	Komunat				

4. Njësi shfrytëzuese të linjës së dytë – institucione lokale të financuara përmes bllok granteve
5. Institucione Shëndetësore Publike
6. Ndërmarrje publike/ Shoqëri tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut
7. Ndërmarrje lokale të themeluara nga komunat
8. Organe rregullatore
9. Rajone e planifikimit
10. Subjekte të tjera

Gjithsej (1+2+3+4+5+6+7+8+9+10)

Bruimi: Ministria e Financave – Sistem elektronik për paraqitjen dhe evidencën e obligimeve

3.3. Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit

Puna e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të shtetit është e rregulluar me Ligjin për ndërmarrje publike, Ligjin për shoqëri tregtare, si dhe me ligje të tjera që përcaktojnë punën në rajone specifike (Ligji për energjetikë, Ligji për sistem hekurudhor, Ligji për rrugë publike, etj.).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është themeluese e 14 ndërmarrjeve publike dhe aksionare/ partnere e vetme në 15 shoqëri tregtare. Këto subjekte janë punëdhënës të rreth 15.5 mijë punëtorëve dhe paraqesin pjesë të rëndësishme të ekonomisë së Maqedonisë.

Të ardhurat e përgjithshme të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të shtetit për vitin 2020 sipas së dhënave nga raportet vjetore janë me vlerë prej 36.5 miliardë denarë, shpenzimet e përgjithshme të realizuara janë me vlerë prej 34.5 miliardë denarë, me ç'rast si rezultat final për vitin 2020 është realizuar fitim bruto prej rreth 2 miliardë denarëve (Tabela 7).

Treguesit financiarë të punës së ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare janë paraqitur në bazë akruale, sipas metodologjisë së përcaktuar të kontabilitetit, e cila dallon nga metodologjia e kontabilitetit të shfrytëzuesve buxhetorë ku të dhënat financiare paraqiten në bazë të parave të gatshme, duke marrë parasysh se këto subjekte kontabiliteti, përgatitjen dhe dorëzimin e faturave dhe raporteve financiare vjetore e realizojnë sipas Ligjit për shoqëri tregtare, standardeve të miratuara ndërkombëtare kontabiliste dhe standardeve ndërkombëtare për raportim financiar dhe jo sipas Ligjit për kontabilitet të buxhetit dhe shfrytëzuesve buxhetorë. Humbja e paraqitur tek ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare të caktuara në pronësi të shtetit është rezultat i amortizimit të llogaritur të mjeteve fikse, që paraqet harxhime të llogaritura dhe prezantohen si harxhime të ndërmarrjeve publike. Rezultati pozitiv i konstatuar gjatë punës kolektive të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore për vitin 2020, është bazë për përmisimin e mëtejshëm të performancës financiare të këtyre ndërmarrjeve, së bashku me përmirësimin efikas të shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve dhe ekonomisë.

Tabela 7. Treguesit kryesorë financiarë të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të plotë të shtetit (në milionë denarë)

Nr. Rend.	Emri i Shoqërisë aksionare/Ndërmarrjes publike në pronësi shtetërore	të ardhura të përgjithshme	shpenzime të përgjithshme	humbje/fitimi para tatimit	të ardhurave të planifikuara	shpenzime të planifikuara	humbje/fitimi para tatimit
		viti 2020			viti 2021		
1	SHA "Elektranat e Maqedonisë së Veriut" - Shkup	12.015,4	13.048,5	-1.033,1	12.434,0	12.421,5	12,5
2	SHA për Përcimin e Energjisë e Elektrike dhe Menaxhimin me Sistemin Elektro-Energjetik në pronësi të shtetit – Shkup	3.362,1	3.720,0	-357,9	3.193,4	3.860,0	-666,6
3	NP për Rrugë Shtetërore – Shkup	9.983,4	5.191,8	4.791,6	23.011,5	23.011,5	0,0
4	SHA "Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Transport – Shkup	1.235,9	1.620,6	-384,8	1.208,7	1.736,2	-527,5
5	NP "Pyjet Nacionale" – Shkup	1.433,4	1.516,8	-83,4	2.044,5	1.943,3	101,2
6	SHA "Posta Nacionale" – Shkup	1.163,8	1.258,8	-94,9	1.181,6	1.341,1	-159,5
7	NP për infrastrukturë hekurudhore "Hekurudhat e	780,5	1.103,1	-322,6	1.110,1	1.428,1	-318,0

	Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup						
8	NP për mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve magjistrale dhe rajonale – Shkup	1.197,7	1.194,1	3,6	1.550,0	1.540,0	10,0
9	NPR “Radiotelevizioni Nacional” - Shkup	1.012,2	937,7	74,5	1.022,5	1.022,5	0,0
10	SHA për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup	1.317,0	1.284,5	32,5	945,3	898,4	46,9
11	SHA për kryerjen e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve në Navigacionin Ajror	487,4	845,7	-358,3	738,9	777,7	-38,8
12	SHA “Ekonomia e Ujërave në Republikën e Maqedonisë së Veriut” – Shkup	629,7	657,8	-28,1	796,7	795,2	1,5
13	NP “Strazhevë” – Manastir	228,8	464,3	-235,6	244,8	467,6	-222,8
14	SHA TCE “Negotinë” – Negotinë	187,4	181,8	5,6	195,8	195,8	0,0
15	SHA “Lotaria shtetërore e Maqedonisë” – Shkup	673,7	263,0	410,7	641,2	375,5	265,7
16	NP “Ziletovica” – Probishtip	22,8	163,3	-140,5	25,6	167,2	-141,6
17	NP “Radiodifuzioni nacional” – Shkup	247,3	202,7	44,6	226,5	225,2	1,2
18	SHA “Aeroportet e Maqedonisë së Veriut” – Shkup	25,2	248,0	-222,8	13,2	122,0	-108,8
19	SHPKNJP “Boris Trajkovski” – Shkup	49,5	99,5	-50,0	116,0	160,0	-44,0
20	ND për ekonominë e ujërave “Lisiçe” – Veles	44,6	85,2	-40,6	47,1	87,8	-40,7
21	SHA për ekonomizim me hapësirë afariste me rëndësi për shtetin	87,8	82,3	5,4	90,0	82,9	7,1
22	NP “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” – Shkup	88,4	73,1	15,3	118,2	83,2	35,0
23	NP “Studençica” – Drugovë	62,2	65,6	-3,4	69,6	69,6	0,0
24	SHA “Agjencia informative mediatike” - Shkup	57,6	56,7	0,9	54,0	54,0	0,0
25	NP “Jasen” – Shkup	37,4	44,9	-7,5	47,6	45,5	2,0
26	NP për menaxhim me kullosa	42,6	55,3	-12,7	39,8	34,8	5,0
27	SHA “Resurse Energjetike Nacionale”	0,0	20,2	-20,2	3.157,0	44,7	3.112,3
28	NP “Agro – Bursa” – Shkup	8,6	10,0	-1,4	12,4	12,4	0,0
29	SHPKNJP Naftësjiellës – Shkup	0,0	7,0	-7,0	9,3	9,3	0,0
	GJITHSEJ:	36.482	34.502	1.980	54.345	53.013	1.332

Burimi: Raporte vjetore dhe Plane financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të shtetit

Me ndryshimet e Ligjit për ndërmarrje publike dhe në drejtim të avancimit të transparencës, ndërmarrjet publike obligohen që të publikojnë raporte vjetore dhe tremujore në ueb faqet e tyre, me ç'rast mundësohet monitorim transparent i punës financiare të këtyre subjekteve dhe njëkohësisht mundësohet që në mënyrë më reale të parashihet rreziku fiskal në këtë sferë dhe të reagohej, si dhe të ndërmerren me kohë masat adekuate. Ministria e Financave që nga viti 2020 në ueb faqe publikon të dhëna tremujore të konsoliduara mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në nivel të ndërmarrjeve publike/shoqërive tregtare në pronësi të shtetit.

Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit, sipas Ligjit për paraqitje dhe evidentim të obligimeve, detyrohen që në bazë mujore t'i paraqesin obligimet e ndërmarrja, të maturuara dhe të pamaturuara, si dhe obligimet e papaguara në Sistemin Elektronik për Paraqitjen dhe evidentimin e obligimeve, të cilin e udhëheq Ministria e Financave. Në bazë të të dhënave të evidentuara për obligimet e paraqitura, Ministria e Financave në vazhdimësi, në bazë tremujore publikon një sërë raporte në ueb faqen e saj, me ç'rast kontribuon më shumë në përforsimin dhe rritjen e transparencës.

Të ardhurat e Buxhetit në bazë të pagesës së deidentës nga shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit në fund të vitit 2020 janë me vlerë të përgjithshme prej 864.554.466 denarëve.

Detyrimi për pagesën e fitimit nga puna në Buxhet është sipas Ligjit për shoqëri tregtare, ndërsa ndërmarrjet publike sipas Ligjit për ndërmarrje publike, tepricën e mjeteve të realizuara nga puna, kanë për detyrim ta paguajnë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qoftë se mjetet në fjalë nuk janë të përfshira për investime në ndërmarrjen publike, me program të investimeve të përpiluar sipas planit financiar të detajuar. Pastaj, Themeluesi i ndërmarrjes publike, për mjetet shtesë nga puna e ndërmarrjes publike që janë paguar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të miratojë vendim që të mbulohen humbjet e një ndërmarrje tjetër dhe të paguhet në llogari të posaçme të destinuar për përkrahje financiare dhe zhvillim të kryerjes së veprimtarisë me interes publik të personit juridik të themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose që të mbulohen detyrime të buxhetit ndaj fondeve.

Në vitin 2020 në bazë të kësaj, në Buxhet janë paguar mjete me vlerë të përgjithshme prej 101.768.517 denarëve.

Edhe pse Ligji vjetor për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk i përfshin drejtpërsëdrejti ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit, ato përmes ministrive të tyre resoriale marrin transfere si përkrahje buxhetore për realizim të projekteve të caktuara infrastrukturore, duke marrë parasysh se ato kryejnë aktivitete që janë në interes publik, gjegjësisht janë subjekte që kryejnë aktivitete që janë esenciale për ekonominë e RMV-së.

Me qëllim të ballafaqimit më të mirë me pasojat negative të shkaktuara nga pandemia Kovid 19 dhe me udhëzime nga pushteti ekzekutiv si themelues i këtyre subjekteve, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit, ishin të detyruara që fitimet e realizuara t'i kthejnë në buxhet, si dhe t'i rishikojnë planet financiare në aspekt të uljes së shpenzimeve joproduktive për 15 %.

4. Shfrytëzimi i ndihmës paraaderuese të BE-së

Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka qasje në mjetet nga Instrumenti i ndihmës paraaderuese (IPA) të Bashkimit Evropian përmes dy perspektivave financiare: Perspektiva financiare e IPA 2007-2013 (IPA 1) dhe Perspektiva financiare e IPA 2014-2020 (IPA 2). Projektet e financuara nga Perspektiva financiare e IPA 2007-2013 (IPA 1) kanë përfunduar zbatimin e tyre dhe mbetet që zyrtarisht të përmbillen disa nga programet në të cilat janë financuar.

Në këtë pjesë prezantohet vetëm pjesa e ndihmës paraaderuese të BE-së që zbatohet sipas metodës së menaxhimit të decentralizuar/indirekt. Metoda e menaxhimit të decentralizuar/indirekt me IPA është metodë e menaxhimit në kuadër të të cilës Komisioni Evropian jep detyra për zbatimin e programeve të caktuara të IPA-s strukturës së akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, siç janë zbatimi i procedurave të tenderëve, lidhja e marrëveshjeve, monitorimi i projekteve dhe kryerja e pagesave. Nga ana tjetër, gjatë menaxhimit qendror këto përgjegjësi i ka KE-ja.

Mjetet për bashkëfinancim nacional të projekteve që zabtohen sipas metodës së menaxhimit decentralizues/indirekt, janë planifikuar në buxhetin e Ministrisë së Financave, ndarja 09002 – Funksione të shtetit, me përjashtim të bashkëfinancimit nacional të nevojshëm për projektet IPARD, që planifikohen në buxhetin e Agjencisë së përkrahjes financiare dhe zhvillimin rural, ndarja 14004, si dhe bashkëfinancimin nacional për pagesën e kontributit financiar ndaj KE-së për pjesëmarrje në programet e Bashkimit Evropian, që planifikohen në ministrinë resoriale.

4.1 IPA 1 – Perspektiva financiare 2007-2013

Në kuadër të IPA 1 perspektiva financiare 2007 – 2013, Republika e Maqedonisë së Veriut përmes pesë komponentave të IPA-s kishte në dispozicion mjete me vlerë prej 614 milionë euro (37.8 miliardë denarë) ku 467 milionë euro (28.7 miliardë denarë) apo 76% nga alokimet e përgjithshme u zbatuan përmes metodës së menaxhimit të decentralizimit (përmes strukturave që janë të akredituara nga shërbimet e Komisionit Evropian që menaxhojnë vetëm me fondet evropiane). Për IPA 1 në periudhën e programit 2007-2013, strukturat nacionale kompetente për zbatimin e projekteve të akredituara për menaxhim të decentralizuar me komponentat në vijim: IPA komponenta I - Ndihmë tranzitore dhe avancimi institucional (TAIB)/Ndihmë tranzitore dhe përmirësimi institucional; IPA Komponenti III – Zhvillimi rajonal; IPA Komponenti IV – Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe IPA komponenti V – Zhvillimi rural.

Zbatimi i pjesës më të madhe të programeve në kuadër të IPA 1 ka përfunduar në fund të vitit 2019 dhe zbatimi i projekteve të planifikuara në kuadër të Programit vjetor TAIB 2013 ka përfunduar në fund të vitit 2020.

Me programet e IPA komponentit I, në përgjithësi mundësohet përkrahja e administratës shtetërore në drejtim të përfundimit të kapaciteteve të saj në nivel qendror dhe lokal, reformimi i saj, si dhe plotësimi më i shpejtë dhe më efikas i detyrimeve për anëtarësim.

Për programin nacional TAIB 2013, niveli i marrëveshjeve të lidhura është rreth 93%, gjegjësisht janë lidhur gjithsej 52 marrëveshje, zbatimi i të cilave filloi në vitin 2017. Sipas kushteve të Marrëveshjes financiare, zbatimi i marrëveshjeve u realizua deri në tetor të vitit 2020, ndërsa pagesat përfundimtare lidhur me marrëveshjet u realizuan në muajin maj të vitit 2021.

4.2 IPA 2 – Perspektiva financiare 2014 – 2020

Në kuadër të IPA 2 perspektiva financiare për vitet 2014 – 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut kishte në dispozicion 664 milionë euro. Sa i përket mënyrës së zbatimit, 50% e alokimeve të përgjithshme për IPA 2 planifikohen që të zbatohen përmes sistemit indirekt të menaxhimit, përkatësisht përmes strukturave IPA të akredituara.

Ndihma shfrytëzohet për financimin e projekteve në sferat në vijim: drejtësia dhe punët e brendshme, infrastruktura rrugore dhe hekurudhore, mbrojtja e mjedisit jetësor, arsimi, punësimi, promovimi i barazisë gjinore, zhvillimi i burimeve njerëzore, zhvillimi i bujqësisë dhe zhvillimi rural.

Mjetet IPA që zbatohen përmes menaxhimit indirekt me programet vjetore dhe shumëvjeçare në vijim:

- Programi aksional për vitin 2014 në kuadër të së cilit financohen projektet në sektorët në vijim:
Gjyqësor,
Sistemi për rimëkëmbje nga fatkeqësitë dhe sigurimi i vazhdimësisë në punë,
Zhvillimi i kapaciteteve për ekspertizë në vendngjarje,
Bileta hyrëse për programet e Bashkësisë Evropiane,
Konkurrencë lokale dhe rajonale, e përqendruar në pjesën e turizmit dhe
Përkrahja për integrim në BE (SÇE).
- Programi aksional për vitin 2015, Programi aksional për vitin 2016, Programi aksional për vitin 2018 dhe Programi aksional për vitin 2020 në kuadër të së cilave financohen biletet hyrëse për programet e BE-së.
- Programi aksional për vitin 2017 në kuadër të cilit financohen projektet në sektorët në vijim:
Punë dhe arsim
Bileta hyrëse për programet e BE-së;
- Programi sektorial shumëvjeçar për mjedisin jetësor dhe aksionet klimatike në periudhën 2014-2020
- Programi IPARD 2.

Në kuadër të Programit aksional për vitin 2014 janë lidhur gjithsej 26 marrëveshje me vlerë prej 14.63 milionë euro. Për financimin e projekteve në kuadër të këtij Programi, Republika e Maqedonisë së Veriut kishte në dispozicion rreth 20 milionë euro të IPA mjeteve. Si projekte më të rëndësishme që zbatohen në kuadër të Programit janë:

- punë ndërtimore për rehabilitimin e burgjeve në Manastir dhe Shkup,
- punë ndërtimore për rehabilitimin e njësive rajonale të prokurorisë publike
- Skema e granteve për përkrahjen e sektorit joqeveritar në sferën e drejtësisë,
- Marrëveshje për përkrahje të reformave në sistemin e drejtësisë,
- Marrëveshje për furnizim me pajisje të IT-së për Ministrinë e Punëve të Brendshme – Qendra për ruajtjen e të dhënave në rast të fatkeqësive, etj.

Sa i përket këtij programi është e rëndësishme që të ceket se afati final për përfundimin e projekteve sipas Marrëveshjes së nënshkruar financiare ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian është data 20 nëntor të vitit 2021.

Në kuadër të Programit shumëvjeçar për mjedisin jetësor dhe aktivitetet klimatike dhe Programit shumëvjeçar për transport janë parashikuar projekte nga sfera e komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, si dhe projekte për ndërtimin e stacioneve filtruese, rrjeteve të kanalizimit dhe menaxhimit me mbeturina dhe ndryshimet klimatike.

Në kuadër të sektorit të Mjedisit jetësor dhe aktiviteteve klimatike për periudhën 2014 -2020 parashihet që të financohen rreth 48 marrëveshje për të cilat janë ndarë 114.96 milionë euro IPA mjete. Si projekte më të rëndësishme që planifikohen të financohen në kuadër të Programit janë marrëveshjet për punë ndërtimore për ndërtimin e stacioneve filtruese në Manastir dhe Tetovë, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Manastir, Tetovë dhe Kërçovë, ndërtimi i sistemit kolektor në Shkup, etj.

Në kuadër të sektorit të Transportit për periudhën 2014 – 2020, janë parashikuar të financohen rreth 22 marrëveshje. Në sektorin e Transportit në periudhën 2014 – 2019 janë ndarë 110.91 milionë euro të IPA mjeteve:

- ndërtimi i aksit hekurudhor nga Kriva Pallanka deri në Republikën e Bullgarisë
- ndërtimi i rrugorës nga Gradsko deri në Drenovë

- rikonstruimi i aksit rrugor nga Raeci deri në Prilep
- rikonstruimi i aksit rrugor nga Kumanova deri në Rankovcë etj.

Duke përfshirë edhe muajin maj të vitit 2021 në sektorin Transporti janë lidhur 4 (katër) marrëveshje në vlerë prej 31.98 milionë eurove, prej të cilave 27.18 milionë euro janë IPA mjete. Në sektorin mjedisi jetësor dhe ndryshimeve klimatike janë lidhur 9 (nëntë) marrëveshje me vlerë të përgjithshme prej 25.47 milionë eurove, prej të cilave 20.53 milionë eurove janë IPA mjete. Për pjesën tjetër të projekteve janë duke u zhvilluar procedurat e tenderit.

Sipas Marrëveshjes së nënshkruar financiare për këtë program, afati final për lidhjen dhe përfundimin e marrëveshjeve në kuadër të këtij programi është data 31.12.2025.

Në kuadër të Programit aksional për vitin 2017 janë parashikuar të financohen rreth 10 marrëveshje, për të cilat janë ndarë 12.65 milionë euro mjete IPA.

Në kuadër të këtij programi financohen projekte të sferës së punës dhe arsimit me qëllim të uljes së shkallës së lartë të papunësisë, rritjes së pjesëmarrjes në tregun e fuqisë punëtore, posaçërisht të të rinjve dhe grave, rritjen e mundësisë për arsim dhe trajnim cilësor, përmirësimin e rezultateve dhe aftësive, si dhe vendosjen e sistemit modern dhe fleksibil për mbrojtje sociale. Për arritjen e qëllimit final janë parashikuar më shumë projekte në sferën e:

- Përforcimit institucional të kapaciteteve për reforma sektoriale të qëndrueshme;
- Përforcimit të sistemit për arsim dhe trajnim;
- Promovimit të zhvillimit të aftësive, punësimit dhe kushteve të punës;
- Mbrojtjes sociale, përfshirjes sociale dhe pjesëmarrjes së barabartë në tregun e punës dhe në shoqëri.

Duke përfshirë muajin maj të vitit 2021 në kuadër të Programit aksional për vitin 2017 janë lidhur 3 (tri) marrëveshje me vlerë të përgjithshme prej 5.36 milionë eurove, prej të cilave 5 milionë euro janë mjete IPA.

Në lidhje me këtë Program është e rëndësishme që të theksohet se sipas Marrëveshjes së nënshkruar financiare lidhur me Programin aksional për arsim, punësim dhe politikë sociale për vitin 2017, me ç'rast afati përfundimtar për nënshkrimin e marrëveshjeve është data 20 nëntor për vitin 2021.

Sa i përket financimit të biletave hyrëse për programin e BE-së, pagesa e biletave hyrëse për pjesëmarrje në programet dhe agjencitë përkatese duhet të zbatohet përmes perspektivës financiare të IPA 3 për periudhën e programit të viteve 2021-2027. Financimi i biletave hyrëse zbatohet në mënyrë të decentralizuar përmes Fondit Nacional në kuadër të Ministrisë së Financave, me ç'rast planifikimi i pjesëmarrjes në IPA është në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Financave, ndërsa planifikimi i pjesëmarrjes nacionale është detyrë e institucioneve kompetente në buxhetin e tyre.

Programet e BE-së përfshijnë gati se çdo sferë të jetës sociale ekonomike të qytetarëve evropian: arsimit, kultura, të rinjtë, mediat, çështjet sociale, zhvillimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, mjedisi jetësor, transporti, shëndeti publik, bashkëpunimi juridik, lufta kundër dhunës, krimit, terrorizmit, shoqëria informatike, doganat dhe tatimet. Në programet marrin pjesë subjekte juridike, por në raste të caktuara edhe persona fizikë (individë).

Në kuadër të Programit IPARD 2 përkrahen projekte që do të mundësojnë arritjen e standardeve të BE-së, të vendosura në sferën e prodhimit të bujqësore, përpunimit të ushqimeve dhe zhvillimit rural. Për periudhën 2014-2020, në kuadër të këtij Programi, Republika e Maqedonisë së Veriut ka në dispozicion rreth 60 milionë euro mjete të IPA-s.

Zbatimi i programit IPARD 2014-2020 fillon me 4 masa (Investime në mjete materiale të ekonomive bujqësore, Investime në mjete fikse për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe të peshkimit, Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, si dhe ndihmë teknike për zbatimin e Programit), ku kanë filluar përgatitjet për akreditim edhe për një masë tjetër (Investime në infrastrukturën rurale publike).

Deri në muajin maj të vitit 2021 në kuadër të këtij Programi janë lidhur 2043 marrëveshje nga gjithsej gjashtë thirrje publike.

4.3 IPA 3 – në kuadër të Perspektivës financiare 2021-2027

Pakoja e re financiare 2021 – 2027 pritet të ketë rritje prej 6% në krahasim me pakon paraprake IPA 2. Fokusi i IPA 3 do të jetë më shumë fonde për investime përmes granteve dhe huave, si dhe rritjes së konvergencës. Gjithashtu, me IPA 3, fokusi i Bashkimit Evropian është në bashkëpunimin me BEI dhe BERZH, por edhe institucionet e tjera ndërkombëtare financiare, që do të ofrojnë hua të ashtuquajtura "leverage". IPA 3 do të duhet të kontribuojë në zbatimin e "Planit ekonomik dhe të investimeve për Ballkanin Perëndimor", të miratuar në samitin e muajit maj në vitin 2020 në Zagreb, për inkurajimin e rimëkëmbjes dinamike afatmesme, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e shkëmbimit tregtar ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, përmes financimit të projekteve të mëdha infrastrukturore në sektorin e transportit, mjedisit jetësor, dixhitalizimit dhe energjetikës, të cilat kanë rëndësi dhe lidhje rajonale, si dhe projekte të zhvilluara për zbatim në 4 vitet e ardhshme.

Shfrytëzimi i mjeteve nga IPA 3 do të bëhet në nivel nacional dhe rajonal. Shfrytëzimi i mjeteve përmes Instrumentit për ndihmë paraaderuese IPA III për periudhën 2021 – 2027, parasheh 5 dritare (të ashtuquajtura), edhe atë:

- Dritare 1: Sundimi i ligjit, të drejtat fundamentale dhe demokracia
- Dritare 2: Qeverisje e mirë, harmonizim i legjislacionit, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik
- Dritare 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme
- Dritare 4: Konkurrenca dhe rritja inkluzive
- Dritare 5: Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar.

Në nivel nacional, pakoja e fondeve do të jetë rreth 80 -100 milionë eurove në nivel vjetor. Në kuadër të pakos nacionale, fokusi mbetet në fillimin e negociatave, në përshtatjen e administratës me ritmin e përsheptuar të reformave dhe në mekanizmat koordinuese që duhet ta përsheptojnë procesin e negociatave, sipas metodologjisë së re të negociatave, grupimin në klaster dhe harmonizimi i negociatave me shfrytëzimin e mjeteve të IPA-s, për nevojat e procesit të negociatave dhe reformave strukturore në të gjithë shoqërinë. Vlera e mjeteve financiare në nivel nacional do të varet nga gatishmëria e administratës për të përgatitur projekte relevante dhe të zhvilluara që dalin nga nevojat e procesit për integrim në BE, angazhimi politik në zbatimin e këtyre projekteve, sepse IPA 3 është një garë ndërmjet vendeve shfrytëzuese (vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë) në kuadër të ashtuquajturës ndarje e drejtë („fair share“).

Në nivel rajonal, një pjesë e madhe e mjeteve të parajamëruara të IPA 3 do të plasohen përmes programeve rajonale, të destinuara për përkrahje të sektorit të transportit, mjedisit jetësor, energjetikës, përkrahjes sociale dhe dixhitalizimit. Prandaj, për këta sektorë do të jetë e rëndësishme që t'i zbatojnë me sukses strategjitë e tyre afatgjata, ku janë të përcaktuara prioritetet nacionale, si dhe tendencat që dalin nga axhenda evropiane, siç janë dixhitalizimi, interneti me rrjet të gjerë dhe të shpejtë, projektet e energjetikës dhe transformimi në dekarbonizim, burime të ripërtëritshme të energjisë, infrastruktura e gazit, ekonomia qarkore, mjedisi jetësor i pastër, garancitë për biznes privat dhe lidhja e komunikacionit, etj. Në vendin tonë edhe më tutje do të jenë në dispozicion mjetet nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor sipas parimit të ashtuquajtur bashkimi („blending“) i granteve dhe huave. Përparësi për financim do të kenë projektet e zhvilluara, që janë gati për zbatim të shpejtë. Përkatesisht, strategjia e re fiskale do të jetë më e relaksuar sa i përket huazimit të kapitalit nga institucionet financiare ndërkombëtare.

5. Borxhi Publik


Menaxhimi efikas i borxhit publik është i rëndësishëm dhe nënkupton zvogëlimin e rreziqeve gjatë hartimit të strukturës dhe politikës për menaxhim të borxhit, me qëllim që të shmanget pamundësia eventuale për servisim të rregullt dhe në kohë të borxhit. Qëllimi themelor është sigurimi i mjeteve të domosdoshme për financim të deficitit buxhetor dhe shlyerje të borxhit të viteve paraprake, si dhe mjete për financim të projekteve, pa shkaktuar rritje të pajustifikuar të borxhit deri në nivel që mund të rrezikohet stabiliteti i ekonomisë dhe rritja ekonomike e vendit. Menaxhimi cilësor i borxhit, ndër të tjera, përcaktohet nga korniza institucionale dhe kapaciteti për vendosjen dhe zbatimin e politikës së menaxhimit të borxhit publik. Kjo nënkupton përcaktim të qartë të qëllimeve dhe masave për menaxhim të borxhit publik.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në muajin maj të vitit 2019, miratoi Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për borxhin publik. Qëllimi i ndryshimeve ligjore ishte rritja e transparencës, harmonizimi me praktikën ndërkombëtare dhe rritja e besueshmërisë ndërmjet institucioneve dhe investitorëve ndërkombëtarë. Me ndryshimet ligjore, politika e menaxhimit të borxhit përcaktohet si dokument i posaçëm i Strategjisë për menaxhim të borxhit publik, e cila do të përpilohet në periudhë afatmesme prej tre viteve dhe do ta miratojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Ministrisë së Financave. Para miratimit të ndryshimeve ligjore, politika e menaxhimit të borxhit publik ishte pjesë e Strategjisë fiskale.

5.1. Vlera e borxhit publik dhe shtetëror

Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut më datë 31.03.2021 është me vlerë prej 6.207,8 milionë eurove, gjegjësisht 54.1% të BPV-së. Në kuadër të borxhit shtetëror, pjesëmarrje dominuese ka borxhi i pushtetit qendror me vlerë prej 6.191,1 milionë eurove, ndërsa borxhi i komunave është me vlerë prej 16.6 milionë eurove. Borxhi i përgjithshëm publik përfshin borxhin shtetëror edhe borxhin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi dominuese ose të plotë të shtetit (borxh i garantuar dhe jo i garantuar) në datë 31.03.2020 është me vlerë prej 7.173.6 milionë eurove, që paraqet 62.5% të BPV-së.

Grafiku 16. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik



Borxhi i pushtetit qendror paraqet 86.3% të borxhit të përgjithshëm të borxhit shtetëror deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2021 dhe ky borxh menaxhohet drejtpërdrejt nga Ministria e Financave. Në nivelet e tjera të borxhit, siç është borxhi i komunave dhe borxhi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi dominuese të shtetit apo komunave, Ministria e Financave merr pjesë në procesin e huamarrjes, por nuk mund të ndikojë në intensitetin e tërheqjes së mjeteve sa i përket huave të marrëveshjeve të lidhura.

Me fillimin e krizës Kovid-19, nevojat për financim u rritën, që rezultoi me huamarrje më të madhe në tregun ndërkombëtar të kapitalit. Përkatesisht, rritja e nevojave për financim shoqëruar me projeksionet e zvogëluara për rritje ekonomike, rritën treguesin borxhi publik/BPV-në. Projeksione më të hollësishme për lëvizjen e borxhit shtetëror dhe publik do të prezantohen në Strategjinë për menaxhim të borxhit publik për vitet 2022-2024 (me perspektivë deri në vitin 2026).

5.2 Borxh i garantuar dhe rreziku nga aktivizimi i garancive shtetërore

Me qëllim të fitimit të kushteve më të mira për financimin nga kreditorët, shteti emeton garanci shtetërore, pas analizave të kryera lidhur me huamarrësin dhe aftësinë e tij për servisim individual të detyrimeve të ardhshme. Gjatë, realizimit të huamarrjeve të reja merret parasysh qëndrueshmëria afatgjate e financave publike, ku procesi i emetimeve të garancive të reja rregullohet dhe i nënshtrohet procedurës së huamarrjes së përcaktuar në Ligjin për borxhin publik, sipas së cilës kërkuesit e garancisë duhet të plotësojnë kritere të caktuara që shteti të mund të emetojë garanci. Sipas ndryshimeve të fundit ligjore në Ligjin për borxhin publik, menaxhimi i detyrimeve potenciale u përmirësua përmes përforsimit të kapaciteteve në pjesën e dhënies së pëlimeve për huamarrje. Gjegjësisht, Ministria e Financave kryen analiza kreditore dhe vlerësim të aftësisë kreditore të bartësve të borxhit publik përgjatë emetimit të garancisë shtetërore, sipas metodologjisë së veçantë të përcaktuar të vlerësimit. Me këtë qasje bëhet harmonizimi me praktikën ndërkombëtare gjatë emetimit të garancive shtetërore.

Duke përfshirë datën 31.3.2021, garancitë shtetërore të emetuara janë me vlerë prej 927.5 milionë eurove, që paraqet 8.1% të BPV-së.

Edhe pse borxhi i garantuar është pjesë përbërëse e borxhit publik dhe publikohet në mënyrë transparente, Ministria e Financave ka marrë parasysh rrezikun në lidhje me detyrimet potenciale, gjegjësisht se cilat do të ishin efektet mbi Buxhet në rast të aktivizimit të garancive shtetërore. Ky segment shpjegohet më hollësisht në pjesën lidhur me rreziqet fiskale, si pjesë përbërëse e Strategjisë fiskale.

6. Analiza krahasuese e projeksioneve makroekonomike dhe fiskale për 2022-2026

6.1 Krahasimi me Strategjinë e rishikuar fiskale për 2021-2025

Strategjia fiskale e RMV-së 2022-2026 në krahasim me Strategjinë fiskale të rishikuar të RMV-së 2021-2025 nuk shfaq devijime sa i përket projeksionit të rritjes ekonomike, ndërsa devijimet në drejtim të pozicionit të jashtëm të vendit janë minimale.

Lidhur me kërkesën e jashtme, pritet që të stabilizohen gradualisht zinxhirët globalë të furnizimit, të rritet aktiviteti ekonomik te partnerët tanë tregtarë më të mëdhenj, të cilët, së bashku me uljen e presioneve nga pandemia në nivel global, pritet që të kenë ndikim pozitiv në flukset ekonomike vendore në periudhën e ardhshme, si në shkëmbimin tregtar, ashtu edhe në investime dhe konsum.

Rritja ekonomike ashtu si në Strategjinë fiskale paraprake, pritet të lëviz nga kërkesat vendore, me kontribut pozitiv gjithashtu nga konsumi dhe nga investimet, ndërsa eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ, por gradualisht të zvogëlohet, në kushte të rritjes solide të eksportit dhe importit.

Dallime më të rëndësishme ka tek papunësia, përkatësisht rënie më dinamike të papunësisë pritet në periudhën afatmesme, krahasuar me Strategjinë fiskale paraprake. Gjegjësisht, duke u zvogëluar presionet prej kriza shëndetësore, kthimi i besimit të investitorëve dhe pritshmëritë e përmirësuara të subjekteve afariste në periudhën e ardhshme, parashikohet rritje më e madhe sa i përket e kërkesës për fuqi punëtore, e nxitur dhe nga përkrahja e kompanive vendase dhe të huaja për hapjen e vendeve të reja të punës.

Tabela 8. Krahasimi i projeksioneve makroekonomike me Strategjinë e rishikuar fiskale viti 2021-2025

Индикатори	Рев. Фиск. стратегија 2021-2025					Фискална стратегија 2022-2026				
	2021	2022	2023	2024	2025	2021	2022	2023	2024	2025
БДП, реална стапка на раст (%)	4,1	4,6	5,2	5,6	5,9	4,1	4,6	5,2	5,6	5,9
Стапка на инфлација (просек)	1,5	1,8	2,0	2,0	2,2	2,1	1,8	2,0	2,0	2,0
Салдо на тековна сметка (% од БДП)	-2,9	-2,5	-2,0	-1,6	-1,3	-3,0	-2,4	-2,0	-1,6	-1,2
Нето-плата - номинален пораст (%)	3,0	3,5	3,9	4,1	4,4	3,0	3,5	3,8	4,1	4,2
Стапка на невработеност (просек)	15,8	15,0	14,1	13,2	12,4	15,8	14,4	12,9	11,4	9,9
Стапка на вработеност (просек)	48,3	49,1	50,1	51,1	52,1	47,5	48,6	49,8	51,3	52,8

Извор:Проекции на Министерството за финансии

Treguesit Strategjia e rishikuar 2021-2025 Strategjia fiskale 2022-2026

BPV, shkalla reale e rritjes

Norma e inflacionit (mesatarja)

Saldoja e llogarisë rrjedhëse (% nga BPV-ja)

Paga neto – rritje nominale (%)

Shkalla e papunësisë (mesatarja)

Shkalla e punësimit (mesatarja)

Burimi: Projektione të Ministrisë së Financave

Në periudhën e kaluar, aktiviteti ekonomik u karakterizua me zbatimin e masave shëndetësore, që kishin ndikim në realizimin e të hyrave buxhetore, ndërsa sa i përket shpenzimeve në buxhet kishte rritje të nevojave në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, por edhe nevojë për përkrahje të ekonomisë dhe qytetarëve, si dhe nevojë për masa të targetuara shtesë për rivitalizimin e ekonomisë në fazën e zbutjes graduale të masave për parandalimin e Covid-19 dhe rihapjes së ekonomisë.

Me zbatimin e procesit të imunizimit dhe përmirësimit me etapa epidemiologjisë, besimi i investitorëve dhe konsumatorëve do të rritet, me ç'rast do të rezultojë me rimëkëmbjen e investimeve dhe konsumit privat. Me rimëkëmbjen e ekonomisë dhe zbutjen e masave parandaluese shëndetësore, do të përmirësohet shfrytëzimi i kapaciteteve të shërbimit, që do të kontribuojë në lëvizjen e aktivitetit ekonomik, rritjen e ekonomisë dhe të ardhurat buxhetore.

Sa i përket projeksioneve për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Strategjia fiskale e RMV-së për periudhën 2022-2026 paraqet diferencë lidhur me Strategjinë fiskale të rishikuar të RMV-së për periudhën 2021-2025 sa i përket parashikimeve fiskale (Tabela 9). Përkatësisht, me deficitin buxhetor si tregues kryesor të politikës fiskale (edhe pse i ndryshuar në vlerën absolute dhe si% e BPV -së) parashikohet konsolidim fiskal i financave publike në periudhën e ardhshme.

Sa i përket projeksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve, me Strategjinë fiskale të RMV-së për periudhën 2022-2026 ndryshuan projektionet që i referohen projeksioneve të Strategjisë fiskale të rishikuar të RMV-së për

periudhën 2021-2025. Sa i përket anës së të ardhurave u realizuan ndryshime adekuate tek projeksionet, duke marrë parasysh realizimin e mirë në periudhën janar-prill të vitit 2021, pritshmëritë për rritje ekonomike, si dhe ruajtjen e trendit të arkëtimit të të ardhurave.

Tek ana e shpenzimeve, diferencë më të madhe ka në pjesën e subvencioneve dhe transfereve (në pjesën e shpenzimeve rrjedhëse) si rezultat i masave të ndërmara për sigurim të fondeve për zbatimin e masave ekonomike të miratuara nga Qeveria e Republikës Maqedonisë së Veriut, për ballafaqim me krizën e shkaktuar nga pandemia e virusit Korona Kovid-19, si dhe te shpenzimet kapitale për shkak të rishikimit të nivelit të financimit të projekteve në sferën e infrastrukturës rrugore.

Tabela 9. Krahasimi i projeksioneve afatmesme për Buxhetin e RMV-së me Strategjinë fiskale të rishikuar të RMV 2022 – 2026 (në milionë denarë)

	Рев. физик. стратегија 2021-2025						Фискална стратегија 2022-2026						Отстапување 2021-2025/ 2022-2026				% на отстапување			
Бюджет на Република Северна Македонија	Завршна сметка 2020	2021	2022*	2023*	2024*	2025*	2021	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2022*	2023*	2024*	2025*	2022*	2023*	2024*	2025*
Вкупни приходи	189,554	212,630	223,532	239,216	257,032	278,142	212,630	233,217	251,273	273,525	296,815	321,844	9,685	12,057	16,493	18,673	12	23	18	22
Даночни приходи и придонеси	173,464	186,282	197,707	212,316	229,432	249,542	186,282	207,047	224,467	246,319	268,909	293,738	9,340	12,151	16,887	19,367	7	19	20	25
Даночни приходи	106,900	117,982	126,001	137,032	150,392	166,558	117,982	133,719	146,748	163,946	181,603	201,202	7,718	9,716	13,554	15,045	10	25	24	30
Придонеси	66,564	68,300	71,706	75,284	79,040	82,984	68,300	73,328	77,719	82,373	87,306	92,536	1,622	2,435	3,333	4,322	2.3	3.2	4.2	5.2
Неданочни приходи	11,173	16,954	16,317	17,246	17,746	18,246	16,954	16,516	17,152	17,352	17,552	17,752	199	-94	-394	-694	1.2	-0.5	-2.2	-3.8
Капитални приходи	1,846	3,187	3,188	3,334	3,534	4,034	3,187	3,334	3,334	3,534	4,034	4,034	146	0	0	0	4.6	0.0	0.0	0.0
Донации	3,071	6,207	6,320	6,320	6,320	6,320	6,207	6,320	6,320	6,320	6,320	6,320	0	0	0	0	0.0	0.0	0.0	0.0
Вкупни расходи	243,421	247,567	252,483	265,172	281,515	297,251	247,567	265,876	279,687	298,863	320,406	344,338	13,393	14,515	17,348	23,155	5.3	5.5	6.2	7.8
Тековни расходи	227,306	223,512	226,593	233,344	245,878	259,270	223,512	233,286	240,975	251,696	269,593	284,459	6,693	7,631	5,818	10,323	3.0	3.3	2.4	4.0
Плати и надоместоци	29,775	31,394	31,562	31,662	33,062	34,062	31,394	31,862	31,962	32,062	33,562	34,062	300	300	-1,000	-500	1.0	0.9	-3.0	-1.5
Стоки и услуги	15,423	21,322	22,068	23,418	25,418	27,718	21,322	22,568	24,418	26,418	29,718	32,718	500	1,000	1,000	2,000	2.3	4.3	3.9	7.2
Трансфери до ЕПС	21,373	21,315	21,453	22,617	23,744	26,018	21,315	21,453	22,184	22,953	25,807	28,671	0	-433	-791	-211	0.0	-1.9	-3.3	-0.8
Субвенции и трансфери	34,905	19,351	17,234	18,234	21,734	24,590	19,351	21,234	22,234	25,734	29,590	33,090	4,000	4,000	4,000	5,000	23.2	21.9	18.4	20.3
Социјални трансфери	117,799	120,653	124,104	126,855	130,981	135,742	120,653	126,097	129,803	134,420	139,708	145,176	1,993	2,948	3,439	3,966	1.6	2.3	2.6	2.9
Каматни плаќања	8,031	9,478	10,172	10,558	10,939	11,140	9,478	10,072	10,374	10,109	11,208	10,742	-100	-184	-830	68	-1.0	-1.7	-7.6	0.6
Домашни	2,742	3,069	3,580	3,938	3,939	3,940	3,069	3,603	3,904	4,151	4,471	4,782	23	-34	212	531	0.6	-0.9	5.4	13.5
Странски	5,289	6,409	6,592	6,620	7,000	7,200	6,409	6,469	6,470	5,958	6,737	5,960	-123	-150	-1,042	-463	-1.9	-2.3	-14.9	-6.4
Капитални расходи	16,115	24,055	25,890	31,828	35,637	37,981	24,055	32,590	38,712	47,167	50,813	59,879	6,700	6,884	11,530	12,832	25.9	21.6	32.4	33.8
Буџетско салдо	-53,867	-34,937	-28,951	-25,956	-24,483	-19,109	-34,937	-32,659	-28,414	-25,338	-23,591	-22,494	-3,708	-2,458	-855	-4,482	12.8	9.5	3.5	23.5
Примарно буџетско салдо	-45,836	-25,459	-18,779	-15,398	-13,544	-7,969	-25,459	-22,587	-18,040	-15,229	-12,383	-11,752	-3,808	-2,642	-1,685	-4,414	20.3	17.2	12.4	55.4
Вкупни приходи, % од БДП	28.5	30.1	29.6	29.6	29.5	29.5	30.1	30.9	31.1	31.4	31.5	31.6					1.3	1.5	1.9	2.0
Вкупни расходи, % од БДП	36.7	35.0	33.5	32.8	32.3	31.5	35.0	35.3	34.6	34.3	34.0	33.8					1.8	1.8	2.0	2.5
Буџетско салдо, % од БДП	-8.1	-4.9	-3.8	-3.2	-2.8	-2.0	-4.9	-4.3	-3.5	-2.9	-2.5	-2.2					-0.5	-0.3	-0.1	-0.5
Примарно буџ. салдо, % од БДП	-6.9	-3.6	-2.5	-1.9	-1.6	-0.8	-3.6	-3.0	-2.2	-1.7	-1.3	-1.2					-0.5	-0.3	-0.2	-0.5

Strat. fisk. e rishikuar Strategjia fiskale 2022-2026 Diferenca 2021-2025/2022-2026 % të diferencës

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Llogaria përfundimtare

Të ardhura të përgjithshme

Të ardhura tatimore dhe kontribute

Të ardhura tatimore

Kontribute

Të ardhura jotatimore

Të ardhura kapitale

Donacione

Shpenzime të përgjithshme

Shpenzime rrjedhëse

Paga dhe kompensime

Mallra dhe shërbime

Transfere në NJVL

Subvencione dhe transfere

Transfere sociale

Pagesa të interesit

Vendore

Të huaja

Shpenzime kapitale

Saldoja e Buxhetit

Saldoja primare e Buxhetit

Gjithsej të ardhura, % nga BPV-ja

6.2 Krahاسimi me projeksionet e tjera të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare

Duke marrë parasysh pasigurinë e lidhur me afatgjatësinë dhe pasojat nga kriza shëndetësore, por edhe vlerësimet e ndryshme të efekteve nga masat dhe politikat ekonomike në vend në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, të ndryshme janë edhe pritshmëritë për rrugën e rritjes ekonomike nga institucione të ndryshme.

Sipas skenarit themelor të Strategjisë fiskale, rritja ekonomike në vitin 2021 është projektuar të jetë 4.1%, ndërsa në periudhën 2022-2026 parashihet përsheptim i rritjes që mesatarisht do të arrijë 5.4% dhe është më i lartë se pritshmëritë e institucioneve të tjera.

Përkatesisht, politika fiskale dhe ridizajnimi i shpenzimeve publike, të orientuar drejt përforsimit të ciklit të investimeve publike dhe masave të destinuara drejt rritjes ekonomike të përsheptuar, inkluzive dhe të qëndrueshme, pritet që të ketë ndikim të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik në periudhë afatmesme.

Gjithashtu, përmes Planit për financim të rimëkëmbjes dhe përsheptimit të rritjes ekonomike do të përkrahet aktiviteti për investime, do të intensifikohet rritja e punësimit, do të përmirësohet konkurrenca në ekonomi dhe me këtë edhe potenciali për rritje ekonomike.

Табела 10. Споредба на проекциите за реалниот раст на БДП и инфлацијата за Северна Македонија

Институција	Реален раст на БДП (%)						Стапка на инфлација (%)					
	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2021	2022	2023	2024	2025	2026
ММФ	3,8	4,0	3,7	3,5	3,5	3,5	2,0	1,5	1,6	1,9	2,0	2,0
Светска банка	3,6	3,5	-	-	-	-	1,6	2,0	-	-	-	-
Европска комисија	3,7	3,8	-	-	-	-	1,7	1,7	-	-	-	-
НБРСМ	3,9	3,9	4,0	-	-	-	2,2	2,0	2,0	-	-	-
Министерство за финансии	4,1	4,6	5,2	5,6	5,9	5,7	2,1	1,8	2,0	2,0	2,0	2,0

Извор: ММФ (World Economic Outlook, април 2021 г.), Светска банка (Western Balkans Regular Economic Report, април 2021 г.), Европска комисија (European Economic Forecast, мај 2021 г.) и НБРСМ (Квартален извештај, мај 2021 г.).

Табела 10. Krahасими i projeksioneve për rritjen reale të BPV-së dhe inflacionit për Maqedoninë e Veriut

Институции	Рритја reale e BPV-së	Norma e inflacionit (%)
FMN		
Banka Botërore		
Komisioni Evropian		
BPRMV		
Ministria e Financave		

Burimi: FMN (World Economic Outlook, prill v. 2021), Banka Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, prill v. 2021), Komisioni Evropian (European Economic Forecast, мај v. 2021) dhe BPRMV (Raporti tremujor, мај v. 2021).

Gjithashtu, ndryshimet paraqiten në aspekt të nivelit të deficitit buxhetor, me atë që të gjitha institucionet, sipas projeksioneve të Strategjisë fiskale, parashikojnë konsolidim fiskal të caktuar, gjegjësisht ulje graduale të deficitit buxhetor dhe ruajtje të qëndrueshmërisë së borxhit shtetëror (Табела 11).

Табела 11. Споредба на проекциите за буџетскиот дефицит и државниот долг за Северна Македонија

Институција	Буџетско салдо (% од БДП)						Државен долг (% од БДП)					
	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2021	2022	2023	2024	2025	2026
ММФ	-5,6	-4,2	-3,6	-3,4	-3,2	-3,0	53,8	54,9	55,5	55,9	56,0	56,0
Светска банка	-5,3	-3,9					56,5	57,5				
Европска комисија	-4,1	-3,4					53,5	54,2				
Министерство за финансии	-4,9	-4,3	-3,5	-2,9	-2,5	-2,2	54,5	55,3	54,9	53,7	52,4	50,7

Извор: ММФ (World Economic Outlook, април 2021 г.), Светска банка (Western Balkans Regular Economic Report, април 2021 г.) и Европска комисија (European Economic Forecast, мај 2021 г.).

Tabela 11. Krahassimi i projeksioneve për deficitin buxhetor dhe borxhin shtetëror në Maqedoninë e Veriut

Institucioni	Saldoja buxhetore (% e BPV-së)	Borxhi shtetëror (% e BPV-së)
FMN		
Banka Botërore		
Komisioni Evropian		
Ministria e Financave		

Burimi: FMN (World Economic Outlook, prill v. 2021), Banka Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, prill v. 2021), Komisioni Evropian (European Economic Forecast, maj v.2021) dhe BPRMV (Raporti tremujor, maj v. 2021).

7. Rreziqet fiskale dhe analiza senzitive

Projeksionet afatmesme ekonomike dhe fiskale shoqërohen gjithmonë me shkallë të pasigurisë dhe rrezikut. Materializimi eventual i këtyre rreziqeve, që supozojnë kushte të ndryshme nga ato të marra si bazë për projeksionet afatmesme të diskutuara më lartë, do të rezultojë me diferencë të skenarit bazë afatmesëm, gjegjësisht realizim tjetër i ndryshimeve kryesore fiskale. Përkatësisht, në këtë pjesë të Strategjisë fiskale analizohen efektet e mundshme të realizimit eventual të disa rreziqeve kryçe makro fiskale mbi deficitin buxhetor dhe borxhin shtetëror.

7.1 Rreziqet makrofiskale dhe senzitiviteti i deficitit dhe borxhit shtetëror

Në këtë pjesë të Strategjisë fiskale ofron një pasqyrë rreth rezultateve të analizës senzitive sa i përket ndjeshmërisë së deficitit buxhetor dhe nivelit të borxhit shtetëror ndaj realizimit eventual të katër rreziqeve kryesore të identifikuar lidhur me politikën fiskale për periudhë afatmesme. Përkatësisht, të gjitha rreziqet janë analizuar veçmas dhe në të gjithë skenarët supozohet mungesa e diferencave të tjera nga skenari bazë dhe realizimi i rreziqeve të caktuara:

- Skenari 1- Zvogëlimi i rritjes ekonomike
- Skenari 2- Të ardhura më të ulëta tatimore për 5%
- Skenari 3 – Realizimi më i ulët i shpenzimeve kapitale për 25% dhe
- Skenari 4 – Servisimi i detyrimeve në bazë të garancive të emetuara me mjetet nga Buxheti i RMV-së.

Duke marrë parasysh që projeksiioni bazë fiskal afatmesëm bazohet në disa supozime makroekonomike, ato konsiderohen si faktor primar me ndikim potencial sa i përket lëvizjeve fiskale. Andaj, si skenar i parë i rrezikut, supozojmë materializimin e rreziqeve në rënie që i referohet kohëzgjatjes dhe pasojave nga kriza shëndetësore, si në vend ashtu edhe në nivel global, të cilat mund të kenë pasojë/efekt mbi zinxhirët globalë në furnizim dhe në kërkesën e jashtme, pritshmëritë e subjekteve afariste dhe amvisërive, rritjen e investimeve dhe remitancave nga jashtë dhe rrjedhimisht pasojë negative në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik vendor. Sipas këtij skenari, projeksiioni për rritje reale mesatare të BPV-së ndërmjet viteve 2022 dhe 2026 është 1.4 pikë përqindje më i ulët se në skenarin bazë. Përkatësisht, rritja më e ulët ekonomike do të implikojë edhe realizim më të ulët të komponentit ciklik të të ardhurave në buxhet. Prandaj, në krahasim me projeksionin bazë, ky skenar do të rezultonte me deficit më të madh buxhetor prej 0.9 pikë përqindjeje të BPV-së mesatarisht në vit, ndërmjet viteve 2022 dhe 2026, ndërsa borxhi shtetëror do të ishte më i lartë për 7 pikë përqindje të BPV-së në fund të vitit 2026.


Me skenarin e dytë supozohet zvogëlimi i arkëtimit të të ardhurave tatimore për 5% në nivel vjetor në krahasim me projeksionin themelor. Në kushte të nivelit të pandryshuar të shpenzimeve buxhetore dhe rritjes së pandryshuar ekonomike, të ardhurat tatimore do të kontribuonin në rritjen e deficitit buxhetor për 0.9 pikë përqindje të BPV-së mesatarisht në vit gjatë periudhës 2022-2026 në krahasim me projeksionin themelor, ndërsa borxhi shtetëror do të ishte më i lartë për 3.9 pp. të BPV-së në fund të vitit 2026 sa i përket projeksionit themelor.

Me skenarin e tretë supozohet realizim më i ulët i shpenzimeve kapitale, gjegjësisht realizim në nivel prej 75% në krahasim me shpenzimet e parashikuara në projeksionin themelor, i cili është i ngjashëm me realizimin e tyre në të kaluarën. Realizimi i ulët i shpenzimeve kapitale do të kishte pasojë negative mbi rritjen e investimeve bruto dhe si rrjedhojë edhe mbi rritjen e aktivitetit ekonomik në krahasim me skenarin bazë mesatarisht për 0.6 pikë përqindje në nivel vjetor. Ky skenar, do të kishte ndikim negativ në të ardhurat tatimore, i cili do të tejkalonte efektin e uljes së shpenzimeve. Prandaj, sipas këtij skenari, deficitin buxhetor do të ishte më i lartë për 0.4 pikë përqindje të BPV-së mesatarisht në vit në periudhën e parashikuar në krahasim me projeksionin themelor, ndërsa borxhi shtetëror do të ishte më i lartë me 2.6 pikë përqindje të BPV-së në fund të vitit 2026 sa i përket projeksionit themelor.

Me skenarin e ketërt supozohet që detyrimet që maturojnë në bazë të kryegjësë dhe interesit të huave të garantuara nga shteti të sevisohen tërësisht nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është supozim ekstrem. Materializimi eventual i skenarit ekstrem do të shkaktojë rritje të nivelit të shpenzimeve buxhetore në periudhën e ardhshme. Në kushte të nivelit të pandryshuar të të ardhurave buxhetore dhe rritjes së pandryshuar ekonomike, do të kontribuonte në rritjen e deficitit buxhetor me 1.1 pikë përqindje të BPV-së, në mënyrë mesatare në vit për periudhën 2021-2026, në krahasim me projeksionin themelor, ndërsa borxhi shtetëror në fund të vitit 2026 do të ishte më i lartë me 5.4 p.p. sa i përket projeksionit bazë. Efekti i këtij skenari mbi borxhin do të ishte i pranishëm në të gjithë periudhën afatmesme.


Në përgjithësi, realizimi i cilido prej katër skenarëve të rreziqeve, që pasqyrojnë rreziqet kryesore të identifikuar makrofiscale në periudhën e ardhshme, në pjesën më të madhe do të rezultonte me efekte relativisht të kufizuara në deficitin buxhetor dhe borxhin shtetëror (Grafiku 17). Më saktë, në asnjë mënyrë nuk rrezikohet qëndrueshmëria e politikës fiskale në planin afatmesëm.

Grafiku 17 Analiza senzitive e deficitit buxhetor (majtas) dhe borxhit shtetëror (djathtas) të rreziqeve makrofiscale



Projeksioni bazë
 Skenari 1
 Skenari 2
 Skenari 3
 Skenari 4

Burime: Stimulimet e Ministrisë së Financave



Projeksioni bazë
 Skenari 1
 Skenari 2
 Skenari 3
 Skenari 4

Burime: Stimulimet e Ministrisë së Financave

Gjatë vitit 2021, ekonomia pritet të rimëkëmbet, përmes zbatimit të procesit të imunizimit masiv dhe përmirësimit gjendjes epidemiologjike. Imperativi themelor është tejkalimi i krizës shëndetësore me pasoja më të vogla të mundshme mbi ekonominë, që nënkupton ruajtjen e të gjitha vendeve të punës dhe kthimin në tregun e punës të gjithë ata që humbasin vendet e punës. Po qe e nevojshme, përmes procesit inklusiv me përfshirje të të gjitha palëve të involvuara, do të merren masa ekonomike shtesë për mbështetje të aktiviteve dhe sektorëve të caktuar të prekur nga pandemia. Masat ekonomike shtesë do të ndikojnë në shpenzimet e Buxhetit dhe në rritjen e deficitit buxhetor. Financat publike në periudhën e kaluar, në kushte të sfidave të shumta, duke përfshirë këtu edhe krizën shëndetësore dhe ekonomike, siguruan pagesë në kohë të të drejtave ligjore, gjegjësisht përmes shpenzimeve efikase dhe publike, u siguria servisi i rregullt dhe në kohë i detyrimeve shtetërore.

Në periudhën e ardhshme afatmesme, politika fiskale do të orientohet në konsolidimin e shpenzimeve publike, nxitjen e aktivitetit ekonomik përmes shpenzimeve kapitale dhe investimeve në infrastrukturë, si dhe në përmirësimin e kushteve për udhëheqjen biznes dhe hapjen e vendeve të punës. Njëkohësisht, do të vazhdojë përcaktimi për realizimin e konsumit të disiplinuar buxhetor me theks në kufizimin dhe kontrollin e shpenzimeve më pak produktive me qëllim të rritjes së investimeve në projektet kapitale. Postulatet themelore të përcaktuara të politikës fiskale në periudhën e ardhshme sigurojnë konsolidim me etapa, me ulje graduale të nivelit të deficitit.

